

UNIVERSITETI I EUROPËS JUGLINDORE
FAKULTETI JURIDIK
DREJTIMI PENAL



‘PROFILI I PERSONAVE QË VUAJNË DËNIMIN
NË BURGUN E TETOVËS NË PERIUdhËN 2012-2019’

Punim i magjistraturës

Mentor:

Prof. Dr. Ismail Zejneli

Kandidat:

Blerand Rexhepi

Tetovë, 2020

DEKLARATË

Deklaroj që gjatë përgatitjes së tezës së masterit i kam lexuar dhe i kam pas parasysh të gjitha rregulloret pozitive ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e mbrojtjes së pronë intelektuale dhe unë nuk kam përdor fjali ose fragmente nga të tjerët autor pa respektuar standardet metodologjike dhe stilin e duhur të citim të të njëjtëve duke i shënuar citimet e tyre me fusnota. Deklaratën e jap nën përgjegjësi të plotë morale, materiale dhe penale.

D e k l a r u e s

Blerand Rexhepi

PËRMBAJTJA

Hyrje.....
Qëllimi punimit.....
Çështjet hulumtuese dhe hipotezat e studimit.....
Metodologjia e punimit.....

KAPITULLI I PARË

ORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE PENITENSIARE NË MAQEDONI

1. Aspekti historik i institucioneve penitensiare.....
2. Parimet e organizimit të institucioneve penitensiare.....
3. Parimi i ligjshmërisë.....
4. Parimi i risocializimit.....
5. Parimi i individualizimit.....
6. Parimi i mbajtjes kolektive të dënimit.....

KAPITULLI I DYTË

VUAJTJA E DËNIMIT NË BURGUN E TETOVËS

1. Pozita dhe gjendja e të dënuarve në rajonin e Tetovës.....
3. Profili i të të dënuarve.....
4. Llojet e vuajtjes së dënimit.....
5. Vrasjet.....
6. Tentimvrasjet.....
7. Dhuna fizike.....
8. Dhuna seksuale.....

9. Dhuna psiqike.....
10. Përkatësia gjinore.....
11. Moshë.....
12. Përgatitja shkollore.....
13.Përkatësia nacionale.....
14.Gjendja shëndetësore.....

KAPITULLI I TRETË

GJENDJA EMOCIONALE E TË BURGOSURVE QË NDIKOJNË NË KRYERJEN E VEPRAVE PENALE DHE VUAJTJEN E DËNIMIT

1. Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprës penale.....
2. Gjendja emocionale e të burgosurve gjatë kryerjes së veprës penale.....
3. Shkaqet e kryerjes së veprës penale.....

KAPITULLI I KATËRT

PARANDALIMI DHE MASAT PËR MBROJTJE TË TË BURGOSURVE NË SHOQËRI

1. Roli institucional preventues.....
2. Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit.....
3. Legjislacioni dhe mbrojtja e të burgosurve.....
4. Mbrojtja juridiko-penale e të burgosurve.....

Përfundimi.....

Literatura.....

Hyrje

Në këtë punim, theksohet tema e profilizimit, me theks të veçantë në profilizimin e autorëve të veprave të lehta dhe të rënda me burgim afatgjatë. Qëllimi i profilizimit të personave të tillë është që të organizojnë dhe strukturojnë më mirë jetën e tyre të përditshme në sistemin e burgjeve, me theks të veçantë në identifikimin e sjelljeve të rrezikshme dhe kategorive të të burgosurve që paraqesin rrezik për stafin e burgut, të burgosurit e tjerë ose vetë ata. Si rrjedhim, tema e hulumtimit në këtë punim përfshin profilizimin kriminal të autorëve të krimeve të rënda, historinë e shfaqjes së tyre, teknikat hetimore, modelet dhe llojet e profilizimit, si dhe ndryshimin midis profileve kriminale dhe profilizimit të të burgosurve. Dallimet dhe specifikat në profilizimin e një personi që vjen në burg dhe profilizimin kriminal që përdoret më së shpeshti nga oficerët e policisë në hetimin e krimeve të rënda janë analizuar në këtë punim. Kuadri ligjor dhe organizativ që i mundëson personelit të burgut të zhvillojë profilin e një të burgosuri të veçantë dhe masat në dispozicion të oficerëve të policisë gjyqësore në rastet kur një i burgosur i sigurisë është identifikuar në lidhje me mjedisin e tij shoqërorë dhe fizik, është përpunuar më tej. Në pjesën e fundit të punimit, për të ilustruar temën, janë analizuar raste nga praktika e sistemit të burgjeve të Maqedonisë e me theks të veçantë në burgun e Tetovës dhe rajonin e Pollogut në periudhën kohore 2012-2019, e cila tregon vlerësimin fillestarë të të burgosurve dhe modalitetet e mbikëqyrjes së tyre të vazhdueshme, me qëllim parandalimin e incidenteve dhe rrezikimin e sigurisë së stafit të burgut dhe të burgosurve të tjerë.

Qëllimi dhe rëndësia e studimit

Në sistemin tonë ligjor dhe social të burgosurit kriminel janë kategoria me vulnerabël në konflikt me ligjin. Në këto kushte nevojitet një sistem ligjor i përshtatshëm me të drejtat e të burgosurve dhe me integrimin e tyre në shoqëri pas vuajtjes së dënimit, kjo sepse kriminaliteti i të burgosurve të të gjitha moshave dhe gjinive ndikon drejtpërdrejt në shoqëri. Për rrjedhojë administrimi i drejtësisë për të burgosurit ende është në proces zhvillimi. Nëpërmjet këtij studimi synimi është evidentohet vakuumi dhe problemet me të cilat haset sot sistemi ynë ligjor. Evidentimi i situatës aktuale të kriminalitetit në Maqedoninë e Veriut dhe i faktorëve të cilat ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e tij përbëjnë një avantazh në lidhje me zhvillimin e drejtësisë për të burgosurit. Me anë të këtij punimi objektivi është:

1. Analizimi i situatës aktuale mbi kriminalitetin e të burgosurve dhe profilizimi i tyre,
2. Identifikimi dhe analizimi i faktorëve nxitës të kriminalitetit tek ta,
3. Evidentimi i masave të ndërruara nga shteti për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit e të burgosurve të të gjitha kategorive,
4. Evidentimi i vakuumeve ligjore në lidhje me drejtësinë dhe e të drejtat e të burgosurve,
5. Identifikimi i veprimeve dhe masave që duhet të ndërmerren nga shteti për luftimin dhe parandalimin e këtij fenomeni që po shqetëson shoqërinë.
6. Ndërmarrja e masave edukativo-arsimore në integrimin e të burgosurve pas vuajtjes së dënimit nga ana e shtetit dhe institucionet përkatëse.

Qëllimi i këtij studimi është gjithashtu të propozojë edhe disa rekomandime të zbatueshme për të gjithë faktorët e përfshirë në hartimin dhe në zbatimin e legjislacionit, me qëllim minimizimin e kriminalitetit si një fenomen me influencë negative për shoqërinë. Sot ende nuk jemi të sigurt që sistemi aktual dhe ai që do të vijojë në të ardhmen janë sisteme të mira dhe ato të duhurat që do të ndikojnë në parandalimin e realizimit të veprave penale. Kjo për faktin që sfidat që na paraqiten janë të pafundme dhe të paparashikueshme, por ajo që është e rëndësishme është që sistemi në çdo fazë, duhet t'i përgjigjet sa më mirë, më shpejt dhe me kosto sa më të ulët kërkesave të të sotmes dhe perspektivave të së ardhmes në mënyrë që në sistemin ligjor të prevalojë interesi më i lartë i kategorive të personave që janë të prirur të kryejnë vepra kriminale.

Çështjet hulumtuese dhe hipotezat e studimit

Një hulumtim shkencor ka në strukturën e tij të inkorporuar pyetjet kërkimore dhe hipotezat e ngritura për qëllimin e studimit. Pyetjet kërkimore shërbejnë për kanalizimin e studimit dhe evidentimin e rëndësisë së tij. Në këtë punim trajtohet në mënyrë të detajuar fenomeni i kriminalitetit të personave të të gjitha moshave dhe gjinive duke bërë një analizë të kuadrit ligjor dhe zbatimit të tij ndaj të këtyre kategorive, autorë të veprave penale. Pyetjet kërkimore që janë ngritur në këtë punim janë në funksion të analizimit të studimit lidhur me kriminalitetin dhe reformave ligjore që duhet të ndërmerren për uljen e përfshirjes së të personave të të gjitha kategorive në vepra të ndryshme penale. Në këtë punim jemi përpjekur që t'i japim përgjigjeve të mëposhtme:

- Cilët janë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në rritjen e kriminalitetit nga të personat e të gjitha kategorive dhe gjinive?
- A parashikon legjislacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut një trajtim të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të tyre gjatë vuajtjes së dënimit në përputhje me legjislacionit dhe standardet ndërkombëtare?
- Cilat janë aktet ndërkombëtare dhe rajonale që janë integruar në sistemin e brendshëm për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve?
- A i përmbush legjislacioni i Republikës së Maqedonisë së Veriut të gjitha detyrimet që vijnë nga aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve?
- Cilat janë problematikat që has legjislacioni penal i Republikës së Maqedonisë së Veriut për të burgosurit në zbatimin e tij në praktik?
- A gëzojnë mbrojtje të posaçme të burgosurit që vuajnë dënimet penale në institucionet përkatëse me kuadrin ligjor ekzistues?
- A disponon sistemi ynë i drejtësisë institucione në përputhje me standardet ndërkombëtare për vuajtjen e dënimit nga të burgosurit?
- Cilat janë ndryshimet që duhen bërë në legjislacionin vendor për të ofruar një standard mbrojtje më të lartë për të burgosurit?

Hipoteza e studimit është pjesë e pandarë e strukturës së tij, mungesa e të cilës do të cenonte arkitekturën e punimit shkencor. Hipoteza është një element i rëndësishëm i hulumtimit shkencor e cila shërben për evidentimin e problematikave dhe të zgjidhjeve të mundshme që mund të ofrohen. Në këto kushte studimi ynë mbështetet në disa hipoteza të rëndësishme.

HIPOTEZA I: Legjislacioni ynë në lidhje me zbatimin e të drejtave të të burgosurve dhe respektimi i të drejtave të tyre gjatë vuajtjes së dënimit, në përputhje me parashikimet ndërkombëtare, prezantohet i plotë por i copëzuar. Disponojmë ende një legjislacion jo të plotë dhe standardizuar në lidhje me të drejtat e të burgosurve si kategoria më vulnerable dhe e rëndësishme e shoqërisë, kur pretendohet që vendi të bëhet anëtare e plotë e BE-së

HIPOTEZA II: Nevojitet një Kod i Drejtësisë për të burgosurit i cili do të parashikonte rregullat procedurale dhe do të ofronte një mbrojtje për të burgosurit në të gjitha instancat e sistemit gjyqësor, duke parashikuar dispozitat që rregullojnë llojet e dënimit si dhe masat për ekzekutimin e dënimit paraqesin gjithashtu një rëndësi të veçantë për drejtësinë e vendit.

HIPOTEZA III: Vëndosja në funksion real të të gjitha institucioneve adekuate për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve si gjatë vuajtjes së dënimit gjithashtu edhe pas vuajtjes së dënimit duke i praktikuar të gjitha masat të cilat do ndikojnë në parandalimin e përsërijes së veprave penale edhe atë duke garantuar që sistemi penal në Republikën e Maqedonisë së Veriut të shikohet në mënyrë integrale dhe multidisiplinore. Shërbimet sociale, arsimore, policia e shtetit, shërbimi i provës, e prokuroria duhet të bashkëpunojnë jo vetëm në parandalimin, por edhe në përcaktimin e masave restauruese më të përshtatshme për të burgosurit në konflikt me ligjin dhe sidomos për rehabilitimin e tyre dhe integrimin e tyre në shoqëri pas vuajtjes së dënimit.

HIPOTEZA IV. Duke vërejtur progresin në përmirësimin e kushteve në institucionet ndëshkuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh faktin se këto janë probleme sistematike që janë zvarritur në këtë zonë për një kohë të gjatë, duhet të theksohet se sistemi penitenciar ende përballet me probleme dhe sfida të mëdha, veçanërisht për sa i përket kushteve materiale, shëndetit, arsimit dhe ri-socializimit të të dënuarve.

HIPOTEZA V. Problemi me mungesën e personelit adekuat në burgje, veçanërisht kur bëhet fjalë për edukator, punonjës social dhe mjekë, në korrelacionin me programet e ri-socializimit jo-ekzistues është një problem sistematik, i cili nëse nuk adresohet si duhet, do të vazhdojë të shkaktojë pasoja negative për të burgosurit pas lirimit të tyre nga vuajtja e dënimit.

Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencorë

Qëllimi i hulumtimit shkencor është të sigurojë një përshkrim të hollësishëm faktik të kushteve dherrethanave me të cilat përballen të dënuarit në institucionet ndëshkuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Korniza metodologjike e hulumtimit bazohet në vizitën në terren në institucionin ndëshkimor në Tetovë, mbledhjen e të dhënave statistikore për periudhën 2012-2019, qëllimi i të cilit është të dokumentojë gjendjen aktuale në institucionin që është objekt i analizës dhe të vlerësojë trajtimin e të dënuarve dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, situatën në të cilën ndodhet gjendja penitenciare, kushtet e jetesës së të dënuarve, përfshirë regjimin dhe aktivitetet, higjenën dhe sigurinë shëndetësore, kontaktet me botën e jashtme, qasjen në kujdesin shëndetësor, trajtimi i tyre nga ana e zyrtarëve të burgut. Për përgatitjen e punimit të magjistraturës janë përdorur metoda të përshtatshme themelore dhe speciale të kërkimit shkencor që kërkon kjo lëmi për t'u hulumtuar, duke u nisur nga qëllimet e hulumtimit dhe nga lënda dhe përmbajtja e përcaktuar e saj. Gjatë hulumtimit të bërë për këtë lëmi janë përdorur disa metoda të cilat janë vlerësuar si më të përshtatshme për këtë hulumtim edhe atë metoda normative është përdorur në analizën e normave juridike pozitive ndërkombëtare dhe vendore që rregullojnë dhënien e përfitimeve dhe profilizimin e të burgosurve. Interpretimi juridiko-analitik i rregulloreve ligjore në lidhje me këtë çështje hulumtuese. Metoda përshkruese ka gjetur aplikim në shpjegimin dhe përshkrimin e temës së hulumtimit shkencor. Metoda krahasuese është përdorur për të krahasuar legjislacionin vendor me atë të vendeve në rajon dhe ndërkombëtarë siç janë standardet e Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Europian. Përveç pjesës teorike, punimi gjithashtu përmban një pjesë empirike që lejon të kryhet verifikim empirik, i saktë i tezave të përcaktuara dhe pikëpamjeve të deklaruara të punimit. Janë përdorur të dhënat statistikore zyrtare të marra nga burgu i Tetovës dhe Raportet Vjetore të Zyrës për Ekzekutimin e Sanksioneve të Republikës së Maqedonisë së Veriut për funksionimin dhe gjendjen në institucionet ndëshkuese dhe korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut për periudhën 2012-2019. Të dhënat e mbledhura në mënyrë empirike interpretohen me një qasje shumë të saktë dhe logjike për thelbin e dhënies së lehtësive për të burgosurit dhe profilin e tyre nga të gjitha aspektet siç janë gjinia, mosha, gjendja socio-ekonomike, edukimi, shkalla arsimore, shëndetësore etj. Metodologjia dhe metodat e kërkimit shkencor përbëjnë një nga shtyllat më të rëndësishme mbi të cilat ndërtohet studimi shkencor. Përdorimi i tyre është esencial në një hulumtim dhe përfaqëson një reflektim të logjikshëm të analizës shkencore të projektit hulumtues. Studimi ka në fokus trajtimin e konceptit të të burgosurve të të gjitha kategorive, grupmoshave, gjinive e etj, fillimin e përgjegjësisë penale, evidentimin e faktorëve që çojnë në përfshirjen e tyre në aktivitetet kriminal dhe trajtimin e kontekstit ligjor. Për të arritur objektivat e këtij studimi kemi kombinuar disa prej metodave shkencore me të përdorura, si:

Metoda historike. Përdorimi i kësaj metode synon të trajtoj historikun e të burgosurve në konflikt me ligjin penal, duke shqyrtuar për këtë qëllim ngjarjet juridike të cilat kanë hedhur dritë dhe kanë trajtuar këtë kategori subjektsh në etapa të ndryshme të zhvillimit të së drejtës vendore. Me anë të metodës historike kemi grumbulluar fakte të ndryshme të shpërndara në kohë të ndryshme, duke nxjerrë në pah përparësitë e periudhave të ndryshme kohore me qëllim evidentimin dhe konsolidimin e vlerave dhe standardeve të arritura, të cilat më pas do të krahasohen me qëllim arritjen e konkluzioneve përfundimtare.

Me anë të metodës **sintezo-analitike** janë analizuar elementët e veçantë teorikë e doktrinarë të drejtësisë për të burgosurit në përgjithësi dhe të të atyre në konflikt me ligjin penal në veçanti, të cilët të shqyrtuara në plane të veçanta dhe të përgjithshme do të ndihmojnë në mbledhjen, ballafaqimin dhe në sintezën e informacionit të të dhënave. Kjo përbën metodën themelore në të cilën do të bazohet punimi.

Përdorimi i metodës **krahasuese** synon ballafaqimin e të dhënave të grumbulluara ndërmjet tyre dhe me ato të sistemeve të drejtësinë për të burgosurit të vendeve të ndryshme në rajon dhe më gjërë. Kjo metodë do të ndihmojë për të arritur konkluzione të qarta për avantazhet e aplikimit të instrumenteve ndërkombëtare për të mbrojtur të drejtat e të burgosurve në konflikt me ligjin.

Metoda **hulumtuese** e përdorur në studim përfshin procesin e mbledhjes së materialeve në format e shkruara dhe elektronike. Hulumtimi është një proces që ka shoqëruar gjithashtu fazën e sistemimit të zërave bibliografikë në funksion të finalizimit të këtij punimi. Në analizimin e këtij fenomeni janë shfrytëzuar të dhënat e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut-Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve, rreth numrit të të burgosurve në Burgun e Tetovës për periudhën 2012-2019, të përfshirë në veprimtari kriminale si dhe llojeve të veprave penale të kryera nga këta të fundit.

Metoda e **analizës** së legjislacionit. Kjo metodë përfshin analizën e legjislacionit vendas dhe të huaj në fushën e kriminalitetit të të miturve dhe të mbrojtjes së të drejtave të tyre siç janë legjislacioni i Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe legjislacionin ndërkombëtarë dhe rajonal. Përdorimi i kësaj metode konsiston në analizën dispozitave ligjore e Kushtetuese, instrumenteve apo akteve ndërkombëtare që kanë në fokus trajtimin e të drejtave të të burgosurve dhe luftën ndaj kriminalitetit dhe rolin në uljen e tij.

Ky punim është rezultat i përdorimit të metodave **primare** dhe **sekondare**. Kështu, për të grumbulluar të dhënat primare janë shfrytëzuar të gjitha burimet institucionale në arkivat dhe të dhënat zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, të Ministrisë së Brendshme, të Prokurorisë së Përgjithshme - Burgut të Tetovës dhe legjislacioni në fuqi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

KAPITULLI I

ORGANIZIMI I INSTITUCIONEVE PENITENSIARE NË MAQEDONI

1.1 Aspekti historik i institucioneve penitensiare

Trajtimet dhe studimet penologjike që herët kanë synuar njohjen dhe studimin e ekzekutimit të dënimeve dhe sanksioneve tjera penale me qëllim të parandalimit të kriminalitetit, rruga e paraqitjes së këtyre mendimeve ka kaluar nëpër tre faza kryesore: në fazën e parë e cila daton nga fundi i shekullit të 18 rastet të cilat kanë pasur të bëjnë me dënimet dhe ekzekutimin e tyre zakonisht janë trajtuar në kuadër të së drejtës penale. E ditur se privimi nga liria sikur edhe burgjet e asaj kohe më tepër shërbenin për ndaljen e delukientit të pandehurit derisa të gjykohej ose derisa të bëhej ekzekutimi i dënimit fizik apo dënimit me vdekje. ¹ Sipas burimeve nga literatura e historisë së penologjisë në rendin feudal dënimet kryesore dhe më të shpeshta ishin dënimet trupore ose dënimet me vdekje e kësisoj sipas të dhënave nga Arkivi i inkuizicionit spanjoll gjatë shekullit të XV-XVI me dënim me vdekje ose me tortura të rënda fizike janë dënuar më tepër se 300 mijë persona. ² Ndërsa sipas burimeve angleze në shekullin e XVIII në Angli dënimi me vdekje ka qenë i paraparë për më tepër se 200 vepra penale. ³ Juristi dhe gjykatësi i njohur gjerman nga shekulli i XVII Karpov shkruante se në karrierën e tij si gjykatës ka shqiptuar rreth 20.000 dënime me vdekje. ⁴ Institucionet korrektuese krahas kategorizimit dhe ndarjes së tyre sipas kriterëve të ndryshme si: themeluesit, shkallës së sigurisë, llojit të personave të cilët mbajnë dënimin në ato kanë edhe komponencën e vet e cila ka të bëjë me organizimin dhe strukturën e organeve dhe shërbimeve kryesore mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, organizimi dhe struktura e këtyre institucioneve ka ndikim të madh në realizimin e qëllimeve dhe programit të tretmanit të personave të dënuar. Në shumë vende të botës problematika e ekzekutimit të sanksioneve penale udhëhiqet nga Ministria e drejtësisë apo nga departamenti në kuadër të saj që ushtrojnë kontrollë dhe mbikqyrje në zbatimin e ligjit në këtë fushë. Edhe Republika e Maqedonisë së Veriut ka përvetësuar të njejtën praktikë që zbatohet në shumë vende të botës dhe me themelimin e Ministrisë së drejtësisë dhe reformës ligjore e cila ka kompetencë për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit dhe nxjerrjen e akteve nënligjore. ⁵

¹ H.D. Schwind und Gunter Blau, vep.e cit fq. 2-4

² G.Ponti, vep.e.cit fq. 387-393

³ Noval Morris and David I. Rothman: The Oxford history of the prison – The practice of punishment in Western Society, New York, 1998, fq. 28-32

⁴ D.Atanackovic, Penologija, Beograd 1988, fq. 4-5

⁵ Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale, neni 205, paragrafi 1

Shërbimet e zbatimit të sanksioneve si institucione penitensiare janë përgjegjës për:

- Organizimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e ekzekutimit të dënimit me burg dhe burgim të përjetshëm,
- Organizimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e burgimit të të miturve dhe masave edukuese,
- Organizimin e programeve që i kontribuojnë korrektimit, rehabilitimit dhe riintegrit të personave të dënuar, përgaditjes për lirim dhe mbikqyrjes afatgjate të personave të dënuar me burg dhe me burgim të përjetshëm,
- Vlerësimin e rrezikut kriminogjen dhe për caktimin e nevojave për trajtim të kryesve të veprave penale,
- Udhëzimin dhe mbështetjen ndaj personave të dënuar në përfundim të dënimit, personelit civil dhe zyrtarëve të korrektimit, dhe
- Bashkëpunimin me institucionet përkatëse, shoqatat dhe organizatat të cilat meren me problemet e ekzekutimit të sanksioneve penale.

Shërbimi i sigurimit është një ndër shërbimet kryesore dhe të domosdoshme në secilin ent. Ky shërbim ka për detyrë sigurimin e kushteve dhe rrethanave për funksionimin normal të jetës dhe punës së të gjitha shërbimeve të tjera, ky shërbim ka për detyrë për të siguruar dhe mbrojtur institucionin nga atakimet e jashtme por edhe me ato brenda institucionit. Ka personel të pajisur dhe të aftësuar për kryerjen e detyrave të sigurimit të entit. Shërbimi i riedukimit është një ndër shërbimet më të rëndësishme në të gjitha institucionet korrektuese.⁶ Ky shërbim është i degëzuar dhe në vete përfshinë disa sektorë. Në kuadër të këtij shërbimi gjendet shërbimi ose sektori i pranimit, sektori i studimit dhe observimi, sektori i klasifikimit, sektori i arsimit dhe shkollimit, sektori për aktivitete të lira dhe gara sportive. Sipas një përkufizimi më sintetik, një institucion është një “rregull loje” e pranuar shoqërisht. Secili institucion nënkupton një tërësi normash, të cilat individët duhet ti zbatojnë. Të tilla norma mund të jenë me natyrë morale, zakone të vendit dhe norma të shtetit⁷. Gjithashtu ato janë parime themelore juridike të shtetit dhe janë organizmat politike kushtetuese që i shprehin ato. Kur është fjala për struktura dhe mekanizma të rregullit shoqëror, institucionet janë objekt i studimit të shkencave shoqërore: të sociologjisë, shkencave politike dhe ekonomike. Ndër kushte themelore të individualizimit të tretmanit dhe ekzekutimit të suksesshëm të dënimit me burgim është dhe klasifikimi dhe kategorizimi i institucioneve korrektuese. Me klasifikimin dhe kategorizimin e institucioneve korrektuese nënkuptohet themelimi i institucioneve të llojllojshme me qëllim të zbatimit të tretmanit dhe përshtatjes më të suksesshme të kërkesave për riedukim dhe riintegrim të personave të dënuar. Klasifikimi dhe kategorizimi i

⁶ Dr. Hana Korac – Penologjia (prvo izdanje) Sarajevo 2009, fq. 54

⁷ Dr. Ragip Halili, Penologjia – Prishtinë 2014, fq. 43

institucioneve do të thotë ndarja e institucioneve në lloje të ndryshme sipas disa kriterëve të cilat zakonisht rregullohen me ligje apo dispozita të tjera të secilit shtet. Klasifikimi dhe kategorizimi i institucioneve korrektuese bëhet me qëllim që observimi dhe klasifikimi i personave të dënuar tani të sendërtohet në praktikë. Për këtë arsye me të drejtë në literaturën penologjike thuhet se: observimi studimi shkencor, klasifikimi i personave të dënuar dhe vetëkategorizimi i institucioneve korrektuese paraqesin një tërësi të masave dhe metodave të organizuara dhe të planifikuara të një tretmani më adekuat me qëllim të riedukimit dhe riintegrit të suksesshëm të personave të dënuar.⁸ Klasifikimi dhe kategorizimi i institucioneve ndërshtetë – përmirësuese është i kohës së re. Nevoja për ndarjen dhe kategorizimin e institucioneve paraqitet atëherë kur ndërton dhe qëllimi e arsyeja e dënimit, në përgjithësi dhe e dënimit me burgim në veçanti. Në kohën kur ndërshtetë kishte për qëllim hakmarjen, shpëtimin, retribucionin, atëherë ekzistonin institucione korrektuese klasike të tipit të burgut kolektiv apo burg të qelisë ose të burgut të mbyllur. Siç dihet, atëherë nuk ka pasur studim ose observim shkencor kriminologjik por ka ekzistuar një ndarje elementare e personave të dënuar e cila nuk i ka kushtuar kujdes riedukimit dhe riintegrit. Më vonë me depërtimin e ideve të shkollave të ndryshme juridiko-penale dhe kriminologjike parashtrihen kërkesat për studim dhe njohje të gjithanëshme të personalitetit të delikuentit dhe të të dënuarit. Në këtë kohë shtrohet dhe nevoja e klasifikimit dhe e kategorizimit të institucioneve korrektuese duke iu përshtatur kërkesave dhe synimeve bashkëkohore për realizimin e qëllimit të dënimit e ai ishte risocializim dhe pengim i kriminalitetit, rruga e depërtimit të ideve të klasifikimit ka qenë e gjatë dhe e vështirë, edhe sot e kësaj dite ka shtete të cilat ky kategorizim nuk ka depërtuar dhe më tej aplikohen metoda të sistemeve të vjetra klasike, zakonisht klasifikimi bëhet në bazë të kriterëve objektivë, psh. Lloji i veprës penale, lloji i dënimit, lartësia e dënimit, mosha dhe gjinia.⁹ Ndonëse në penologjinë moderne është e klasifikimit dhe e kategorizimit të institucioneve është çështje me rëndësi në praktikën penitensiare në shumë vende vërehen edhe më tej ngecje në drejtim të klasifikimit dhe kategorizimit të tyre. Sipas të dhënave të shoqatave dhe asociacioneve ndërkombëtare që trajtojnë problematikën e ekzekutimit të dënimeve me burgim dhe organizimin e institucioneve korrektuese në praktikë ende nuk ka depërtuar fryma e organizimit dhe klasifikimit të institucioneve sidomos paraqitja e institucioneve të specializuara. Posaçërisht vërehet një tendencë e rikjes së klasifikimit dhe kategorizimeve në bazë të kriterëve bashkëkohore dhe kombini i sistemeve të vjetra me sisteme të reja. Kështu ende dominojnë institucionet korrektuese të karakterit të përgjithshëm me disa paralele dhe repartee të specializuara. Siç dihet, ekziston një lloj kompromisi dhe një simbiozë e institucioneve klasike me disa repartee dhe paralele të institucioneve bashkëkohore. Mirëpo, pa marrë parasysh këtë gjendje, vërehet një përprerje gjithnjë e më e fuqishme e themllimit të institucioneve të specializuara të cilat i

⁸ R.Mlagjenoviq-Kupceviq. Vep.e cit.fq 174-175

⁹ D.Davidovic, O.Matic e tjerë: Kategorizacija kazneno-popravnih domova i klasifikacija osudjenih lica, Beograd, 1970, fq. 25-27

përshtaten dhe klasifikimit të personave të dënuar. Besohet se në të ardhmen prespektiva e institucioneve korektuese duhet të jetë themelimi i institucioneve të specializuara. Që tani, në disa shtete perendimore vërehen disa hapa konkret dhe mjaft inkurajues të kategorizimit dhe klasifikimit të institucioneve korektuese si në Francë, Belgjikë, Itali, Holandë, Suedi etj. Sipas ligjit mbi ekzekutimin e sanksioneve penale kompetencat dhe përgjegjësitë për organizimin, zbatimin dhe ekzekutimin e sanksioneve penale i bartë Shërbimi korektues dhe Shërbimi sprovues.¹⁰

Sipas ligjit në fjalë (neni 208) llojet e institucioneve korektuese janë:

1. Burgje për ekzekutimin e dënimit me burgim dhe me burgim të përjetshëm,
2. Qendra të paraburgimit për ekzekutimin e paraburgimit dhe dënimeve të burgimit deri në 3 muaj,
3. Burgje për femra për ekzekutimin e dënimit me burgim, burgim për të mitur të shqiptuar ndaj femrave,
4. Burgje për të mitur, për ekzekutimin e burgimit të të miturve,
5. Institucione educative korektuese për ekzekutimin e masave edukative,
6. Spitale dhe ambulancat e burgjeve, për trajtimin e të paraburgosurve dhe personave të dënuar.

Ndarja dhe kategorizimi i institucioneve apo institucioneve ndërkimtare përmirësuese bëhet sipas kriterëve të ndryshme. Në këtë drejtim flitet për kategorizimin e institucioneve sipas organizimit horizontal dhe vertikal. Pastaj ndarja e institucioneve në ente të përgjithshme dhe të vecanta. Ndarja në ente dhe burgje. Nga ana tjetër sipas moshës dhe kategorisë së personave të cilët e mbajnë dënimin kemi ndarjen e institucioneve në institucione korektuese dhe në ente educative përmirësuese për të rritur. Sipas gjinisë, entet ndahen në ente për femra dhe ente për meshkuj, sipas rajonit ato mund të jenë ente komunale, rajonale, republikane dhe federale. Sipas shkallës së sigurisë mund të jenë të tipit të mbyllur, gjysëm të hapur dhe të hapur.¹¹ Në këtë drejtim flitet për ente speciale për të mitur, të rinjë, ente speciale për të mitur të rritur, ente speciale për recidivistë, ente speciale për të dënuar nga shpëritë dhe kariera, ente speciale për të dënuar për delikte në trafikun rrugorë, ente speciale për personat e sëmurë që kanë kryer krime, ente speciale për shërimin dhe rehabilitimin e të dënuarve alkoolistë dhe narkomanë, ente speciale për të dënuar me crregullime mentale etj.¹² Burgjet janë institucione të themeluara në qendra komunale apo rajonale ku zakonisht bëhet ekzekutimi i dënimit me burgim me kohëzgjatje të shkurtër. Këto dënime me burgim mund t'i shqiptojnë gjykatat e rregullta dhe për kundërvajtje. Historikisht,

¹⁰ Dr. Hana Korac – Penologija (prvo izdanje) Sarajevo 2009, fq. 56

¹¹ R.Mlagjenović-Kupcević. Vep.e cit.fq 174-175

¹² Dr. Ragip Halili, Penologija – Prishtinë 2014, fq. 45

dallimi midis epokave ose periudhave të ndryshme, nënkupton një ndryshim të madh dhe themelor në sistemin e institucioneve që qeverisin shoqërinë. Ngjarjet politike dhe ushtarake vlerësohen me rëndësi historike nëse shoqërohen me ndryshime të institucioneve. Në historinë evropiane një rëndësi të veçantë ka patur tranzicioni i gjatë të institucioneve feudale të Mesjetës në institucionet moderne, që qeverisin jetën bashkëkohore. Institucionet formale grupohen në dy kategori: institucionet ekonomike dhe institucionet politike. Institucionet ekonomike përcaktojnë rregullat që rregullojnë bashkëveprimet njëzore në fushën ekonomike, ndërsa institucionet politike përcaktojnë këto rregulla në fushën politike. Për sa i përket institucioneve politike, zakonisht pranohet përkufizimi që lidhet me institucionet demokratike: ato janë rregullime institucionale përgjithësisht të pranura në një sistem politik që lejojnë të marrin vendime politike dhe në të cilat personat drejtues e marrin pushtetin e vendimarrjes nëpërmjet garave elektorale. Në praktikë institucionet demokratike janë të lidhura me ekzistencën e zgjedhjeve të lira dhe të drejta, përgjegjësinë e politikanëve kundrejt zgjedhësve dhe me pjesëmarrjen e lirë të qytetarëve në aktivitetet politike. Në kuptimin juridik, një institucion publik është një person juridik i cili në veprimtarinë e vet financohet nga fonde publike dhe kontrollohet nga shteti. Drejtim një institucioni publik mund të bëhet nëpërmjet një personi të vetëm ose prej një bordi apo Këshilli administrativ, anëtarët e të cilit janë të gjithë nëpunës të shtetit dhe të emëruar prej tij për një periudhë kohe të caktuar. Veprimtaria e institucioneve politike është objekt i së drejtës kushtetuese, ndërsa veprimtaria e institucioneve publike është objekt i së drejtës civile. Institucionet Publike kanë një vlerë jashtëzakonisht të madhe për një komb. Në qoftëse ato përdoren në mënyrë të përshtatshme për hartimin e politikave, për zbatimin dhe administrimin e tyre, atëherë institucionet publike do të jenë po aq të rëndësishme për zhvillimet dhe perspektivën kombëtare, sa ç'janë edhe burimet ekonomike natyrore. Problemi shtrohet se sa saktë ndërtohen këto institucione me qëllim që të funksionojnë në mënyrë sa më efektive perspektivat administrative dhe manaxheriale. Aktivistët e organizatave, që punojnë në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, pranojnë një sërë ndryshimesh pozitive në kushtet e të burgosurve dhe të paraburgosurve, por ende ata ngrenë probleme serioze. Një nga 12 pikat, që duhet të plotësoj vendi për anëtarësimin e saj në BE, është dhe përmirësimi i standardeve në sistemin e institucioneve penitenciare, pra në ambientet e burgimit dhe të paraburgimit. Aktivistët e organizatave, që punojnë në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut, pranojnë një sërë ndryshimesh pozitive në kushtet e të burgosurve dhe të paraburgosurve, por ende ata ngrenë probleme serioze në mënyrën e trajtimit dhe të kushteve të jetësës së tyre. Një prej tyre lidhet me gjendjen e strehimit dhe të trajtimit të atyre të dënuarve, që janë të sëmurë, apo janë në moshë të thyer. Sistemi i institucioneve penitenciare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, si autoritetet administrative, që njihen me ligj për të ekzekutuar vendimet e dhëna nga gjykata për ruajtjen dhe mbikëqyrjen e personave, aktualisht përfshin 11 ambiente burgimi dhe paraburgimi 1 burg për të mitur në Tetovë dhe një repart për të mitur në kompleksin e burgut "Idrizovë". Sipas raportit për statistikat kriminale vjetore të Këshillit të Evropës për vitin 2018, Republika e Maqedonisë së Veriut ndjek trendin

Evropian për të ulur normën e përgjithshme të mbyllur. Ndërsa në nivelin e gjithë Evropës norma u ul me 6.6 përqind në periudhën midis 2016 dhe 2018, duke kaluar nga 109.7 në 102.5 të burgosur për 100,000 banorë, Maqedonia e Veriut është ndër vendet ku kjo normë ra më së shumti -9.7 përqind. Ose shprehur në numra në Maqedoninë e Veriut në të gjitha burgjet sot vuajnë dënimin rreth 2200 të burgosur (shënimi ynë). Duke vënë në dukje progresin në përmirësimin e kushteve në institucionet ndëshkuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh faktin se këto janë probleme sistemike që janë zvarritur në këtë zonë për një kohë të gjatë, duhet të theksohet se sistemi penitenciar ende përballet me probleme dhe sfida të mëdha, veçanërisht për sa i përket kushteve materiale, shëndetit, arsimit dhe rishoqërimit të të dënuarve. Për sa i përket aftësisë hapësinore, kushteve materiale dhe higjiena, u dokumentua se për shkak të mbipopullimit në burgun e Shtipi, dhomat e përcaktuara si izolim i vetëm përdoren si dhoma të jetesës për të dënuarit.¹³ Dhomat ku ndodhen të dënuarit nuk kanë dritë të mjaftueshme ditore, ato kanë ajrim jo adekuat, gjë që shkakton praninë e një erë të pakëndshme. Dhomat e brendshme kanë banjot brenda që janë të mbuluara me një perde dushi dhe shishe uji janë gjetur shpesh brenda birës së tyre për të zvogëluar aromën në dhomë. Situata rreth kushteve të të burgosurve nuk është më e mirë edhe në vendet e rajonit siç është Shqipëria, Kosova, Serbia apo gjetiu, një situatë e vështirë dhe me kushte shumë të këqija hetohet edhe në burgjet shqiptare prandaj, apelohej se prokuroria dhe gjykata duhet të jenë të vëmendëshme ndaj personave, që sëmuren gjatë kohës, kur ata janë duke vuajtur dënimin, si dhe ata që kur kanë kryer veprën penale kanë rezultuar me fakte se janë të sëmurë mendorë. Trajtimi i këtyre të fundit duhet të jetë, sipas Komitetit të Helsinkit, në bazë të ligjit pa u sistemuar në ambjentet, ku qëndrojnë të burgosur ose parabugosur të tjerë. Deri më tani janë evidentuar 70 persona, ndaj të cilëve nuk zbatohet procedura e mjekimit për diagnozën, që kanë dhe për këtë Komiteti Shqiptar i Helsinkit është duke negociuar me autoritetet që të ketë sa më parë një zgjidhje ligjore dhe konform konventave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.¹⁴

¹³ R.Mlagjenoviq-Kupceviq. Vep.e cit.fq 174-175

¹⁴ Dr. Hana Korac – Penologija (prvo izdanje) Sarajevo 2009, fq. 59

1.2 Parimet e organizimit të institucioneve penitensiare ¹⁵

Avancimi i sistemit gjyqësor dhe funksionimi i tij paraqet një parakusht kyç për zhvillimin e Republikës së Maqedonisë se Veriut si një shtet demokratik juridik dhe një shoqëri multi-kulturore e të drejtave dhe lirive të barabarta të qytetarëve dhe për integrimin e saj euroatlantik. Ndërtimi i një sistemi të gjyqësisë dhe institucioneve të pavarura dhe të paanshme që gravitojnë drejt realizimit të funksionit të drejtësisë efektive, cilësore dhe të barabartë, është një postulum qendror i parimit të sundimit të ligjit dhe një zhvillim human dhe i qëndrueshëm i shoqërisë në Maqedoni si një komuniteti i bazuar mbi në të drejtën legjitime duke respektuar vlerat më të larta civilizuese. Vlerësimet për situatën që arsyetojnë miratimin e Strategjisë korrespondojnë me vlerësimet e KE në raportet e progresit të Republikës së Maqedonisë në vitet e fundit, Rekomandimet e grupit të ekspertëve të lartë për çështje sistematike për sundimin e ligjit në lidhje me komunikatat e përgjuara që u shpalosën në pranverë të vitit 2015, qershor 2015. Rekomandimet e grupit të lartë të ekspertëve për çështje sistematike dhe sundimi i ligjit të shtatorit 2017, reformat urgjente prioritare të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë në qershor 2015, Përgatitja e Programit të BE-së për mbështetjen e sektorit gjyqësor, korrik 2014 (në tekstin e mëtejshëm MK Vlerësimet), praktika e GJEDNJ e shprehur nëpërmjet gjykimeve kundër Republikës së Maqedonisë, Raporti i GRECO Vlerësimi për Republikën e Maqedonisë - raundi i katërt, dhjetor 2013, Raport mbi pajtueshmërinë e GRECO për Republikën e Maqedonisë - raundi i katërt, korrik 2016, Komisioni Evropian për efikasitetin e drejtësisë (CEPEJ) - Raport për vlerësimin e sistemeve gjyqësore evropiane dhe efikasitetin dhe cilësinë e drejtësisë - edicioni i fundit në vitin 2016 (të dhënat e 2014), Mendimi i Komisionit të Venedikut për ligjet mbi përgjegjësinë disiplinore dhe vlerësimin e gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë, në dhjetor 2015, Raportet nga misioni i kryer i vlerësimin në vitin 2012 (Luka Perili Efektiviteti gjyqësori, Xhems Voelg Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit). Baza për përgatitjen e kësaj strategjie ishte Draft Strategjia për reformën e sektorit gjyqësor, e përgatitur në kuadër të projektit IPA 2010 "Mbështetje e mëtejshme për gjyqësorin e pavarur, të përgjegjshëm, profesional dhe efikas dhe futjen e shërbimit të provës dhe sanksioneve alternative" dhe raportet nga IPA projekte të tjera. Vendosjen e saj në rrugën e standardeve evropiane dhe ndërkombëtare dhe funksionimin e saj stabil si shtyllën kryesore të sundimit të shtetit demokratik juridik. ¹⁶

- Vendosja e parimit të sundimit të ligjit si parimi më i lartë politik dhe ligjor në rregullimin e marrëdhënieve midis tre mbajtësve të pushtetit, duke respektuar pavarësinë, paanshmërinë dhe integritetin e pushtetit gjyqësor.

- Largimi nga rendi ligjor i ligjeve që rrezikojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe gjyqtarëve dhe autonominë e prokurorisë publike.

¹⁵ Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, 2014 Prishtinë, fq. 14-18

¹⁶ D. Atanackovic – Penologjia, 1988 Boegrad, fq. 4-5

- Heqja dhe korrigjimi i rendit juridik të vendimeve ligjore që bllokojnë ushtrimin e funksionit të kontrollit gjyqësor mbi ligjshmërinë e sjelljes së pushtetit ekzekutiv dhe të administratës shtetërore;
- Rivlerësimi i funksionimit të institucioneve të caktuara, në veçanti Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publik, kompetencat kushtetuese dhe ligjore e të cilave janë garanci për sigurimin e pavarësisë dhe efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike;
- De-profesionalizimi dhe përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për përgjegjësinë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publik;
- Reforma e gjyqësorit administrativ me qëllim të realizimit efikas të funksionit të tij dhe kontrollit mbi aktet e pushtetit ekzekutiv dhe të administratës shtetërore;
- Forcimi i funksionimit të PSP si një institucion i pavarur brenda PP-së në trajtimin e akteve të kompetencës së saj dhe ndjekjes penale të veprave penale të profilit të lartë "krim i bardhë";
- Rivlerësimi i sistemit gjyqësor dhe sistemit të prokurorisë publike nga aspekti i rrjetit dhe kompetencave të institucioneve, ekipimit të tyre kadrovik dhe material;
- Krijimi i parakushteve financiare, personale, informatike dhe të tjera, rritje urgjente të investimeve buxhetore, me qëllim të rritjes së efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike. Rishqyrtim i sistemit të vlerësimit e të kualitetit dhe efikasitetit të veprimeve të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë;
- Thjeshtimi i qasjes në drejtësi nëpërmjet forcimit të ndërmjetësimit, shqyrtimit të ndihmës juridike falas, shpenzimeve gjyqësore, tarifave të avokatëve dhe kostove të tjera;
- Përhapja e funksioneve të sistemit gjyqësor dhe sistemit të informimit të prokurorisë publike;
- Forcimi i sistemit të edukimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve të gjykatësve, prokurorëve publikë dhe avokatëve
- Forcimi i mekanizmave të transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë përmes sistemit të vetë-rregullimit të shoqatave të tyre profesionale.
- Evropianizimi i gjyqësorit dhe i prokurorisë publike nëpërmjet futjes së standardeve evropiane ligjore, si dhe menaxhimeve dhe standardeve të tjera institucionale dhe procedurale në funksionimin e gjyqësorit, prokurorisë publike dhe avokaturës; përgatitja e gjyqtarëve dhe prokurorëve publik për funksionimin e tyre në zonën e vetme evropiane të drejtësisë dhe zbatimin e vazhdueshëm të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut dhe konventa të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, harmonizimin e ligjeve materiale dhe procedurale me ligjet e BE-së dhe harmonizomi me ligjet e shteteve anëtare të BE.

1.3 Parimi i ligjshmërisë¹⁷

Konceptin themelor të së drejtës penale në RMV dhe esencën e institutive të saj e përcaktojnë disa parime mbi të cilët është bazuar e drejta penale bashkëkohore. Me rëndësi parimore është parimi i ligjshmërisë: nuk ka vepër penale, nuk ka dënim apo sanksion tjetër penalo-juridik pa ligj (nullum crimen, nulla poena sine lege). ‘Askujt nuk mund t’i shqiptohet dënim ose ndonjë sanksion tjetër penale për vepër, e cila para se të kryhet nuk ka qenë e caktuar me ligj apo me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën si vepër penale dhe për të cilën nuk ka qenë i paraparë dënim me ligj.¹⁸ Nën nivelin e definimit ligjor është proklamimi kushtetues i këtij parimi (Kushtetuta, n.14 p.1), sipas të cilit ‘askush nuk mund të dënohet për vepër, e cila para se të kryhet nuk ka qenë e paraparë me ligj ose me dispozitë tjetër si vepër penale dhe për të cilën nuk është përcaktuar dënim’. Dënimi kushtetues lejon pikërisht që vepra penale të përcaktohet edhe me dispozitë tjetër e jo vetëm me ligj që në dispozita të tjera kushtetuese shprehimisht është demantuar: sipas prezumimit të pafajësisë (Kushtetuta, n.13) ‘personi i akuzuar për vepër penale do të llogaritet si i pafajshëm përderisa faji i tij nuk vërtetohet me vendim të plotëfuqishëm kurse nga ana tjetër (Kushtetuta, n.98 p2) gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve dhe marrëveshjeve të ratifikuara ndërkombëtare që do të thotë jo edhe në bazë të ndonjë dispozite tjetër. Gjithashtu, definimi kushtetues i gabuar është në kolizion edhe me vlerën themelore të shtetit juridik liberal (Kushtetuta, n.8 p2) sipas të cilit në RM gjithcka është e lejuar nëse me Kushtetutë dhe ligj nëse nuk është e ndaluar që do të thotë se asgjë nuk mund të ndalohet me ‘dispozitë tjetër’.¹⁹ Parimi i ligjshmërisë ka rëndësi të postulatit elementar, përcaktim themelor i së drejtës penale si e drejtë e bazuar në ligj. E drejta për dënim del nga vullneti i qytetarëve të cilët shtetit i bartin autorizime të kufizuara për shpallje të disa sjelljeve si sjellje ndërshkuese dhe ndëshkimin e kryer të tyre. Si akt për legjitimim dhe vetëkufizim të së drejtës shtetërore për ndëshkim, ligji njëkohësisht është garant për liritë dhe të drejtat e njeriut dhe mbrojtës nga cdo autokraci, në lloj kriminaliteti apo keqpërdorimi të pushtetit.²⁰ E gjithë kjo con në kërkesën që e drejta penale të jetë e drejtë ligjore. Ligji është burim themelor i së drejtës penale. Vetëm ligji, i cili është shprehje e vullnetit të përgjithshëm dhe miratohet në procedurë demokratike parlamentare mund të ketë funksion të tillë, kurse ndalesat dhe sanksionet e tij të gëzojnë përkrahje të përgjithshme.²¹ Pranimi i parimit të ligjshmërisë sipas kësaj nuk është çështje e zgjidhjes së lirë apo e vullnetit arbitrar të ligjdhënësit. Secili shtet që do t’i takojë rrethit të popujve të civilizuar dhe të shteteve demokratike thjeshtë patjetër të përcaktohet dhe të sigurojë respektim të këtij parimi. Është e pakontestueshme se sot parimi i ligjshmërisë paraqet rrjedhshmëri të përgjithshme civilizuese, standard

¹⁷ Dr Vlado Kambovski & Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Tetove, fq. 38

¹⁸ Kodi penal i R.Maqedonisë, n.1 Kushtetuta e R.Maqedonisë. n.14

¹⁹ Dr Shefqet Muci – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, 2012 Tiranë fq. 52-55

²⁰ Volter: ‘të qenit të lirë, varet vetëm nga ligji’

²¹ Dr. Vlado Kambovski, (fq. 6 & 240)

që ka domethënie të ius cogens për secilin shtet bashkëkohor. Konsekuencat themelore juridiko-penale e parimit të parimit të ligjshmërisë janë: kërkesa për përcaktimin e veprës në ligj, kërkesa për dënim dhe sanksione të tjera, ndalimi i analogjisë, ndalimi prapaveprues i ligjit etj. Rëndësinë e vet primare, ky parim e shter nëpërmjet detyrës së ligjdhënësit të përcaktojë veopra penale dhe dënime që janë të domosdoshme, në mënyrë që të menjanojë të gjitha dilemat se vallë çka është e ndaluar dhe cfarë pasoja juridike e godasin kryerësin e veprës.²² Përmbajtja e parimit të ligjshmërisë përcakton në rradhë të parë dy kërkesat themelore: përcaktimin e figurës ligjore dhe ndalimin e veprimit retroaktiv të ligjit. Parimi i të caktuarit të figurës ligjore obligon ligjdhënësin të përcaktojë përskrime të qarta dhe precise të veprave penale dhe të gjithë prezumimeve për ndërskrimine tyre (nullum crimen, nulla poena sine lege stricta et certa), figura ligjore dhe të gjithë prezumimet për ndërskrimin duhet të përcaktohen ashtu që për secilin qytetar si dhe për organet shtetërore që zbatojnë ligjin duhet të jetë e qartë se cilat sjellje dhe me cilat prezumime vjen në ndeshje me ligjin. Në një shoqëri demokratike rëndësi të madhe ka mbrojtja dhe sigurimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe të shtetasit, përfshirë dhe të drejtën më kryesore për jetë dhe të drejtën të bëjmë me mbrojtjen e shëndetit, lirisë, nderit dhe dinjitetit të personit, personi i privuar nga liria ka të drejtë të kompensimit të dëmit dhe të drejtat tjera të përcaktuara me ligj (neni 13 i Kushtetutës së RM), askush nuk mund të dënohet për vepër e cila para se të jetë e kryer nuk ka qenë e përcaktuar me ligj.²³ Kërkesa për përcaktimin e figurës ligjore është në funksion të realizimit konsekuent të parimit të ndarjes së pushtetit:²⁴ nëse ligji lejon disa elemente të veprës penale të precizojë vetë gjykata, kjo do të thotë se ajo e merr rolin e ligjdhënësit. Përcaktimi i ndalesave ligjore jo të qarta do të thotë se ligjdhënësi ia ka lënë gjykatës caktimin e kufirit në mes të asaj se cka është ndëshkuese dhe jo ndëshkuese, kurse procedura e tillë do të dërgojë në një pasiguri juridike.²⁵ Norma ligjore, nënkupton edhe të caktuarit précis të dënimit apo snaksionit tjetër. Sipas sistemit të dënimeve relativisht të caktuara për cdo vepër penale, ligjdhënësi vendos një dënim në disa korniza të caktuara (për shembull një dënim prej një deri në pesë vjet burgim) në të cilin gjykata duhet të përshtatë dënimin, duke e njohur vendin, rrethanat relevante rast për rasti. Ndalimi për veprimin retroaktiv të ligjit penal është në funksion të garantimit të sigurisë juridike të qytetarit. Ligjdhënësi nuk guxon të shkelë këtë vlerë të jashtëzakonshme juridike – sigurisë juridike, duke parashikuar mundësinë e një ndalesë penalo-juridike të zgjerohet edhe në veprimet e kryera para hyrjes së saj në fuqi. Ndalesë të tillë përmban edhe Kushtetuta në lidhje me të gjithë ligjet dhe dispozitat tjera (n.52 p.4 ndalesa për veprim retoraktiv të ligjit, përvec kur është më i favorshëm për qytetarët). Konsekuencat e drejtëpërdrejta juridiko-penale të parimit të ligjshmërisë është dhe ndalimi i analogjisë me të cilën nënkuptohet se një vepër penale e cila nuk është e paraparë në ligj të konsiderohet si e tillë në bazë të ngjajshmërisë me veprën penale. Me ligjshmeri kuptohet kërkesa për

²² Mayer, 1, 264, Geerds, 409, Jescheck-Weigend, 133

²³ Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale pjesa e posacme , Tetovë 2007, fq. 33-34

²⁴ Kodi penal i R.Maqedonisë, n.1 Kushtetuta e R.Maqedonisë. n.14

²⁵ Renoul, 22

respektimin e përpiktë dhe pa kushte të Kushtetutes, ligjeve dhe akteve nënligjore nga ana e të gjithë organeve shtetërore, personave zyrtar, organizatave shoqërore dhe shtetasve në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Parimi i ligjit penal ka historinë e vet si në ligjin tonë, aq më saktë, në sistemin tonë juridik. Teoria e së drejtës penale në ish-Jugosllavi, që do të thotë para Luftës së Dytë Botërore, kishte një qëndrim pozitiv për këtë çështje. Përkatësisht, duke mbrojtur zbatimin e parimit të lirisë personale, përpjekjet ishin për të zbatuar parimin e ligjshmërisë, parimin e ligjshmërisë dhe në fushën e ligjit penal. Sanksionimi dhe zbatimi i vazhdueshëm i këtij parimi mundësoi një siguri më të përshtatshme dhe më cilësore të qytetarëve, në fakt siguri juridike të secilit individ. Me fjalë të tjera, parimi i ligjshmërisë kundërshton gjithashtu ligjin e vjetër jugosllav të gjykimit arbitrar dhe arbitrar. Përcaktohet me tezën se veprat penale mund të përcaktohen vetëm me ligj. Përcaktimi ligjor i veprave penale është një element ligjor për çdo krim.²⁶ Me këtë përcaktim, ligji penal i Jugosllavisë së vjetër ndalon gjithashtu përdorimin e doganave dhe praktikës gjyqësore si burim sigurie të veprave penale.²⁷ Parimi i ligjshmërisë në përcaktimin e veprave penale shprehet edhe në zhvillimin e pas luftës së sistemit juridik dhe politik të Republika e Maqedonisë. Si fjalë kyçe dhe institucione kryesore, ne i nënvizojmë ato, si më poshtë. Në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal të vitit 1947, zbatimi i parimit të ligjshmërisë sanksionohet në një mënyrë të përshtatshme. Sidoqoftë, i njëjti parim u zbatua me aplikimin e njëkohshëm të analogjisë në përcaktimin e veprave penale dhe sanksioneve penale. Në vitin 1951, analogjia dhe zbatimi i saj në përcaktimin e krimeve u braktisën. Rregulli, një pjesë integrale e parimit të ligjshmërisë, ishte se e drejta penale nuk do të zbatohet për krimet e kryera para hyrjes në fuqi të saj. Ka pasur edhe një devijim nga masat e sigurisë. Përkatësisht, për një periudhë të caktuar kohore ekzistonte mundësia për të zbatuar masa sigurie edhe kur ato nuk ishin të përcaktuara në kohën e kryerjes së krimit.²⁸ Nga aktet kushtetuese është e rëndësishme të analizohen vendimet e Kushtetutës së ish-RSFJ-së nga viti 1963. Dispozitat e nenit 49/2 nënvizojnë se veprat penale dhe sanksionet penale mund të përcaktohen vetëm me ligj.²⁹ Pas miratimit të kësaj Kushtetute, rregullore të ngjashme shënohen në kushtetutat e njërive federale të ish-Jugosllavisë. Në Kushtetutën e fundit të Republikës së Maqedonisë, të miratuar në 1974, e treta me radhë, e miratuar në kohën e hyrjes në fuqi të "ligjit socialist", hasim dhe lexojmë të njëjtën dispozitë me një përkufizim shumë të qartë. Përkatësisht, është çështje e përcaktimit kushtetues që veprat penale dhe sanksionet penale përcaktohen vetëm me ligj.³⁰ Pas pavarësisë së Republikës së Maqedonisë, u miratua Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë nga 1991. Pjesa normative e Kushtetutës nënvizon se Republika e Maqedonisë është një shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe shoqërorë. Po ashtu në pjesën normative

²⁶ Dr Shefqet Muci – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 66-80

²⁷ Поконкретно во делото на д-р Тома Живановиќ, цитирано дело, стр. 148 – 149.

²⁸ За изложените новини и отстапувања од наведеното начело и во делото на проф д-р Јован Проевски, цитирано дело, стр. 14.

²⁹ Поопширно и поконкретно за наведеното, во одредбите од член 49 од Уставот на СФРЈ од 1963 година. Уставот е објавен во „Службен лист на СФРЈ“, бр. 14/1963 година.

³⁰ За изложеното, во одредбите од член 242/2 од Уставот на СРМ од 1974 година (Службен весник на СРМ, бр. 7/1974)

dhe në një kapitull të veçantë, të drejtat dhe liritë themelore të qytetarit dhe personit përcaktohen dhe rregullohen me ligjin kushtetues. Dispozitat e Kushtetutës që përmbajnë të drejtat civile dhe politike janë vendimtare dhe të sakta. Në kontekstin e temës së shtjelluar në këtë punim, gjegjësisht, parimit të ligjshmërisë, Kushtetuta thekson se askush nuk mund të dënohet për një krim që nuk ishte përcaktuar me ligj ose rregullore tjetër si vepër penale përpara se të kryhej. për të cilat nuk është parashikuar asnjë dënim. Kjo rregullore rrjedh nga dispozitat e nenit 14 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë të vitit 1991.³¹ Rëndësia e parimit të ligjshmërisë në të drejtën penale lind nga fakti se në ligjin aktual kriminal, parimi i cituar sanksionohet nga dispozitat e përfshira në dispozitat e nenit 1 të Kodit Penal.³² Gjithçka që është paraqitur në këtë punim tregon për një përfundim të pashmangshëm juridik. Përkatësisht, parimi i ligjshmërisë është një parim themelor në të drejtën penale si shkencë, por edhe një parim dhe parim domethënës në tërë sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë. Parimi i cituar cilësohet si i tillë si një e drejtë e garantuar dhe e pranuar në përgjithësi e civilizuar.

1.4 Parimi i risocializimit³³

Parimi i risocializimit në praktikën penitensiare bashkëkohore paraqet një synim dhe përcaktim që ka rëndësinë e veçantë, do të thotë tretman dhe sjellje njerëzore ndaj të dënuarve. Sipas këtij parimi duhet të respektohet personaliteti i njeriut dhe dinjiteti i tij. Gjithashtu do të thotë respektimi i vetive dhe cilësive njerëzore nacionale etike racore dhe fetare të çdo individi e në rastin konkret të secilit personi të dënuar i cili gjendet në entet ndërkohore përmirësuese. Personi i dënuar pa marrë parasysh faktin se për veprimin kriminal është shpallur fajtor dhe është dënuar nuk është zhveshur nga subjektiviteti i tij njerëzor. Ai ende e ka dinjitetin njerëzor dhe moral. Për shkak se i dënuari ka kryer vepër penale ai është qortuar dhe atij i është shqiptuar dënimi mirëpo edhe më tej është subjekt shoqërorë dhe kjo rrethanë nuk do të thotë se ai automatikisht është privuar nga disa veti dhe të mira universal natyrore njerëzore. Aq më tepër kur në sistemin bashkëkohor modern të ekzekutimit të dënimit me burgim, është proklamuar se qëllimi i dënimit nuk është hakmarrja dhe shpagimi por riedukimi dhe riintegrimi, rikthimi i të dënuarit në shoqëri si qytetar korrekt. Të gjitha këto obligojnë që ndaj personit të dënuar gjatë qëndrimit në entet ndërkohore përmirësuese duhet patur sjellje humane qëndrim njerëzor respektim të dinjitetit dhe të vlerave elementare njerëzore ndaj tij. Ky shikim kështu i personalitetit të të dënuarit nënkupton një kujdes dhe angazhim të veçantë të personalitetit dhe vlerave elementare njerëzore të të dënuarit. Në shumë vende demokratike kujdesi dhe respektimi ndaj vlerave njerëzore të individit gjatë qëndrimit në institucionet korrektuese në mënyrë decide është rregulluar dhe paraparë me akte më të larta juridike, me

³¹ За изложеного, во одредбите од член 242/2 од Уставот на СРМ од 1974 година (Службен весник на СРМ, бр. 7/1974).

³² Поконкретно во одредбите на член 1 од КЗ, „Службен весник на РМ“, бр. 37/1996 година

³³ Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 209

Kushtetutë me ligje dhe akte tjera nënligjore.³⁴ Në shumë dispozita kushtetuese të vendeve të ndryshme gjejmë formulime dhe nene të vecanta ku garantohet trajtimi human dhe respektimi i personalitetit dhe dinjitetit të njeriut me rastin e privimit nga liria ose gjatë mbajtjes së dënimit me burgim në institucionin korrektues. Poashtu edhe në Kodet penale të vendeve demokratike në dispozita të vecanta kërkohet trajtim human ndaj kryesit të veprës penale si gjatë kohës së ndricimit të çështjes penale, ashtu edhe gjatë kohës së privimit nga liria. Ndërsa në dispozitat e ligjeve mbi ekzekutimin e sanksioneve penale si ligje speciale gjithashtu hasim në formulime më konkrete dhe më detajzuese mbi nevojën e sjelljes dhe qëndrimit human ndaj personave të dënuar gjatë kohës së qëndrimi nëpër institucionet korrektuese. Në dispozita të këtilla posacërisht theksohet se trajtimi i personave të dënuar gjatë ekzekutimit të dënimit me burg duhet të jetë njerëzor dhe të respektohet dinjiteti moral, të ruhet shëndeti fizik dhe psikik i tyre.³⁵ Masat e kufizimit dhe shtrëngimi të cilat parashihen mund të shqiptohen vetëm në raste të jashtëzakonshme, por edhe atëherë ato duhet të jenë të parapara me ligj dhe të kufizuar. Sjellja humane dhe respekti i dinjitetit moral sidomos kujdesi dhe ruajtja e shëndetit fizik dhe psikik të personave të dënuar ka rëndësi të madhe për procesin e riintegrit të tyre. Ndaj individëve të dënuar dhe të privuar nga liria, ndaj të cilëve ushtrohet dhuna, nënçmimi, përbuzja, fyerja, injorimi, shtrëngimi, tortura, çenohet dinjiteti i tyre moral dhe njerëzor, procesi i riedukimit dhe riintegrit nuk mund të zbatohet me sukses. Ndaj personave që është aplikuar dhuna fizike dhe psikike mjetet dhe metodat e riintegrit dhe riedukimit nuk mund të arrijë sukses të dëshiruar. Në këtë drejtim është shumë i njohur parimi se vetëm njeriu i shëndoshë në pikëpamje fizike dhe psikike njeriu që paraqet një tërësi morale mund të riedukohet dhe risocializohet, për këtë arsye në Penologji bashkëkohohe dhe në praktikë penitensiare këtij parimi i kushtohet kujdes i madh. Mirëpo fatkeqësisht të privuar nga liria ndaj personave që gjenden duke mbajtur dënimin me burgim në shumë raste aplikohet dhuna shtrëngimi tortura maltremiti fizik dhe psikik, kështu që në mënyrë flagrante dëmtohet shëndeti i tyre dhe çenohet ky parim. Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale në nenin 5 paragrafi 1 trajton aplikimin e këtij parimi. Para se gjithash ky parim i referohet ekzekutimit të dënimit me burgim, ngase qëllim i posaçëm i këtij lloji të dënimit është që të parandalojë personin që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale dhe të ushtrojë ndikim edukativ ndaj tij. Për këtë qëllim në entin ndëshkues-përmirësues aplikohen masa të ndryshme edukuese dhe terapeutike. Personi i dënuar me burgim ka për detyrë edhe të punojë. Efekti ekonomik i punës duhet ti nënshtrohet qëllimit të riedukimit dhe resocializimit si dhe formojë shprehi të punës të i dënuari. Parimi është një përgjithësim themelor që është i pranuar si i vërtetë dhe mund të përdoret si bazë për arsyetimin ose sjelljen njerëzore.

³⁴ Dr. Shefqet Muçi – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 91-93

³⁵ Dr. Hana Korac – Penologjia (prvo izdanje) Sarajevo 2009, fq. 97-118

Parimi merr kuptime të ndryshme, sipas përdorimit të emërimit: ³⁶

- një rregull ose normë kryesisht e mirësjelljes
- një e vërtetë ose ligj themelor ose hamendësim
- rregull apo ligj që lidhet me një dukuri natyrore ose e punimit të një sistemi të ndërlikuar
- rregull e sjelljes vetjake.

Një sqarim i arsyeve themelore (kryesisht një shpjegim i punimit të disa aparateve në shprehjet e ligjeve të natyrës. Parimi është një rregull themelor i mirë përcaktuar i ligjit. Një e vërtetë themelore ose mësim (doktrinë) i padiskutueshëm, një pohim i dhënë ligjor që është i qartë dhe s'ka nevojë të dëshmohet (miratohet). Një princip ushqen themelin për zhvillimin e rregullave dhe ligjeve të tjera shkurtimisht, parimi është një rregull (normë) në vendosjen se si të sillemi. ³⁷

1.5 Parimi i individualizimit ³⁸

Është koncentrat i përcaktimeve kriminalo-politike që qëndrojnë kah personaliteti i delinkuentit dhe paraqitjes së tij në sistemin kategorial të së drejtës penale. Është pasojë e idesë për subjektivizmin e së drejtës penale, e zhvilluar që nga fundi i shekullit XIX e përfshirë në maksimumin 'nuk dënohet vepra por kryesëi', dhe të gjithë konceptet themelore në sistemin kategorial të së drejtës penale mblohen nga dimensionin individual. Faji është qortim që referohet kryerësit konkret dhe që bazohet në mundësitë e tij që të sillet sipas kërkesave të rregullimit juridik, dënimi dhe sanksionet tjera i prekin liritë dhe të drejtat e njeriut të kryerësit konkret dhe duhet të realizohet ndonjë efekt. Për këtë arsye sanksioni penalo-juridik duhet të jetë i përshtatshëm për personalitetin e kryerësit, individuale. ³⁹ Të gjitha këto kërkesa të cilat kanë kuptim të parimit të individualizimit bazohen në postulatet për funksionin mbrojtës të së drejtës penale e fokusuar në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Përmbajtja dhe veprimi pozitiv juridik i këtij parimi mund të paraqiten nëpërmjet sistemit pyramidal të vendosur në anën e kundërt të së drejtës penale, nëmajë qëndrojnë dispozitat e përgjithshme për të drejtën penale dhe inkriminimet e caktuara që i prekin të gjithë në mënyrë të njëjtë (parimi i ligjshmërisë, barazisë para ligjit etj), ndalesat penalo-juridike kanë veprim të përgjithshëm dhe individualizues por kornizat e parapara penale duhet të jenë të vendosura në mënyrë që të lënë hapësirë për individualizëm e pasojës penalo-juridike të veprave, prandaj konsekuenca e këtij parimi është pranimit i sistemit të dënimeve të caktuara relative. ⁴⁰ Niveli i dytë i dënimit dhe pasojave të tjera juridike të veprës penale në masë të madhe është e mbuluar me kërkesën për individualizëm, zbatimi i këtij parasheh sistemin e ndarë të dënimeve dhe pasojat e tjera juridike të

³⁶ Dr. Ragip Halili, Penologjia – Prishtinë 2014, fq. 2010

³⁷ Dr. Hana Korac – Penologjia (prvo izdanje) Sarajevo 2009, fq. 109

³⁸ Dr. Vlado Kamborvski & Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq. 48

³⁹ Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 210

⁴⁰ Dr. Shefqet Muçi – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 198

veprave penale, në një sistem të tillë duhet të parashihen sanksione penalo-juridike të cilat lënë hapësirë të mjaftueshme për gjetjen e masave të vërteta dhe të drejta për rastet konkrete për përshtatjen e tyre personalitetit të kryerësit dhe për realizimin optimal të qëllimeve të sanksioneve të dalluara. Niveli i tretë është ai i zbatimit të dënimit dhe sanksioneve të tjera, parimi i individualizimit është parim themelor i matjes gjyqësore të dënimit dhe sanksioneve të tjera. Që t'ia individualizojmë përshtatë sanksionin penalo-juridik personalitetit të kryerësit gjykatës duhet t'i ngelet në dispozicion më tepër instrumente, mundësia për zbutjen e dënimit apo lirimit të dënimit, për shqiptim të alternativave të dënimit dhe zbatimit të sanksioneve në bazë të rrethanave. Korniza e fundit e ekzekutimit të dënimit dhe sanksioneve të tjera është përcaktimi i kërkesës për individualizim.⁴¹ Qëllimi primarë i ekzekutimit të dënimit me burgim është risocializimi dhe riintegrimi social i të dënuarit që mund të realizohet vetëm nëse zbatohen metodat dhe procedurat individuale. Trajtimi i individualizimit në ekzekutimin e masave institucionale (masat për mjekim) të sigurimit është përcaktuar me vetë natyrën e këtyre masave. Parimet proceduralo-penale janë rregullat bazë kryesore kërkesat themelore mbi të cilat është ndërtuar procedura penale në përgjithësi dhe institucionet procedurale, me analizimin e gjithëmbarshtëm të dispozitave të drejtës së procedurës penale mund të vërehet se bazohet në një mori parimesh e disa prej tyre i përkasin rregullimit të sistemit juridik dhe si të tilla i konsiderojnë si parime kushtetuese.⁴² Është i rëndësishëm veçanarisht të dënimi me burgim, që ndryshe quhet edhe individualizimi penitenciar. Individualizimi në këtë fazë ka për qëllim përshtatjen e ekzekutimit të sanksioneve penale, veçorive të kryesit të veprës penale. Ndërsa individualizimi penitenciar është kusht për realizimin e parimit të riedukimit dhe resocializimit të të dënuarit. Realizimi i parimit të përshtatshmërisë së mësimi sipas moshës duke u bazuar në nxënësin e paramenduar “mesatar” pa e përfillur parimin e individualizimit, mësimi i sjell dëme të mëdha.⁴³ Kjo sidomos ka të bëjë me nxënësit e talentuar që kanë koeficient të lartë të inteligjencës dhe me ata që kanë ngecje në zhvillim. Për këtë arsye zbatimi i parimit të individualizimit në mësim ka rëndësi të madhe. Me këtë rast mbahet llogari për adaptimet e aktiviteteve didaktike të çdo nxënësi duke u bazuar në zhvillimin e tij individual. Nxënësit në klasë dallohen për nga zhvillimi i tyre psiko-fizik dhe kanë tiparet e tyre individuale. Ky dallim shihet në moshën kronologjike, paradituritë, fjalorin etj. Po ashtu edhe zhvillimin psikik, të vërejturit, perceptimin, të menduarit, të mbajturit mend, vullneti etj., dallohet në mes individëve të ndryshëm. Dallimet individuale të nxënësit shkaktohen edhe nga fakti se vijnë nga rrethe të ndryshme familjare dhe shoqërore të cilët ndikojnë në formimin e qëndrimeve, pikëpamjeve, interesit, identitetit personal etj.⁴⁴ Përveç faktorëve psikologjikë dhe sociologjikë në realizimin e suksesshëm të këtij parimi ndikojnë edhe faktorët pedagogjikë të cilët kanë të bëjnë me shfrytëzimin racional të kohës në orën e mësimi, këmbëngulësia dhe qëndrueshmëria në përvetësimin e diturive, shkathtësive dhe shprehive,

⁴¹ Dr. Ismet Saliu – E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2003, fq. 76

⁴² Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli – E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq. 35

⁴³ Dr. Vlado Kamborvski & Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq. 48

⁴⁴ R.Mlagjenoviq-Kupceviq. Vep.e cit.fq 174-175

mësimi efikas duke shfrytëzuar burime të ndryshme të diturisë dhe aftësimi efikas i nxënësve për punë të pavarur. Zbatimi i këtij parimi mund të bëhet gjatë realizimit të shumë njësive mësimore nga natyra dhe shoqëria, si: “Shtazët shtëpiake”, “Karakteristikat e shtazëve: lëvizja, frymëkëmbimi, ushqimi, rritja, zhvillimi, shumimi, ndryshimi gjatë vitit, kushtet për jetë.” Të gjitha këto veçori vlejné edhe për botën bimore. Po ashtu ky parim mund të përdoret edhe kur përpunojmë njësitë mësimore që kanë të bëjnë me orientimin në ambientin jetësor, relievin dhe format e tij në vendlindje dhe më gjerë etj. Me këtë rast bëjmë diferencimin e detyrave, radhitjen e nxënësve, ku vërehet puna e tyre individuale. Por duhet cekur se ky parim nuk realizohet vetëm në formë individuale të punës, por edhe në formë kolektive (puna frontale dhe në grupe) me çka nxënësit mësojnë që të bashkëpunojnë me të tjerët dhe në këtë mënyrë të bëhet socializimi i personalitetit të tyre.⁴⁵

1.6 Parimi i mbajtjes kolektive të dënimit⁴⁶

Ky parim thekson se personat e dënuar gjatë qëndrimit në institucionet korektuese me qëllim të riedukimit dhe riintegrit të plotë, dënimin duhet ta mbajnë së bashku në grupe në nëngrupe. Personat e dënuar gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim duhet të jetojnë dhe punojnë në kolektiv e jo të izoluar nga njëri-tjetri. Ky parim është i kundërt me parimin e izolimit të personave të dënuar, sic dihet parimi i izolimit theksonte se personi i dënuar duhet të qëndrojë i vetmuar gjatë tërë kohës së mbajtjes së dënimit me burgim, praktika penitensiare e sistemit të izolimit ka vërtetuar se ai sistem nuk ka kontrolluar në riedukimin e personave të dënuar e as në pengimin e kriminalitetit në shoqëri. Sistemi bashkëkohorë i ekzekutimit të dënimeve me burgim thekson se personat e dënuar dënimin duhet të mbajnë së bashku në kolektiv kuptohet – jo të ndarë dhe të klasifikuar sipas kriterëve dhe vetive të caktuara të cilat janë në interes të arritjes së procesit të riedukimit dhe riintegrit. Personat e dënuar sipas këtij parimi vendosen në pavijone të fjetjes, në vendqëndrimet ditore, në grupe punuese dhe në grupe për aktivitete të lira dhe në këtë mënyrë tërë kohën gjenden në kolektiv. Ata punojnë, jetojnë dhe ndërmarin aktivitete të ndryshme në grupe. Kjo praktikë mendohet se është një mënyrë më e natyrshme dhe më e përshtatshme për arritjen e procesit të riedukimit të personave të dënuar. meqenëse njeriu është qenie sociale shoqërore që lind, formohet dhe zhvillohet e përsoset në bashkësi, në grup, në kolektiv familjarë e shoqërorë është krejtësisht e natyrshme që edhe në institucione ndëshkimore ai të qëndrojë në grup dhe në kolektiv e jo të izolohet e të ndahet sepse izolimi dhe ndarja nuk ndikon në përmirësimin e tij. Mirëpo, mirëmbajtja e përbashkët e dënimit me burgim nuk ka asgjë të përbashkët me sistemin e parë kolektiv në të kaluarën kur të dënuarit vërtetë kanë qëndruar të gjithë së bashku por pa ndarje pa klasifikim dhe pa marrë në konsideratë vetitë dhe cilësitë individuale të tyre.⁴⁷ Tani sistemi modern i mbajtjes së dënimit kërkon që

⁴⁵ Dr Shefqet Muci – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 132

⁴⁶ Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 210

⁴⁷ Dr Shefqet Muçi – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 133

personat e dënuar dënimin të mbajnë të ndarë, të klasifikuar në grupe dhe nëngrupe dhe kategori të caktuara pas një pune të kujdesshme dhe të gjithëanëshme të studimit dhe observimit të personalitetit të tyre. Qëndrimi jeta dhe puna në grup nuk ndikon negativisht në riedukimin e personave të dënuar, jeta e përbashkët puna në kolektiv, aktivitetet kulturore dhe sportive të cilat ndërmiren së bashku vetëm kontribuojnë që personat e dënuar të nxitin vetëiniciativa dhe të krijohen shpehi dhe veti pozitive të cilat ndikojnë fuqishëm në përmirësimin e tyre. Parimi i sigurisë juridike është gjithashtu një element shumë i rëndësishëm i shtetit të së drejtës. Si standarde formale kryesore të tij konsiderohen saktësia, qartësia, dhe qëndrueshmëria në tërësi e të gjithë rendit juridik të një shteti të caktuar. Nga ana tjetër, si standarde kryesore në kuptimin material të parimit të sigurisë juridike konsiderohen mos cenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Me një fjalë, jo vetëm normat e veçanta, por i gjithë rendi juridik kërkohet të jetë i kuptueshëm, i parashikueshëm dhe jo kontradiktor. Në këtë mënyrë, vlerësohet se krijohet edhe besimi i qytetarëve në qëndrueshmërinë e këtij rendi si dhe bindja e tyre në nevojën e respektimit dhe zbatimit të tij në jetën e përditshme. Në të njëjtën kohë, mbi këtë bazë, qytetarët përcaktojnë edhe hapësirën e lirisë apo mënyrën e sjelljes së tyre në shtet dhe shoqëri. Në kuadër të këtij parimi, standardet e mësipërme kërkohet të respektohen nga të gjithë mekanizmat dhe institucionet shtetërore, veçanërisht nga organet qendrore të tre degëve kryesore të pushtetit shtetëror, pra nga parlamenti në ushtrimin e funksionit të tij ligjvënës, nga Qeveria në miratimin e akteve që nxjerr në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve, nga pushteti gjyqësor në ushtrim të funksionit të tij të dhënies së drejtësisë, e të tjerë. Për sa më sipër, është e natyrshme që një nga kërkesat e qenësishme të parimit të sigurisë juridike është bërja sa më publike e akteve normative.⁴⁸

⁴⁸ Dr. Hana Korac – Penologija (prvo izdanje) Sarajevo 2009 fq. 149-159

KAPITULLI II

VUAJTJA E DËNIMIT NË BURGUN E TETOVËS

2.1. Pozita dhe gjendja e të dënuarve në rajonin e Tetovës

Rajoni i Pollogut është një nga 8 rajonet e Republikës së Maqedonisë dhe ndodhet në veriperëndim të vendit. Ky rajon në perëndim kufizohet me Shqipërinë dhe në veri me Kosovën, ndërsa brenda vendit kufizohet me Rajonin jugperëndimor dhe Rajonin e Shkupit. Ky rajon në vete përfshinë komunat si atë të Bogovinës, Bërvenicës, Jegunovcës, Gostivarit, Tearcës, Tetovës, Vrapçishtit dhe Zhelinës. Sipas regjistrimit të fundit zyrtar në vitin 2002, Tetova si një nga komunat më të mëdha me rrethinë ka mbi 60 mijë banorë ndërsa Gostivari me rrethinë mbi 40 mijë banorë.⁴⁹ Bazuar në këtë, në bazë të statistikave, dënim në burgun e Tetovës sipas veprave penale të kryera vuajnë një numër shumë i ulët i qytetarëve, derisa pozita dhe gjendja e tyre si arsimore e shëndetësore do të përshkruhet në hulumtimin e realizuar në vazhdim. Institucioni Ndëshkimor Korrektues Burgu i Tetovës është një institucion gjysëm i hapur, ku kryhet burgim deri në tre vjet, si dhe burgim deri në gjashtë muaj kundër shkelësve të përsëritur të dënuar më parë me burgim. Janë krijuar klasa të hapura dhe të mbyllura në institucion. Njësia e paraburgimit u mbyll në vitin 2018. Objekti ka një dhomë që përdoret si njësi pritëse. Burgu nuk ka një dhomë të veçantë për vuajtjen e masës disiplinore - referim në izolim, kështu që për zbatimin e kësaj mase një dhomë përdoret në katin e parë të ndërtesës, ku deri në vitin 2018 ishte vendosur njësia e paraburgimit. Kapaciteti i përgjithshëm i Burgut të Tetovës është 53 shtretër.⁵⁰ Në kohën e vizitës, 43 persona ishin të pranishëm - 2 persona shfrytëzuan fundjavën e përfitimit, dhe 8 persona kryenin angazhime pune jashtë institucionit. Në repartin e mbyllur, 7 persona janë duke vuajtur dënimet me burg. Objektet hapësinore, kushtet materiale dhe higjiena - të gjitha dhomat janë të pajisura me krevate marinari, tavolinë kafeje dhe karrige dhe dollapë metalikë të destinuar për ruajtjen e sendeve personale të të dënuarve. Ka Tv në çdo dhomë që vizituar, të sjellë nga të dënuarit. Në dy prej tyre ka Tv Led në dhomat e tjera ka Tv më të vjetër. Ka dritë të mjaftueshme në të gjitha qelitë, me dy dritare të mëdha për të lejuar ajrosjen dhe ventilimin. Qelitë nuk mbajnë erë lagështie, muret janë pikturuar. Shtratet janë të pastër, dyshekët janë në gjendje të mirë. Njerëzit e dënuar kujdesen për higjenën në qeli dhe në kohën e vizitës pastërtia ishte në një nivel të kënaqshëm. Kishte një erë lagështie në korridor. Në dyshemenë ku ndodhen qelitë, ka dy tualete me dy lavaman dhe ambiente sanitare, me erë lagështie dhe është e pisët dhe e ftohtë. Në pjesën e jashtme të burgut, ku ndodhet oborri, ka një dhomë me tre mbyllje dush të mbyllur me perde dhe një dhomë lavanderi. Një person i dënuar është i punësuar në lavanderi.

⁴⁹ Enti Shtetëror i statistikës së RMV, Rregjistrimi i vitit 2002

⁵⁰<https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/izveshtaj-za-sostojbite-i-uslovlite-vo-kazneno-popravnite-ustanovi-vo-republika-severna-makedonija.pdf>

Dhomat janë në gjendje të dobët, të ndotur dhe të ftohtë. Të dënuarit janë përgjegjës për ruajtjen e higjenes në dhomë. Për sa i përket regjimit, aktiviteve të kohës së lirë dhe kontakteve me botën e jashtme, të dënuarit i përdorin qelitë vetëm për të fjetur, duke kaluar pjesën e mbetur të ditës jashtë në oborrin e burgut. Oborri ka një zonë të vogël, duke pasur parasysh numrin e të dënuarve që vuajnë 20 dënime me burg në burgun e Tetovës. Konstruksioni është i betonuar, nuk ka bar dhe hapësirë për aktivitete të tjera, përveç shëtitjeve. Në këtë pjesë të Burgut ka edhe një dhomë që të burgosurit e përdorin si palestër me pajisjet që kanë bërë vetë. Të burgosurit gjithashtu kanë një dhomë që e përdorin si bibliotekë, të pajisur dobët me libra. Në kohën e vizitës, disa të dënuar po luanin shah në atë dhomë. Në këtë dhomë ka edhe një kuti në të cilën të dënuarit i vendosin ankesat e tyre Avokatit të Popullit. Pranë dhomës me dushe dhe lavanderi, ka edhe një dhomë për ri-socializim të pajisur me kompjuter, të cilën e përdorin punonjësit e Shtëpisë Edukuese dhe Korrektuese Tetovë. Prandaj, të dënuarit nuk mund ta përdorin këtë dhomë. Nuk ka dhoma të veçanta për vizita, vizitat zhvillohen në oborrin e burgut. Personi përgjegjës na informoi se, nëse ishte e nevojshme, ai do t'i lejonte ata të përdorin telefonin e tij për të kontaktuar botën e jashtme. Tetë nga të dënuarit janë të punësuar në ndërmarrje private jashtë burgut, në fushën e hotelierisë, bërjes së mobiljeve, zyrave mjekësore dhe dentare. Sigurimi shëndetësor sigurohet nga burgu dhe kompanitë nuk paguajnë kontributet e tjera për personat e punësuar. Kompania transferon fonde javore në burgun e burgut në Tetovë në shumë prej 10,000 denarë, nga të cilat 2,000 u jepen personave të dënuar që punojnë në kompani.⁵¹ Për sa i përket kujdesit shëndetësor, burgu ka një mjek të përgjithshëm i cili ndodhet në institucion çdo ditë nga 7:30 deri në 15:30 dhe është i disponueshëm në telefon deri në orën 22:00. Nëse nevoja lind pas orës 22 pasdite, arrin një ambulancë. Në institucion nuk ka asnjë infermiere. Dhoma që mjeku përdor për ekzaminime dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor është e vogël, ka vetëm një krevat dhe dy dollapë për ruajtjen e ilaçeve. Doktorin na informoi se ai e ndan zyrën me një bashkëpunëtor teknik të punësuar në Burgun e Tetovës. Dhoma është e pastër dhe e ndritshme. Nuk ka aparat apo ekrane ECG në ambulancë; nga pajisjet ka 1 stetoskop; 1 aparat presioni; 1 aparat për matjen e nivelit të sheqerit në gjak; 1 termometër. Mjeku u siguron të dënuarve kujdesin shëndetësor parësor, kur është e nevojshme të dënuarit të dërgohen në spitalin klinik në Tetovë. Mjeku ekzaminon dhe ofron ndihmë mjekësore për 5 deri në 15 të dënuar në ditë, në çdo kohë gjatë orarit të tij të punës. Mjeku na informoi se për shkak të buxhetit të kufizuar, ilaçet që ndodhen aktualisht në ambulancë janë të mjaftueshme vetëm për 2 deri në 3 muaj. Në lidhje me sëmundjen, mjeku na informoi se shumica e rasteve kishin të bënin me sëmundje psikologjike; problemet e frymëmarrjes dhe problemet e brendshme. Mjeku mban shënime të shkëlqyera dhe të gjitha rastet e sëmundjes janë të dokumentuara. Mjeku na informoi se 5 të dënuar ishin të varur nga lëndët psikotropike, njëri prej të cilëve po merrte terapi metadoni në ambulancën e burgut; ka 1 rast të hepatitit B dhe ka 2 raste të hepatitit C. Në burgun e

⁵¹ <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/09/izveshtaj-za-sostojbite-i-uslovite-vo-kazneno-popravnite-ustanovi-vo-republika-severna-makedonija.pdf>

Tetovës nuk ka zyrë dentare, shpenzimet për stomatologun i përballojnë të dënuarit. Gjithashtu, vetë të dënuarit paguajnë për ilaçet që u duhen për të trajtuar sëmundjet e tyre, të cilat nuk janë në ambulancën e burgut.⁵²

2.2. Profili i të dënuarve

Në kuadër të këtij kapitulli do të elaborohen disa konstatime dhe të dhëna për vecoritë personale të kryesve që kanë të bëjnë me moshën, gjininë, përkatësinë nacionale, shtrirjen regjionale etj. Lidhja ndërmjet moshës dhe kriminalitetit është studiuar shumë kohë më parë. Këtë e vlerëson moshën si një ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikon në tendencat e krimit. Tendenca e theksuar e krimit zhvillohet në proporcion me intensitetin e forcës fizike dhe pasionit të personit.⁵³ Në përgjithësi është pranuar se në vendet ku ka probleme me mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të mungesës së rendit dhe stabilitetit politik dhe ekonomik mundësitë e përfshirjes në krim në moshën të hershme janë të mëdha. Përsa i përket ndarjes së të miturve në grupe moshë legjislacionet e vendeve të ndryshme dallojnë në mes veti dhe parashohin moshën të ndryshme të pjesëmarrësve në akte kriminale. Legjislacioni penal i RMV-së varësisht prej moshës, të miturit i ndanë në disa grupe. Së pari i vecon fëmijët deri në moshën 14 vjeçare, përkatësisht ndaj kategorisë së personave të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale, nuk i kanë mbushur 14 vjet dhe ndaj tyre nuk mund të shqiptohet kurrëfarë sanksioni penal. Këta persona në të drejtën penale quhen fëmijë, në të drejtën penale persona të mitur konsiderohen prej moshës 14-16 vjet, mirëpo edhe në këtë ndarje kemi edhe një nën-darje ku moshën e mitur ndahet në të mitur të rinjë që përfshinë moshën prej 14-18 vjet dhe të mitur të rritur që përfshinë moshën 16-18 vjet. Studiuesit përpiqen të shpjegojnë shkaqet e ndryshueshmërisë së krimit në varësi të grup moshës dhe faktorët që ndikojnë në përhapjen e krimeve në moshën të reja. Ata e vënë theksin në faktorë të ndryshëm ndër të cilët më të rëndësishmit janë: përbërja demografike e popullësisë, rëndësia që ka grup moshë e re në shoqëri, aktiviteti i madh i këtyre moshave, mënyra e kalimit të kohës së lirë, kontaktet e shumta të të rinjëve me njëri tjetrin etj.⁵⁴ Kërkimet kriminologjike lidhur me dukurinë e kriminalitetit kundër pasurisë dhe pjesëmarrjen e personave të mitur, të rinjë dhe fëmijëve tregojnë se rastet janë të shumta, sipas kërkimeve kriminologjike fëmijët dhe të miturit marrin pjesë në 45.7% të rasteve të paraqitura për këto krime. Në disa raste pjesëmarrja e tyre është edhe më e madhe, te krimet e vjedhjeve të zakonshme, vjedhjes së imta, vjedhjes nëpër shitore, vjedhjes së automobilave, ajo arrinë deri në 50%. Moshën më të vjetër e kryesve të këtyre krimeve silltet prej 20-25 vjet.⁵⁵ Nga të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me moshën e kryesve të mitur të veprave penale në RMV gjatë periudhës 2004 sipas moshës janë dënuar 219 të mitur të rinjë

⁵² Të dhënat e poshtëshënuara janë mbledhur dhe përpunuar nga autori i punimit gjatë vizitave dhe kontakteve që ka bërë me zyrtarët e burgut të Tetovës

⁵³ V.Hysi, Kriminologjia, Tiranë 2005, fq. 123

⁵⁴ V.Hysi, Kriminologjia, Tiranë 2005, fq. 123

⁵⁵ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2016, fq. 211

për vepra të ndryshme penale, gjithësejt janë shqiptuar 35 masa disiplinore, 181 masa të mbikqyrjes së shtuar dhe 2 masa të entit. Gjatë periudhës në fjalë sipas moshës janë dënuar 7 të mitur të rritur për vepra të ndryshme penale. Gjithësejt janë shqiptuar 3 dënime me burgim deri në 2 vjet, 3 dënime me burgim prej 3-5 vjet dhe 1 dënim me burg prej 5-8 vjet. Gjatë periudhës 2005 sipas moshës janë dënuar 282 të mirut të rinjë për vepra të ndryshme penale. Gjithësejt janë shqiptuar 50 masa disiplinore, 216 masa të mbikqyrjes së shtuar dhe 16 masa të entit. Gjatë periudhës në fjalë sipas moshës janë dënuar 6 të mitur të rritur për vepra të ndryshme penale. Gjithësejt janë shqiptuar 2 dënime me burgim deri në 2 vjet, 2 dënime me burgim prej 2-3 vjet, 1 dënim me burg prej 3-5 vjet dhe 1 dënim me burg prej 5-8 vjet. Nga gjitha dënimet e shqiptuara me burgim 4 janë për kryerje të veprës penale kundër pasurisë. Gjatë periudhës 2006 sipas moshës janë dënuar 235 të mitur të rinjë për vepra të ndryshme penale, gjithësejt janë shqiptuar 26 masa disiplinore, 204 masa të mbikqyrjes së shtuar dhe 5 masa të entit, gjatë periudhës në fjalë sipas moshës janë dënuar 8 të mitur të rritur për vepra të ndryshme penale, janë shqiptuar 4 dënime me burgim deri në 2 vjet, 3 prej të cilëve për vepra penale kundër pasurisë, 3 dënime me burg prej 3-5 vjet, 2 prej të cilave për vepra penale kundër pasurisë dhe 1 dënim me burg prej 5-8 vjet.⁵⁶ Për qëllime të përgjegjësisë penale për kirmet konsiderohet i mitur personi i cili ka mbushur moshën 14 vjet por jo 18 vjet në kohën e kryerjes së krimit.⁵⁷ Për qëllime të përgjegjësisë për kundërvajtje penale konsiderohet i mitur personi i cili ka mbushur moshën 16 vjeçe por jo 18 vjeçe në kohën e kryerjes së kundërvajtjes penale. Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë por ka arsye të besohet se është i mitur, ai konsiderohet i tillë në kuptim të këtij Kodi derisa të përcaktohet mosha e tij. Kur ka pasiguri në lidhje me moshën e të miturit organi procedures në cdo gjendje ose shkallë të procedimit në bazë të kërkesës së palës ose kryerstit menjëherë merr vendim për të përcaktuar moshën e të miturit. Mosha përcaktohet në bazë të një vlerësimi të plotë të të gjithë informacionit të disponueshëm duke i dhënë rëndësinë e duhur cdo dokumenti zyrtar të tillë si certifikata e lindjes, të dhënat e shkollës, të dhënat shëndetësore, deklarata e prindit për moshën ose deklarata e vetë të miturit dhe një raport i bazuar në ekzaminimin mjekësorë. Nëse pas verifikimit dhe ekspertimit mbeten dyshime për moshën, prezumohet se personi është i mitur. Nëse mosha e të miturit është e përcaktuar me përafërsi për marrjen e vendimit mbi përgjegjësinë penale do të konsiderohet mosha më e ulët.⁵⁸ Studimi i autorëve të veprave penale dhe vëmendja e kriminologëve ka ngjallur interesim dhe është drejtuar në studimin e lidhjeve si femra dhe krimi, të miturit dhe krimi si dhe janë përpjekur të spjegojnë dallimin e madh që ekziston në përfshirjen e meshkujve dhe të femrave në krim, e jo vetëm në vendet perendimore por edhe në ato në zhvillim ose të Europës juglindore.⁵⁹ Karakteristikë e delikuencës së të miturve është se me kriminalitet meren si meshkujt ashtue dhe femrat. Shënimet statistikore gati në të gjitha vendet e botës tregojnë se po

⁵⁶ Drzhaven zavod za statistika, Skopje - Statisticki pregled na prijaveni, obvineti i osudeni storiteli na krivicni dela za 2004 g.

⁵⁷ Kodi i drejtësisë penale për të mitur, i R.Shqipërisë, neni 7.

⁵⁸ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2016, fq. 211

⁵⁹ V.Hysi, Kriminologjia, Tiranë 2005, fq. 123

rritet pjesëmarja e femrave të mitura në kryerjen e aktiviteteve të ndryshme kriminale, sic është marrja me prostitucion, marrja me bixhoz, kontrabanda me drogë dhe forma të reja të sjelljeve të rrezikshme kriminale. Kriminaliteti është present në të gjitha shoqëritë dhe delikte kryejnë pjestarët e të gjitha nacionaliteteve pa përjashtim. Nëse shikojmë të dhënat statistikore për periudhën 2001 në RMV prej gjithësejt 1446 kryersve të veprave penale përkatësia nacionale e tyre ka pasur këtë strukturë: 876 kryers janë deklaruar maqedonas prej të cilëve 24 femra, 248 kryers janë deklaruar shqiptarë prej të cilëve 1 femër, 205 janë deklaruar romë prej të cilëve 10 femra, 62 janë deklaruar turq, 15 janë deklaruar serb prej të cilëve 1 femër, 39 të tjerë dhe 1 i panjohur.⁶⁰ Kriminaliteti mund të studiohet në raport me vendin e kryerjes së tij, ai është i përhapur sikurse në vendet rurale ashtu edhe në vendet urbane mirëpo kriminaliteti është i përhapur më shumë në zonat urbane se në ato rurale. Kriminaliteti në zonat rurale ka specifikat e veta që e dallojnë atë nga ai i zonave urbane si psh: krimet kundër jetës dhe shëndetit janë më të përhapura në zonat rurale ndërsa krimi financiar, krimi i organizuar janë më të përhapur në zonat urbane.⁶¹ Në hulumtimin në vazhdim të realizuar në Burgun e Tetovës mbi profilin e të burgosurve, kemi bërë klasifikimin sipas Veprave penale të kryera nga ana e të burgosurve të cilët edhe vuajnë dënimin e tyre gjatë viteve 2018 – 2019 edhe atë në 3 kuartale për të dy vitet. Profili i të burgosurve në këtë institucion nuk është i rrezikshmërisë së lartë derisa aty vuajnë dënimin persona të cilët kanë kryer vepra penale të ndryshme e që nga vepra kundër qetësisë publike deri tek vepra kundër njerëzimit. Një gjë e rëndësishme në këtë hulumtim që është bërë është se në burgun e Tetovës nuk kemi të burgosur që vuajnë dënimin për vepra shumë të rënda penale ose me burg të përjetshëm, derisa vlenë të theksohet se në këtë burg dënimin e vuajnë vetëm gjinia mashkullore pasi që si institucion është krijuar pikërisht vetëm për meshkujt ndërsa të burgosur të gjinisë femërore nuk ka.

2.3 Llojet e vuajtjes së dënimit

Gjatë historisë së zhvillimit të shoqërisë njerëzore, lufta kundër kriminalitetit është zhvilluar me mjete dhe metoda të ndryshme të cilat pak a shumë kanë kontribuar në mbrojtjen e të mirave të individëve dhe shoqërisë nga atakimet dhe shkeljet e ndryshme. Pas Revolucionit borgjez francez si mjete dhe metoda të luftimit të kriminalitetit parashikohen disa sanksione dhe dënime të tjera e ndër to edhe disa lloje të dënimit me burgim. Nën ndikimin e mësimbebe dhe ideve të lëvizjes dhe shkollave të ndryshme si metoda dhe mjete për pengimin e kriminalitetit përvec dënimeve, më vonë parashikohen sanksione tjera si dënimet plotësuese, masat mbrojtëse masat educative ndaj të miturve, masat të zëvendësimit të dënimeve si dënime plotësuese, dënime alternative dhe masa e mjete tjera të parandalimit të kriminalitetit.⁶² Historia e burgjeve është pjesë përbërëse e historisë së një kombi në tërësi. Burgjet janë një realitet që i

⁶⁰ Drzaven zavod za statistika Skopje, statisticki pregled na prijaveni, obvineti i osudeni na krivicni dela za 2001 god.

⁶¹ V.Hysi, Kriminologjia, Tiranë 2005, fq. 123

⁶² Dr. Ragip Halili, vep. e cit.fq. 14-16

përkasin çdo vendi pavarësisht nga niveli ekonomik apo zhvillimi social-politik i tij. Gjatë periudhës komuniste, si gjithçka, çdo gjë ishte e politizuar dhe çdo informacion në lidhje me burgjet nuk jepej, bile as institucioneve evropiane që merreshin me studime në këtë fushë. Studimet në këtë fushë janë të një rëndësie të veçantë sepse kanë të bëjnë me mbarëvajtjen e shoqërisë, me marrëdhëniet midis njerëzve dhe reduktimin e konflikteve. Ato orientojnë strukturat e shtetit për t'u dhënë zgjidhje të drejtë problemeve duke u mbështetur në ligje sa më të arsyeshme. Para shekullit të XX-të, në vendin tonë burgimi ka qenë vetëm një nga format e ndëshkimeve dhe mund të themi jo kryesorja. Dihet se në vendin tonë krahas të drejtës penale zyrtare romake, bizantine, osmane, ilire dhe shqiptare ka ekzistuar e drejta zakonore ilire e cila nuk parashikonte dënimin me burgim. Format kryesore që parashikoheshin në të drejtën zakonore shqiptar mbi ndëshkimet ishin: Të gjykuarit me vdekje, nxjerrja nga krahina, djegia e shtëpisë, lënia e tokës djerrë, prerja e pemëve, gjoba në para, etj. Edhe në periudhën e Skënderbeut e pashallarëve, ndonëse u përdor burgimi në sistemin e dënimeve, mund të themi se burgimi mbetej një dënim dytësor, në raport me llojet e tjera të dënimeve, sidomos dënimin me vdekje. Pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar ngritja e institucioneve shtetërore e në këtë kuadër të burgjeve për mbajtjen e rendit u konsiderua detyrë parësore për patriotët, politikanët e intelektualët.⁶³ Në mënyrë graduale u krijua kuadri i plotë ligjor që rregullon dhe administron burgjet. Filloi ngritja e godinave me një arkitekturë të përshtatshme që përmbushte kushtet e sigurisë si dhe ato higjieno-sanitare. Burgjet përbëjnë një mozaik mjaft të larmishëm që karakterizohet nga një diversitet i paparë formash të organizimit, administrimit, godinash dhe kushteve të vuajtjes së dënimit, të cilat kanë ndryshuar në mënyrë të pandërprerë në kohë dhe hapësirë.

2.4 Vrasjet⁶⁴

Me vrasje nënkuptojmë atë veprë të kundërligjshme me anë të se cilës i merit jeta një personi tjetër me dashje apo nga pakujdesia. Përveç veprës themelore të vrasjes ekzistojnë edhe vepra të kualifikuara ose të privileguara të vrasjes të cilat nga vepra themelore dallohen me disa rrethana shtesë sic janë mënyra e kryerjes, karakteristikat e viktimës, rrethanat subjektive dhe të ngjajshme. Veprimi i kryerjes është përcaktuar përmes shkaktimit të pasojës privimit nga jeta dhe cdo veprim me të cilin shkaktohet vdekja e një personi, pasoja qëndron në paraqitjen e vdekjes, vepra konsiderohet se është përfunduar në momentin e paraqitjes së vdekjes. Subjekti i veprës penale të vrasjes mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën e caktuar me ligj për përgjegjësi penale. Vrasja mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia. Forma e rëndë e veprës penale është paraparë në paragrafin 2 dhe konsiderohet se është kryer në këto raste: nëse tjetri privohet nga jeta në mënyrë të paskrupullt nëse tjetri privohet nga jeta me paramendim, nëse tjetri

⁶³ Dr. Ragip Halili – Kriminologjia, Prishtinë 2008, fq. 14-16

⁶⁴ Dr. Ismail Zejneli – Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë 2018, fq. 75

privohet nga jeta për arsye të ndonjë interesi ose prej fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale nëse privohet nga jeta personi zyrtar ose ushtarak gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik në ruajtjen e rendit publik. Vrasja e kualifikuar (e rëndë) është privim i paramenduar i tjetrit nga jeta, i kryer në rrethana specifike rënduese të përcaktuara me ligj që e ngrenë shkallën e të padrejtës dhe fajësisë së kryerësit për të cilat ligji për këtë veprë parasheh dënim të rëndë (burgim të përjetshëm). Vrasja e kualifikuar dallohet nga vrasja e rëndomtë sipas rrethanave të caktuara kualifikuese të natyrës objektive ose subjektive. Mund të dallojmë më tepër grupe të rrethanave që vrasjes me paramendim i japin karakteristikën e ndonjëres nga vrasjet e rënda të përfshira në këtë dispozicion (nenet. 237, 238, 309 nga KP i RM-së). Rrethanat që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes: vrasja në mënyrën mizore, vrasje me vënien në rrezik të jetës dhe ndonjë personi tjetër. Rrethanat subjektive që kanë të bëjnë me motivet e kryerësit: vrasja nga lakmia fitimi pasuror, për shkak të kryerjes ose fshehjes së veprës tjetër penale vrasje nga hakmarja e nga motivet tjera të ulëta si vrasje në bazë të porosisë. Veprimi apo sjellja e caktuar e njeriut është një ndër elementet themelore të çdo veprë penale. Veprimi shprehet të veprat penale që kryhen me veprim dhe mosveprim, të veprat penale të kryera me dashje dhe nga pakujdesia, të tentativa apo vepra penale e kryer, etj. Me termin veprim nënkuptojmë të gjitha sjelljet apo veprimet e njeriut që manifestohen në botën e jashtme dhe të cilat janë të përcaktuara me ligj si vepra penale. Veprimet që ngjajnë në psikën dhe vullnetin e brendshëm të njeriut, siç janë: mendimi, dëshira, vendimi dhe qëllimi për të kryer veprë penale, nuk mund të konsiderohen veprime në kuptimin penalo-juridik dhe nuk mund të ndëshkohet po që se ato nuk manifestohen në botën e jashtme. Për t'u konsideruar një veprim relevant në të dr. penale, ai duhet të jetë i vullnetshëm. I vullnetshëm konsiderohet ai veprim i cili është ndërmarrë dhe dirigjuar nga ana e personit të vetëdijshëm dhe në bazë të vullnetit të lire. Sipas së dr. penale nuk do të konsiderohen si veprim dhe nuk do të ndëshkohen sjelljet apo veprimet që ndërmerren apo shkaktohen pa vetëdije, rastësisht apo nëndikimin e dhunës apo kanosjes, psh., veprimi në gjumë, me ç'rast nëna ja zë frymën fonjës së vetë të posa lindur dhe e mbytë; apo personi duke ecur në trotuar për shkak të ngricës rrrshqet dhe me atë rast i shkakton lëndim tjetrit që është gjendur pranë tij. Kurse personi vepron me vetëdije, përkundër vullnetit të tij, në rastin kur nën ndikimin e dhunës apo kanosjes detyrohet të ndërmarrë veprimin e caktuar, psh., kur personi A ja drejton revolën personit B, që është duke punuar në sportelin e bankës dhe në këtë mënyrë e detyron që t'ia dorëzojë të gjitha të hollat që gjenden në kasafortë. Në të dr. penale janë të rëndësishme vetëm ato veprime të njeriut të cilat i përgjigjen ndonjë veprimi të përcaktuar në figurën ligjore të veprës penale përkatëse. Kjo është në harmoni me parimet e ligjshmërisë së veprës penale. Sipas kodit penal, vepra penale mund të kryhet me veprim ose me mosveprim. Mënyrën ndërmjet të së cilës manifestohet veprimi i kryerjes së veprës penale, në të dr. penale njihen dy lloje të veprave penale: vepra penale të kryera me veprim dhe me mosveprim. Ndërhyrjet në Kodin Penal kanë ndryshuar edhe afatin e provës. Pas paragrafit 2 të nenit 59 është shtuar paragrafi 3, i cili parashikon që për dënimet e dhëna deri në dy vjet burgim, të pezulluara nga gjykata, afati i provës është sa dyfishi i kohës së dënimit

me burgim të dhënë nga gjykata. Ndërkaq, afati i provës, me përjashtim të rregullit të parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, është 24 muaj deri në 5 vjet. Afati i provës fillon, nga e nesërmja shpalljes së vendimit të gjykatës që ka dhënë vendim për pezullimin e dënimit me burgim. Afati i provës mund të shkurtohet ose zgjatet në varësi të mënyrës së ekzekutimit të provës dhe kushteve personale të të dënuarit, por pa cenuar afatin minimal dhe maksimal të parashikuar në këtë paragraf.⁶⁵

2.5 Tentimvrasjet

Nocioni ligjor sipas KPM (n.19 p.1) 'ai i cili me paramendim do të fillojë kryerjen e veprës penale por nuk do të mbarojë, do të dënohet për tentim të veprës penale. Tentimi është vepra penale e filluar por e pambaruar, fillim me paramendim me kryerjen e veprës që ka mbetur e pakryer për shkak të ndonjë arsyeje, pavarësisht nga dëshira e kryerësit. Për të gjithë format e veprës së filluar dhe të pambaruar është karakteristikë mungesa e pasojës së veprës. Arsyetimi i dënimit të tentativës së veprës paraqet zgjerim të zonës dënuese në fazën e mëhershme të të gjitha veprat e rënda, që logjikisht imponohet pyetja për arsyeshmërinë e dënimit të tyre. Rreth kësaj paraqitet contest në mes të tre llojeve të teorive: objektive, subjektive dhe të përzeria. Teoritë subjektive si bazë të vetme e theksojnë dëshirën kriminale të kryerësit, secili veprim që është tregues i asaj dëshire duhet të trajtohet si tentativë, nëse pasoja shumë shpesh nuk shfaqet për shkak të rrethanave atëherë nuk ka arsye pse tentimi të dënohet ndryshe prej veprës së kryer. Teoritë objektive-subjektive e theksojnë rëndësinë e bazueshmërisë objektive dhe subjektive të dënimit të tentative. Figura e tentimit definicioni ligjor i tentimit përmban tre elemente: paramendim për kryerjen e veprës penale, fillimi i kryerjes së veprës dhe mosshfaqja e pasojës së tij. Elementi subjektiv në figurën e tentimit është paramendimi i kryerjes së veprës, ana subjektive e figurës së tentativës nuk dalohet prej asaj të figurës së veprës së kryer: kryerësi është i vetëdijshëm për të gjitha tiparet dhe e dëshiron ose pajtohet me shfaqjen e pasojës. Definicioni i përgaditjes (n.18 p.3 KPM) si veprim me të cilin krijohen kushte për kryerjen direkte të veprës dhe të cilët nuk paraqesin veprime të kryerjes nga njëra anë dhe nga ana tjetër e tentimit si fillim i kryerjes së veprës nuk mund t'i plotësojnë nuancat e kalimit prej fazës më të vogël nga ajo më e lartë dhe të sigurojnë prerje relevante penalo-juridike të sjelljes së shpeshtë kompleksive të kryerësit. Për të kryer një vepër penale, personi kalon nëpër një proces paraprak të veprimtarisë kriminale, duke filluar që nga lindja e mendimit për të kryer një vepër penale, shfaqja e këtij mendimi në botën e jashtme, ndërmarrja e veprimeve përgatitore, tentativa për të kryer veprën, dhe në fund, arritja e rezultatit të dëshiruar kriminal. Tentativa është veprimi që ka synuar drejtpërsëdrejti në kryerjen e veprës, por kjo nuk është kryer për shkaqe që nuk varen nga vullneti personit. Në fakt, kur vepra penale ka mbetur në tentativë do të thotë se, nuk kanë ardhur pasojat e dëshiruara, për shkaqe të pavarura nga vullneti i subjektit që ka ndërmarrë veprimet. Por kjo nuk nënkupton mos përgjegjësinë e

⁶⁵ Dr. Ismail Zejneli – Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë 2018, fq. 75

subjektit që ka tentuar të kryejë një veprë penale të caktuar. Në historinë e së drejtës penale, institutin e tentativës e hasim njëkohësisht me institutin e veprës penale. Nëse do t'i hidhnim një vështrim historisë të së drejtës penale do të vinim re se fazat e veprimtarisë paraprake kriminale, apo fazat para kryerjes së veprës penale, janë dënuar në mënyra të ndryshme në kohë të ndryshme historike. Në periudhën skllavopronare personi dënohej jo vetëm për veprën penale të kryera në mënyrë të plotë, por edhe për veprimtarinë paraprake kriminale. E drejta skllavopronare dënonte përgatitjen dhe tentativën. Kjo e drejtë dënonte dhe mendimin e shprehur në botën e jashtme edhe pse ai nuk shoqërohej me ndonjë veprim konkret. E drejta penale feudale, në përgjithësi, dënonte njëllë sikur vepra penale të kish përfunduar, si përgatitjen ashtu dhe tentativën. Ajo dënonte shfaqjen e mendimit në botën e jashtme dhe shkonte edhe më tutje se e drejta skllavopronare. Sipas kësaj të drejtë, personi dënohej edhe kur dyshohej se në mendjen e tij kishte lindur një mendim që ishte në kundërshtim me interesat e klasës në fuqi, sidomos me dogmat fetare. Mjaftonte që dikush të dyshohej se nuk pajtohej me interpretimin zyrtar të dogmave fetare për të përfunduar i djegur në turmën e druve. Pas revolucionit francez të shek.XIX, ideologë të ndryshëm i shpallën luftë arbitraritetit të së drejtës penale feudale. Ata ngritën parimin "*nullum crimen sine lege*", sipas të cilit nuk mund të konsiderohej veprë penale një veprë e cila nuk parashikohej si e tillë nga vetë ligji. Si një e arritur shumë e madhe e kësaj periudhe është edhe parimi se mendimi i shfaqur në botën e jashtme nuk mund të konsiderohej veprë penale dhe personi nuk mund të dënohej vetëm për shfaqjen e atij mendimi.⁶⁶

2.6 Dhuna fizike

Dhuna përkufizohet nga Organizata Botërore e Shëndetit si "përdorim i vullnetshëm i forcës a fuqisë fizike, si kërcënim ose e aplikuar, kundrejt një tjetri, person ose komunitet duke pasur me gjasë rezultate ose mundësi në dëmtime, vdekje, pasoja psikologjike, keqzhvillim, ose pamundësi", megjithëse grupi është i vetëdijshëm që përfshirja e "përdorimit të forcës" në përkufizimin e vet shtrihet përmbi kuptimit konvencional të fjalës siç shpesh justifikohet duke e quajtur instinkt natyror dhe kusht për dominim dhe afirmim e Uni-it mbi tjetrin e pra, kusht i ekzistencës fizike, nuk mund të lejojmë që ky instinkt të mbisundojë akoma në jetën shoqërore. Dhuna e karakterizuar si katastrofë thjeshtë e ardhur nga natyra si element i lëvizjeve në të, nuk mund të barazohet e as të krahasohet me dhunën historike të panevojshme të paramenduar dhe thurur nga vet njeriu për përfitime egoiste dhe që shkaktojnë dhimbje të hatashme mbi tjetrin. Logjika e së drejtës shtetërore dhe hyjnizimeve kombëtare që shkaktoi shkatërrime dhe vrasje masive e gjer shfarosje të tjetrit nuk zë vend në asnjë shkallëzim krahasues me natyrën dhe rrjedhat e saj. Kjo dhunë, është e njohur se rrjedh nga kombinimi i forcës dhe retorikës dinake të shtetit por dhe institucioneve më të vogla shoqërore, kuptuar këtu edhe familjen, për të shërbyer interesat e caktuara të

⁶⁶ Dr. Ismail Zejneli – Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë 2018, fq. 82-83

dhunuesit. Nuk është e rëndësishme tani të trajtojmë dhunën e bashkëlindur dhe atë të fituar se dhuna nga do qoftë ta ketë pikënisjen, pjellë ekstremizëm, luftë, shkatërrim e dhembje. Duke u nisur nga kjo, duhet kërkuar me ngulm rrugët dhe proceset për edukim cilësorë që nënkupton tolerancën, paqen bashkëjetesën dhe dashurinë. Jeta shoqërore, në raste të ndryshme ka nevojë për represion është fakt, por, asnjë represion nuk guxon të kalojë në dhunë ekseseve qoftë edhe për ndërprejen e izolimin e autorit – autorëve të dhunës. Paedukata, lakmia, padurimi, obsesionet, dallimet midis njerëzve dhe shteteve janë pikënisje të dhunës pas së cilës nganjëherë është më lehtë të kapesh se ti kundërvihesh prandaj dhe është më e guximshme kundërvënia se tolerimi i saj. Ku të kërkojmë guximin dhe formën më të suksesshme për të ç’rrenjosur dhunën? ‘Edukimi fillon njëzet vjet para se të lind fëmija’, dhe ky është burimi më begatshëm për të ju shmangur dhunës. Një edukim i brezërave i bazuar në parime të shëndosha humane « prodhon » njerëzimin me vlera dhe ndjenja cilësore që mënjanon dhunën fizike dhe verbale. "Është gjithashtu e rëndësishme që për çdo fëmijë, për çdo adoleshent të mësoj të qeverisë agresivitetin e vet në atë mënyrë që të mos shndërrohet në dhunë". Çdonjëri do të pranojë atë që e quejmë vartësi shoqërore, vartësi nga njëri tjetri e për njëri tjetrin në relacion njeri-njeri; njeri - botë shtazore; njeri – botë bimore dhe njeri natyrë e vdekur e anasjelltas. Ky princip i mospërrjashtimit të relacioneve të parapërmendura shterë burimin e dhunës që në rrënjët e saj. Kjo ndërpret edhe burimet tjera të thjeshta të dhunës sepse parandalon ngritjen e idesë së të drejtës totale dhe të fajit apo të padrejtës totale në marrëdhëniet e individit apo grupit me botën e jashtme. A nuk themi se dhuna sjellë dhunë? Të mbjellim paqe, që të korrim paqe!

2.7 Dhuna seksuale

Sjellja e të miturve çdo herë e ka shqetësuar rrethin dhe ka shkaktuar reagime të shumta pasi që çdo gjeneratë ka qëndrimet e veta specifike për problemet jetësore në përgjithësi kurse për problemet seksuale në vecanti. Ky lloj i kriminalitetit paraqet një rezikshmëri të vecantë ngase cënon lirinë dhe dinjitetin seksual si të viktimës ashtu edhe të familjes së saj e sidomos në raste kur si viktimë paraqiten fëmijët dhe të miturit të cilët nuk janë në gjendje të mbrohen vetë nga atakimet e tilla të dhunshme. Dhuna seksuale përpor që është objekt interesimi i të drejtës penale dhe kriminologjisë e njëjta trajtohet dhe në shkencat tjera sin ë ato mjekësore dhe psikologjike. Krimet seksuale e vecanërisht dhunimet seksuale te femrat e reja dhe fëmijët shkaktojnë pasoja të rënda në jetën e tyre të më vonshme. Këto veprime kriminale shkaktojnë ndryshime negative në jetën shpirtërore të viktimës sidomos në sjelljet dhe qëndrimet e tyre. Këta persona shpeshherë pas traumës të pësuar nga dhuna seksuale dhe vetë jepen pas veprimeve dhe sjelljeve tjera delikvente si meren me prostitucion, me vjedhje dhe me veprime tjera kriminale. Nga ana tjetër këta persona përjetojnë tronditje dhe crregullime të rënda psikike dhe shpirtërore nga të cilat

vështirë se arrijnë të lirohen gjatë jetës.⁶⁷ Vepra penale e dhunimit e paraparë në dispozitat ligjore paraqet vepër më tipike nga lëmi i delikteve seksuale. Përbëhet nga dhunimi i personit tjetër duke përdorur forcën apo klërcënimin se pas një kohe do të sulmohet jeta e saj apo trupi apo ndonjë person i afërm i tij. Ai që për tjetrin me përdorimin e forcës apo kërcënimit do të detyrojë në dhunim, do të dënohet me burgim prej 1 deri në 10 vite (Kodi penal i RM, neni 186, al.1). në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë forma më e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet nëse dikush e detyron personin tjetër me dhunë apo me kërcënim në aktin seksual dhe me këtë rast i shkakton lëndime të rënda trupore, vdekje apo pasoja të rënda apo nëse vepra është kryer nga disa persona. Në nenin 188 të KP të RM është paraparë dhe vepra penale sulmi seksual kundër fëmijëve, objekti i mbrojtjes së kësaj vepre penale është personaliteti i fëmijës që nuk e ka arritur moshën 14 vjeçare. Dhunë e seksualizuar është, nëse dikush ju sulmon me fjalë apo me vepra, që janë të nënkuptuara seksualisht dhe kur dikush dëshiron t'ju poshtërojë me këtë. Ky person cenon kufijtë tuaj, me qëllim që nëpërmjet kësaj të ndihet më i fuqishëm. Kjo është një padrejtësi dhe mund të ndëshkohet rëndë në Gjermani. Ka burra dhe pak gra që ushtrojnë dhunë të seksualizuar. Të prekur nga dhuna e seksualizuar mund të jenë të rritur dhe fëmijë, në shumicën e rasteve janë vajza dhe gra.

Format e dhunës seksuale

- Dikush flet me fjalë seksuale për ju dhe dëshiron t'ju fyejë me këtë.
- Dikush ju prek për shembull në gjoks ose prapanicë, edhe pse ju nuk e doni këtë.
- Dikush ju bezdis seksualisht në telefon, në internet, në një mesazh me përmbajtje seksuale.
- Dikush ju tregon pa ju pyetur ose kundër vullnetit tuaj fotografi ose filma pornografikë
- Dikush ju detyron për aktivitete seksuale ose dëshiron, që ju të shikoni gjatë kësaj.

Ka shumë forma të tjera të dhunës së seksualizuar. Është e rëndësishme që ju të keni besim tek ndjenjat tuaja dhe t'i merrni ato seriozisht. Askush nuk lejohet t'ju prekë seksualisht apo të ushtrojë dhunë ndaj jush kundër vullnetit tuaj. Ju vendosni vetë, çfarë dëshironi dhe çfarë jo. Edhe fëmijët mund të jenë viktimë e dhunës së seksualizuar. Njerëzit që përjetojnë dhunë të seksualizuar e kanë shpesh të vështirë të kërkojnë ndihmë. Ata shpesh kanë turp ose ndiehen fajtorë. Të kërkohet ndihmë, është shenjë e të qenit e fortë. Kjo tregon se ju nuk e pranoni, që dikush ju ka lënduar. Çdo grua, çdo burrë, çdo vajzë dhe çdo djalë ka të drejtë për ndihmë. Informacione për këshillim dhe ndihmë afër vendit ku jetoni mund t'i gjeni në zanzu.de, përmes telefonit për ndihmë „Dhuna ndaj grave“ ose tek i ngarkuari i pavarur me punë për çështjet e abuzimit seksual ndaj fëmijëve.⁶⁸

Klasifikimi i dhunës seksuale

⁶⁷ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2016, fq. 193

⁶⁸ Dr. Ismail Zejneli – Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë 2018, fq. 88

Sulmi seksual

Dhuna seksuale ndaj grave

Dhuna seksuale ndaj burrave

Sulmi seksual ndaj të miturve

Sulmi seksual.

Ky përfshinë kontakt seksual që merret nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës . Sulmi seksual është një akt i qëllimshëm i dhunës me bazë gjinore përmes shprehjes së pushtetit, kontrollit dhe dominimit mbi një tjetër. Ky është një manifestim i pa dëshiruar. Dhuna seksuale ndaj grave është pjesë e të gjitha kulturave të dominuara nga burrat. Për shkak të pozitës së nënshtruar të gruas në shoqëri, siguria e grave paraqet një shqetësim të veçantë, pasi që dhuna ndaj grave dhe vajzave është një fenomen i përhapur global. Viktima të dhunës seksuale janë edhe grate në Kosovë sidomos gjatë luftës së fundit të saj në vitet 1998/99. Ajo përfshinë përdhunimin dhe dhunën në familje, ngacmimet në punë dhe shkollë dhe dhunën seksuale në konflikte të armatosura. Gratë që kanë raportuar dhunën seksuale në disa komuna të Kosovës, si në Dragash është 1.70% , Gjilan 2.80% dhe në Gjakovë 3.50%, Kjo dallon në fshatra dhe qytete. Në zona urbane 4,30% dhe në zona rurale 1.80%. Dhuna seksuale ndaj burrave: Duhet të kuptohet që nuk janë vetëm femrat viktima të dhunës seksuale, por edhe meshkujtë. Në të shumtën e rasteve, dhuna ndaj burrave nuk denoncohet. Meshkujt dhe djemtë që janë sulmuar ose abuzuar seksualisht mund të kenë shumë ndjenja dhe reagime të njëjta si të mbijetuarit e tjerë të sulmit seksual, por gjithashtu mund të përballen me disa sfida shtesë për shkak të qëndrimeve shoqërore dhe stereotipeve rreth burrave dhe mashkullorësisë. Dhuna seksuale ndaj burrave në Dragash është 0.00%, Gjilan 2,10% dhe në Gjakovë 0.00%. Njëjtë sikur dhuna ndaj grave, po ashtu edhe kjo dallon në zona urbane 0.0 % dhe ato rurale 1,20%. Dhuna seksuale ndaj të miturve - një fenomen social global. Pedofilia në përgjithësi ka të bëjë me tendencën dhe sjelljet e të rriturve që kanë për qëllim të kenë marrëdhënie seksuale me fëmijë. Abuzimi seksual me fëmijë mund të bëhet në shumë forma: pornografi, prostitucion, trafikim i qenjeve njerzore, ngacmim e dhunë seksuale nga bashkëmoshatarët etj. Sipas statistikave nga UNICEF në disa komuna të Kosovës në vitin 2013, tregojnë se 6,50% e fëmijëve kanë përjetuar sulmim seksual, ndërsa dhunë psikologjike 32,30% dhe dhunë fizike 45,20% në shkolla. Nga kjo përqindje e dhunës seksuale 57,90% janë sulmuar djemtë dhe 32,30% e vajzave. Sipas mendimit të disa kriminologëve ndikim më të madh në paraqitjen e kriminalitetit e kanë faktorët e jashtëm kriminogjenë, sipas tyre faktorët e jashtëm ose egzogjenë paraqesin kushtet dhe rrethanat determinuese të sjelljes kriminale, ata ndikojnë në paraqitjen e aktivitetit kriminal në shoqëri, faktorët e jashtëm ose objektiv janë të shumtë dhe secili ka rëndësinë dhe rolin e vet në paraqitjen e sjelljes kriminale.⁶⁹ Në literaturën e cila trajton problematikën e faktorëve

⁶⁹ Prof. Dr. Ragip Halili – Kriminologja, Prishtinë 2008, fq. 188

kriminogjenë kemi disa ndarje të faktorëve objektivë dhe të jashtëm. Nga kërkimet empirike kriminologjike e sidomos duke marrë parasysh rezultatet e shënimeve dhe të dhënat statistikore mbi kriminalitetin në shumë vende vërehet se disa faktor objektiv apo të jashtëm kanë një ndikim më të madh se sa faktorët tjerë. Kushtet ekonomike të jetesës së të miturve luajnë një rol të rëndësishëm dhe kryesor në jetën e tyre dhe llogariten ndër faktorët kryesor në edukimin dhe zhvillimin e tyre. Krizat dhe depresionet ekonomike trajtohen si faktorë që kanë ndikim të dukshëm në sjelljet kriminale, rezultatet e kërkimeve dhe studimeve empirike të raporteve në mes krizave ekonomike dhe kriminalitetit tregojnë se në disa raste këto rrethana ndikojnë dukshëm në shtimin e disa formave të kriminalitetit si vjedhjet, mashtrimet, abuzimet, tregëtia e palejuar, prostitucioni.⁷⁰ Edhe kushtet e luftës kanë ndikim në paraqitjen e disa formave të kriminalitetit, ndikim i tillë mund të reflektohet në forma të ndryshme në varshmëri nga ajo se a bëhet fjalë për periudhën afër luftës, në luftë apo pas luftës. Gjatë kohës së luftës shumë fabrika i zvogëlojnë prodhimet e veta ose fare nuk prodhojnë dhe në këtë mënyrë fillon mungesa e të mirave material. Në këtë kohë i jepet shancë berzës së zezë dhe shumë matrapazëve të ndryshëm që në rend të parë i rrisin cmimet. Psikoza e luftës gjithashtu sjell harxhimin e mjeteve material, shumë familje nën mesataren në vrap që të sigurojnë artikuj të domosdoshëm ushqimor, i harxhojnë edhe ato pak mjete material që i kanë. Faza e pasluftës sjell deri te humbja e shumë personave që kanë rënë në luftë e kryesisht meshkuj, kështu paraqiten edhe familje të tjera deficente dhe me këtë rast kushtet e volitshme për paraqitjen e delikuencës së të miturve.⁷¹ Varfëria, si dhe banimi në bashkësi me tolerim të përgjithshëm të dhunës seksuale dhe sanksione kundër tij. Viktimat mund të ballafaqohen edhe me njelllosje nga ana e familjës, shokëve dhe bashkësive të tjera. Dhuna seksuale mundet thellësisht të prek mirëqenien fizike, mentale dhe sociale të viktimave.⁷²

Dhuna seksuale mundet thellësisht të prek mirëqenien fizike, mentale dhe sociale të viktimave. Ajo lidhet me pasoja shëndetësore të numërta ku hyjnë:

- Shtatëzania e padëshiruar,
- Komplikime gjinekologjike si gjakderdhje vaginale, fibroide, dhimbje kronike në Karlicata dhe infektive në traktin urinar,
- Sëmundje seksualisht të bartshme përfshirë këtu edhe HIV/SIDA.
- depresion,
- ç'rregullime stresore post-traumatike,
- mendime dhe sjellje vetëvrasëse.

⁷⁰ Ragip Halili, Kriminologjia Prishtinë 2016, fq. 246

⁷¹ Ragip Halili, Kriminologjia Prishtinë 2016, fq. 246.

⁷² R.Mlagjenoviq-Kupceviq. Vep.e cit.fq 174-175

Viktimat mund të ballafaqohen edhe me njollosjen nga ana e familjes, shokëve dhe bashkësive të tyre. Sektori shëndetësorë ka një rol të veçantë në përgjigjen e saj për viktimat e dhunës seksuale, nëpërmjet:

- grumbullimit të dëshmive mjekësore dhe juridike,
- trajnim të dhënësve të shërbimeve shëndetësore,
- ofrimi i llojeve tjera të shërbimeve.

Dokumentacioni mjekësoro-juridik për sulmet seksuale mund në masë të madhe t'i rrisë gjasat për arrestim të kryerësit, akuzimin e tij si dhe dënimin. Për fat të keq shërbimet mjekësoro-juridike në shumë vende nuk jepen në mënyrë rutine. Prej një rëndësie të veçantë është edhe trajnimi i punëtorve shëndetësor. Trajnim i till duhet t'u jep atyre më shumë njohuri dhe vetëdije për dhunën seksuale dhe të përmirësoj që në mënyrë më efektive ti zbulojnë dhe të mund të ballafaqohen me rastet e keqpërdorimit. Qasje tjera për luftë kundër dhunës seksuale koncentrohen në edukimin dhe ngritjen e vetëdijes ku hyjnë edhe programet educative nëpër shkolla dhe mjediset e tjera të cilët i trajtojnë marrëdhëniet gjinore, detyrimet seksuale dhe shkathtësit për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndosha. Shfrytëzohen edhe fushata nëpër medime dhe aktivitetet e bashkësive nëpërmjet grupeve të burrave dhe grave që të ndryshohen modelet destruktive të sjelljes si dhe qëndrimet publike kah dhuna seksuale.

2.8 Dhuna psiqike

Dhunën psiqike e ke përjetuar prej momentit kur je futur në këtë lidhje. Dhuna psiqike përbën fyerjen verbale, ofendimet, manipulimet ose izolimin nga miqtë dhe nga familjarët. Sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të gjitha gratë kanë të drejtën e mrojtjes nga dhuna, edhe nëse ato jetojnë në ndonjë shtet pa leje qendrimi. Edhe nëse juve ju mungonë leje qendrimi por jetoni në Suedi, askush. Nuk ka të drejtë të përdorë dhunë ndaj juve; askush në familjen e juaj, as shefi juaj, as qiradhënësi juaj, as personat zyrtarë e as policija. Kur dikush bën diqka kundër jush që ju nuk dëshironi; thuani jo! Ju keni të drejtë ta mbronni veten.⁷³ Në Suedi ekziston një ligj që quhet ligji i grave (Kvinnofridslagen). Në këtë ligj thuhet se gratë kanë të drejtë mbrojtjeje ndaj dhunës, nëpërmes për-shembull të banojë në të ashtuquajturat strehimore. Gratë kanë gjithashtu të drejtë mbështetje në kontakt me policin dhe gjykatën. Për fat të keq shpesh shkon ligji për të huajt para ligjit të grave kjo bënë që gratë që nuk kanë leje qendrimi nuk mund të marrin ndihmë. Kjo është vështirë që të marrin të holla nga komuna dhe t'ju japin ndihmë grave që janë pa leje qendrimi.⁷⁴ Komuna e Göteborgut ka marrë vendim në vitin 2010 që gratë që janë pa leje qendrimi, gjithashtu do të kenë mbrojtje nga dhuna. Kjo do të thotë që që komuna do t'i paguaj strehimoret që pranojnë gratë pa leje qendrimi. Për fat të keq nuk funksionojnë shumë mirë por është me rëndësi që ju ta

⁷³ Dr. Shefqet Muçi – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 231

⁷⁴ Dr. Hana Korac – Penologjia (prvo izdanje) Sarajevo 2009, fq. 200

dini që në komunën e Göteborgut ju mund të kërkonti ndihmë. Dhunë është për shembull: Dhuna fizike është shtymja dhe mbajtja me zor.⁷⁵ Dhunë psikike janë fjalët fyese, shantazh emocional, kërcnim për dhunë apo kontroll të jetës së juaj. Dhuna seksuale apo ngacmim: të kryejn seks me juve pa dëshirën tënde, të marrë juve me dhunë dhe të detyrojnë që të kryeni akt seksual pa dëshirën e juaj. Nëse ju jetoni në një marrëdhënie të dhunëshme është mirë të mendoni që: Të mbani kopje dokumente të rëndësishme, si përshembull pasa-portë dhe dokumente tjera identifikuese në një vend të sigurt. Të keni një çantë të mbushur me rroba, barna dhe gjëra të tjera që ju dhe fëmijët kanë nevojë. Respekti i plotë i personalitetit dhe nderit të njeriut si tërësi e vlerave individuale shoqërore përbën një imperative kryesore të jetës shoqërore, nuk do të ketë marrëdhënie ndër-njerëzore të vërtetë, jeta shoqërore harmonike dhe stabile pa respektimin e personalitetit të njeriut dhe vlerave të tij. Kërkesa për respektimin e personalitetit dhe dinjitetit nuk buron nga ndonjë filozofi individuale mirëpo ajo është një kërkesë shoqërore e determinuar si e tillë pasi që një shoqëri demokratike mund të ecë përpara vetëm duke respektuar dhe afirmuar vlerat e individit dhe dinjitetit të tij.⁷⁶ Nga e tërë kjo buron edhe rëndësia e veprave kundër nderit dhe autoritetit. Objekti i mbrojtjes së këtyre veprave penale është nderi dhe autoriteti. Nderi mund të kufizohet si një tërësi e vlerave humane, morale dhe shoqërore të njeriut si individ dhe si qenie shoqërore nga e cila buron kërkesa për pranimin dhe veprimin ndaj njeriut me edukatë, gjë që është shoqërisht e determinuar si një tërësi e atyre vlerave, ndërkaq me autoritet nënkuptojmë respektin që një person e gëzon në rrethin ku jeton, nderi dhe autoriteti janë të mira juridike të personalizuara në mënyrë strikte. Llogaritet se gjithkush është i ndershëm ‘quavis praesumitur bonus’ derisa me fakte nuk dëshmohet e kundërta mirëpo për disa vepra argumentimi i tillë nuk është i lejuar, dilemat rreth vërtetimit të rrethit të subjekteve passive largojnë disa kategori njerëzish pasagjerësh pa ndjenja të zhvilluara të nderit. Veprat penale kundër nderit dhe autoritetit mund të kryhen kundër secilit person, andaj objekt i këtyre veprave mund të jenë edhe fëmijët pa marrë parasysh moshën e tyre, si dhe personat psikikisht të sëmurë, subjekt i së drejtës për mbrojtje të nderit është dhe personi i dënuar pa marrë parasysh llojin e veprës dhe masën e dënimit, ndërkaq lidhur me personat e vdekur ata mund të jenë vetëm subjekt pasiv dhe nëse veprat e tilla penale janë kryer ndaj tyre procedura penale fillohet në bazë të padisë private të bashkëshortit, fëmijëve, prindërve, vëllezërve apo motrave të personit të vdekur, objekt i veprës penale kundër nderit dhe autoritetit mund të jenë edhe personat juridik.⁷⁷ Të gjitha kontaktet e rrezikshme, apo kërcënimet mes anëtarëve të familjes, ose mes bashkëshortëve dëshmojnë dhunën në familje, duke patur parasysh edhe dëmet materiale (pasurinë), metodën e kontrollës, hakmarrjes apo dënimet. Dhuna në familje përfshinë rrahjen, fyerjen, rënien me shuplakë ose shkuljen e flokëve. Si mjete për kërcënim mund të shërbejnë edhe sendet e rëndomta, por edhe armët. Dhuna në familje përfshinë fyerjet emocionale dhe verbale

⁷⁵ Dr. Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë 2016, fq. 193

⁷⁶ R. Mlagjenović-Kupcević. Vep. e cit. fq. 174-175

⁷⁷ Dr. Ragip Halili, Penologjia – Prishtinë 2014, fq. 259

(inferioritetin verbal) ose dhunën seksuale (akt seksual i padëshiruar). Secili mund të jetë viktimë e dhunës në familje. Dhuna është një fenomen që mund t'i ndodh ç'dokujt pa patur parasysh moshën apo grupën sociale ose ekonomike. Kjo mund t'ju ndodh edhe njerëzve me shkallë të ndryshme arsimimi. Rreziku mund t'ju kërcënohet të gjithë anëtarëve të familjes në mënyrë të balancuar.⁷⁸

Në këtë pjesë janë përpunuar të dhënat në formë tabelare mbi të burgosurit në burgun e Tetovës

Ndarja sipas Veprave penale të kryera në kuartale për vitet 2018 – 2019 në Burgun e Tetovës

Vepra penale kundër jetës dhe trupit	Vepra penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut	Vepra penale kundër lirisë seksuale dhe moralit	Vepra penale kundër shëndetit të njeriut	Vepra penale kundër pronës	Vepra penale kundër financave publike	Vepra penale kundër sigurisë në komunikacion	Vepër penale kundër shtetit	Vepër penale për keqpërdorim të detyrës zyrtare	Vepër penale si dhunë psikike në familje
3	3	1	14	10	1	4	1	1	11
7	5	2	18	16	1	1	2	8	3
7	3	1	10	12	1	1	8	3	0
4	3	1	13	16	1	1	8	3	0
9	2	1	20	18	3	1	12	3	0
7	22	18	3	1	1	11	2	0	0

Me ngjyrë të kuqe janë të dhënat e tre kuartaleve për vitin 2018 ndërsa me ngjyrë të kaltërt janë të dhënat për tre kuartalet për vitin 2019 (numrat janë të dënuarit)

Gjatë vitit 2018 Burgu i Tetovës ka pasur 50 të burgosur në katër raportin e katër mujtior të parë të këtij viti. Edhe atë 5 të burgosur (4 prej tyre për herë të parë ndërsa 1 me ripërsëritje) deri në moshën 25 vjeçare, 17 të burgosur deri në moshën 40 vjeçe (7 prej tyre për herë të parë ndërsa 10 me ripërsëritje), 8 të burgosur deri në moshën 50 vjeçe (4 prej tyre për herë të parë ndërsa 4 me ripërsëritje) dhe 1 i burgosur mbi 61 vjeç (1 me ripërsëritje) të burgimit, që gjithësejt 50 të burgosur prej tyre 29 për herë të parë duke vuajtur dënimin kurse 21 duke ripërsëritur dënimin. Prej tyre, me Vepër penale kundër jetës dhe trupit të njeriut të dënuar janë 3 të burgosur, 2 ptë burgosur vuajnë dënimin për Veprën penale vrasje, 3 të burgosur vuajnë dënimin për Veprën penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut, 3 të burgosur vuajnë dënimin për Veprën penale lëndim të të drejtës për grevë gjatë realizimit të lojërave të fatit, 1 i burgosur vuan dënimin për Veprën penale kundër orientimit seksual dhe 1 i burgosur vuan dënimin për Veprën penale përdhunim ndaj personave të palëvizshëm, 14 të burgosur vuajnë dënimin për Veprën penale kundër shëndetit të njeriut, 13 të burgosur vuajnë dënimin për Veprën penale prodhim dhe shitje të lëndëve

⁷⁸ Dr Shefqet Muçi – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 274

narkotike, 1 i burgosur vuan dënimin për Veprën penale të rëndë kundër shëndetit të njeriut, 10 të burgosur vuajnë dënimin për Veprën penale kundër pasurisë, 1 i burgosur vuan dënimin për Veprën penale vjedhje e rëndë dhe 7 të tjerë vuajnë dënimin për veprën penale vjedhje, 2 të burgosur vuajnë dënimin për Veprën penale mashtrim, 1 i burgosur vuan dënimin për Veprën penale për mashtrim në financa publike, 1 i burgosur vuan dënimin për Veprën penale mashtrim me mallëra doganore, 4 të burgosur vuajnë dënimin për veprën penale kundër sigurisë në komunikacion, 1 i burgosur vuan dënimin për Veprën penale kundër shtetit, 1 i burugusr vuan dënim për Veprën penale pjesëmarrje në ushtrinë armike, 1 i burgosur vuan dënimin për Veprën penale keqpërdorim detyre, 2 të burgosur vuajnë dënimin për Veprën penale dhunë, 2 të dënuar vuajnë dënimin për Veprën penale pjesëmarrje në terrorizëm, 1 i bugosur vuan dënimin për Veprën penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, 1 i burgosur vuan dënimin për Veprë penale tregëti me njerëz.

2.9 Përkatësia gjinore

Sa i përket përkatësisë gjinore, Burgu i Tetovës me vendim të organeve shtetërore disponon vetëm me pjesën e burgut për meshkuj dhe në asnjë rast nuk ka pasur të burgosura femra që nga themelimi si institucion ndërkohë që sipas kësaj i bie që përkatësia gjinore në këtë burg të jetë 100% mashkullore.

2.10 Moshë

Ndarja sipas moshës së të dënuarve në Burgun e Tetovës gjatë vuajtjes së dënimit në vitet 2018-2019

Nga 16-18 vjet	Nga 19-24 vjet	Nga 25-29 vjet	Nga 30-40 vjet	Nga 41-50 vjet	Nga 51-60 vjet	Mbi 61 vjet
/	5	5	17	8	14	1
/	12	11	16	14	6	4
/	3	6	13	17	5	3
/	3	6	16	11	10	5
/	11	12	25	11	8	2
/	10	11	19	16	7	3

Me ngjyrë të kuqe janë të dhënat e tre kuartaleve për vitin 2018 ndërsa me ngjyrë të kaltërt janë të dhënat për tre kuartalet për vitin 2019 (numrat janë të dënuarit)

Për dy vite (2018 – 2019) sipas hulumtimit të bërë dhe të ndarë nga tre kuartalet, moshë e të të dënuarve në Burgun e Tetovës varion nga më të ndryshmet ndërsa ata që vuajnë më së shumti dënimin janë moshë nga 25 vjet deri në 50 vjet.

2.11 Përgatitja shkollore

Ndarja sipas Përgatitjes shkollore të të dënuarve në Burgun e Tetovës gjatë viteve 2018 - 2019

Të pashkolluar	Me arsim fillorë	Me arsim të mesëm	Me arsim të lartë	Me master studime	Gjithësejt
2	17	30	0	0	50
2	29	32	0	0	63
0	28	19	0	0	47
2	27	20	0	2	51
2	40	24	0	3	69
2	45	17	1	1	66

Me ngjyrë të kuqe janë të dhënat e tre kuartaleve për vitin 2018 ndërsa me ngjyrë të kaltërt janë të dhënat për tre kuartalet për vitin 2019 (numrat janë të dënuarit)

Sipas përgatitjes shkollore, të dënuarit në Burgun e Tetovës gjatë periudhës së viteve 2018 – 2019 kryesisht janë me shkollim fillorë dhe të mesëm, ndërkohë që me arsim të lartë dhe me studime master thuhet nuk ka asnjë të burgosur gjatë kësaj periudhe, gjë që tregon se vetëdija e lartë por edhe përgatitja shkollore ndikon në kryerjen e veprave penale.

2.12 Përkatësia nacionale

Ndarja sipas Përkatësisë nacionale të të dënuarve në Burgun e Tetovës gjatë viteve 2018 - 2019

Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Rom	Serb	Të tjerë	Gjithësejt
10	38	0	1	0	1	50
11	49	0	1	1	1	63
7	39	0	0	0	1	47
9	41	0	0	0	1	51
5	61	1	3	0	0	69
6	56	1	3	0	0	66

Me ngjyrë të kuqe janë të dhënat e tre kuartaleve për vitin 2018 ndërsa me ngjyrë të kaltërt janë të dhënat për tre kuartalet për vitin 2019 (numrat janë të dënuarit)

Sipas përkatësisë nacionale, të dënuarit në Burgun e Tetovës gjatë periudhës së viteve 2018 – 2019 kryesojnë të burgosurit të nacionalitetit shqiptarë e pas tyre ato maqedonas, për shkak të hapësirës gjeografike ku është vendosur ky institucion derisa dihet që rajoni i Pollogut është i banuar kryesisht me popullatë shqiptare.

2.13 Gjendja shëndetësore

Ndarja sipas Gjendjes shëndetësore të të dënuarve në Burgun e Tetovës gjatë viteve 2018 – 2019

Me probleme shëndetësore	Me sëmundje kronike	Me sëmundje psiqike	Të varur nga droga	Me sëmundje infektive
277	92-5	5	4	3-1
213-25	34-0	48-3	1	1
242-14	133-12	66-1	5-1	0
216	151	127	35	7
224-20	168-18	104-4	30-2	1
140-8	92-10	56-8	16-4	1-4

Me ngjyrë të kuqe janë të dhënat e tre kuartaleve për vitin 2018 ndërsa me ngjyrë të kaltërt janë të dhënat për tre kuartalet për vitin 2019 (numrat janë të dënuarit)

Ndarja sipas Gjendjes shëndetësore të të dënuarve në Burgun e Tetovës në periudhën e viteve 2018 – 2019, kryesojnë të dënuar me sëmundje kronike e pas tyre edhe ato me sëmundje psiqike ndërkohë që të sëmurë me sëmundje infektive ka shumë pak, e gjithashtu edhe të varur nga droga dhe të ngjajshme janë në numër të ulët. Në këtë institucion sanksionues ekziston edhe njësi mjekësore në të cilën janë të punësuar personel që kujdeset për shëndetin e të burgosurve të cilët vuajnë dënimin për sëmundje më të lehta ndërkohë që për ato që pësojnë sëmundje më të rënda kujdeset Klinika.

KAPITULLI III

GJENDJA EMOCIONALE E TË BURGOSURVE QË NDIKON NË KRYERJEN E VEPRAVE PENALE DHE VUAJTJEN E DËNIMIT

3.1 Faktorët që ndikojnë në kryerjen e veprës penale ⁷⁹

Elementi themelor pa të cilin nuk ekziston vepra penale, si dukuri në botën e jashtme është akti. Për nocionin dhe karakteristikat e aktit të veprës penale në teorinë juridike ekzistojnë shumë kuptime. Këto janë: objektive, objektive-subjektive dhe kuptimi final. Sipas kuptimit *objektiv-subjektiv*, akti i veprës penale është sjellja e vetëdijshme dhe e vullnetshme e njeriut të cilin realizohet vepra penale. Sjellja që nuk është e vullnetshme (nëse është shkaktuar me procesin fiziologjik të – teshtimës, ëndrrës, ose veprimin të fuqisë së jashtme – me rrëshqitje në akull, nuk mund të konsiderohet vepër në kuptimin penalo-juridik. Nuk është e mjaftueshme që sjellja të jetë e vetëdijshme dhe e vullnetshme, por duhet të manifestohet në botën e jashtme. Kjo do të thotë që procesi psikik: mendimi, dëshira, vendimi dhe qëllimi që të kryhet vepra penale, nuk mund të kenë karakter të aktit në kuptimin penalojuridik, derisa të mos e marrin pamjen materiale dhe fizike në botën e jashtme. Sipas kuptimit objektiv akti i veprës penale paraqet ndërmarrjen e lëvizjes trupore ose mungesën e lëvizjes trupore, pa marrë parasysh mungesën e lëvizjes trupore, pa marrë parasysh nëse ndërmarrja ose mungesa janë realizuar me vullnet apo jo. Kështu që akti i kryer në gjendje të pavetëdijes ose nën ndikimin e fuqisë mbinatyrore, përkatësisht në kundërshtim me vullnetin e kryesit, konsiderohet akt i veprës penale. ⁸⁰ Idhtari më i njohur i këtij kuptimi është, Toma Zhivanoviq. ⁸¹ Sipas kuptimit finalist (synimi), që u formua në Gjermani, pas luftës së dytë botërore është veprimtaria finaliste, veprimtari që është ndërmarr me qëllim të realizimit të pasojës, që në dispozitat juridike-penale është e ndaluar. Domethënë për aktin e veprës penale nuk është i mjaftueshëm ekzistimi i vetëdijes dhe vullnetit, por duhet të ekzistojë qëllimi për ta ndërmarrë, përkatësisht orientimi. Akti është element themelor i veprës penale. Pa akt nuk mund të realizohet vepra penale. Në teori mund të gjenden mendimet, sipas të cilëve ekzistojnë veprat penale pa manifestimin e sjelljeve. Këto janë vepra penale të qëndrimit (psh. përvetësimi i gjësendeve, që janë të harruara në banesën e kryesit të veprës, kur akti nuk është i dukshëm, nga se nuk përbëhet nga lëvizja trupore. Megjithatë, këtu ekziston sjellja e reflektuar në qëndrimin e kryesit ndaj atij gjësendi, dhe ky është raporti i tij ndaj gjësendi si të ishte i vetë). Akti i veprës penale mund të kryhet në dy mënyra: me veprim apo mosveprim. Me veprim nënkuptohet sjellja e vetëdijshme dhe e vullnetshme e lëvizjes trupore, ndërsa me mosveprim lëshim të lëvizjes trupore. Sipas rregullës, akti kryhet me lëvizjet e trupit dhe me gjymtyrë, para së gjithash me

⁷⁹ Dr. Vlado Kambovski & Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq. 90

⁸⁰ Dr. Ragip Halili – Kriminologjia, Prishtinë 2018, fq. 135

⁸¹ E drejta penale (autorë të ndryshëm – skripta) fq. 32

lëvizjet e duarve. Por kjo mund të realizohet edhe me shqiptimin e fjalëve (p.sh. te deliktet verbale), si edhe ndonjë mënyrë të tjetër të sjelljes, akti mund të përbëhet nga një lëvizje, një veprimtarie që përfshinë disa lëvizje trupore ose me më shumë veprime. (psh. plaçkitja e banesës së huaj dhe rrëmbimi i gjësendeve tek vjedhjet e rënda). Kjo do të thotë që akti mund të jetë i thjeshtë dhe ndërlikuar.

3.2 Gjendja emocionale e të burgosurve gjatë kryerjes së veprës penale

Njëzet e dy për qind e të rinjve heteroseksual shfaqin probleme psikosomatike, prej të cilëve 45 për qind janë femra, të cilët treguan se kanë probleme psikosomatike më shumë se dy herë gjatë javës. 45 për qind e gjinisë femërore shfaqin nervozizëm ndërsa 27 për qind janë meshkuj, tregojnë të dhënat e fundit nga studimet mbi paraqitjen e simptomave psikopatike tek të rinjtë të cilat i shpjegoi psikologja Ana Propizova, të kryera në Maqedoninë e Veriut. I njëjti studim është kryer dhe në 48 shtete tjera të botës. Sipas Propizovës, këto studime përveç që paraqesin tregues të mirë për atë se në çfarë gjendje është shëndeti mendor tek të rinjtë në vendin tonë, janë tregues edhe për mos ballafaqimi me emocionet tona që çojnë që tek këta individë të paraqiten simptome psikopatike të cilat manifestohen me kokëdhimbje, dhimbje barku, alergji, vjellje, tension, dekoncentrim dhe të tjera. Ndërkaq këto të dhëna gjithashtu tregojnë se simptomat psikosomatike janë më të shprehura tek gjinia femërore ku kokëdhimbje ndjejnë 23 për qind e vajzave dhe 10% e meshkujve, vështirësi në përqendrim rreth 29% femra dhe 16% meshkuj ndërsa 43% e vajzave janë në gjendje depresioni dhe mendojnë edhe për vetëvrasje. “Si shoqëri ndërgjegjësimi i jetës emocionale dhe gjendja e shëndetit mendorë tek popullata e re janë në nivel të ulët, prandaj është e nevojshme trajtimi i temave ku do të bisedohet për emocionet dhe aftësi për menaxhimin e emocioneve. Ky është edhe trend botëror që të rinjve tu jepet mbështetje në mënyrë që ata ti zhvillojnë aftësitë se si të ballafaqohen me emocionet e tyre sepse nëse nuk dinë të ballafaqohen dhe ku të drejtohen lehtë këto mund të kalojnë në gjendje depresioni apo të përfundojnë edhe në tentim për vetëvrasje, si formë më e rënd”, tha Propizova.⁸² Psikologja Svetlana Asprovka theksoi se në këtë periudhë të kohës të rinjtë reagojnë dhe i përjetojnë në mënyrë më intensive emocionet tyre por edhe të tjerëve dhe sipas saj në këtë drejtim rol kryesor ka ndikim i rrjetet sociale. “Që një fëmijë të mësoj për emocionet e tij e rëndësishme është që ai duhet të kontaktojë individët me emocionet, ndërsa atë që po e bëjnë fëmijët tanë dhe i kushtojnë më shumë rëndësi janë rrjetet sociale ku shohin fotografi në të cilat emocionet janë të momentit dhe janë të rregulluara si për shembull selfiet. Në fotografi ne i rregullojmë emocionet sipas dëshirës dhe në këtë mënyrë askush nuk mund të të njoh se si ndjehesh dhe çfarë emocione ke realisht. Për këtë arsye me qëllim që të arrihet zhvillimi i një individi dhe pjekuria e tij emocionale e nevojshme është komunikimi me të rritur sepse ata emocionalisht janë më të pjekur dhe do të jen më të kuptueshëm”,

⁸² Hulumtim i kryer nga gazeta Koha (gazetarja Remzije Bilalli, botuar në datën 14 nëntor 2019) me titull: ‘Ndërgjegjësimi i jetës emocionale në nivel të ulët’

sqaroi Asprovaska. Nga ana tjetër psikologja Gordana Spiridonova theksoi se kjo gjendje ndikon edhe në shkollë dhe në të shumtën e rasteve mos kontrollimi i emocioneve çon deri tek përlëshjet verbale dhe ato fizike si dhe dekoncentrim në të mësuarit. “Në shtetet tjera sa i përket kompetencave emocionale në shkolla, punojnë në atë që ti përshkruajnë emocionet e tyre, motivet e emocioneve të tyre si dhe mënyrat e veprimit. Ekzistojnë edhe programe përkatëse për fëmijët me sjellje më agresive, të etiketuar si problematik dhe delinkuentët si dhe fëmijët të cilët të cilët janë të rrethuar nga një rreth me probleme. E nevojshme është që edhe ne të zhvillojmë programe të tilla, në mënyrë që ti ndihmojmë dhe t’i përkrahim të rinjtë në ballafaqimin me emocionet”, tha Spiridonova.

3.3 Shkaqet e kryerjes së veprës penale

Veprimi njëëzor është elementi kryesor në nocionin e veprës penale, vepra penale mund të paraqesë vetëm veprim të caktuar të njeriut,⁸³ sa i përket qëndrimit të veprimit në afatin e përgjithshëm të veprës penale, rrallëherë mendohet se nocioni i veprimit ka një natyrë të jashtëzakonshme dogmatike ose një vlerë estetike jashtëzakonisht arkitektonike në mënyrë që sistemi sistematik ndëshkues të mund të ndërtohet pa e përcaktuar këtë term.⁸⁴ Nocioni i veprimit nuk është vetëm nocion teorik por edhe ligjor. Ashtu, KPM në më shumë vende pjesën e përgjithshme e përdor shprehjen veprim apo kryerje por edhe shprehjen veprim. (n.18, 21, 22 etj). Në dispozitën e përgjithshme për mënyrën e kryerjes së veprës penale (n.29 p1), shprehimisht është përcaktuar se vepra penale mund të kryhet me veprim apo me mosveprim. Me definimin e këtij nocioni tërhiqet edhe rrethi i parë i sjelljeve që hyjnë në sferën penale, kufiri i parë i hapit të njeriut në zonën e së drejtës penale. Sipas kësaj vecanërisht me rëndësi është funksioni kufizues i nocionit të veprimit i shprehur nëpërmjet maksimës ‘Cogitationis poenam nemo patitur’ – askush nuk mund të dënohet për mendimet apo idetë e veta sadoqofshin ato monstruoze. Parimisht njeriu mund të dënohet vetëm për sjelljen e jashtme në kuptimin objektiv të drejtuar kah shkelja e të mirave juridike të mbrojtura me të drejtën penale.⁸⁵ Me veprim të kryerjes nënkuptohet veprimi me të cilin realizohet figura ligjore e veprës penale. Secila vepër penale ka veprimin e vet të kryerjes kurse ajo paraqet konkretizim të nocionit të përgjithshëm të veprimit. Veprimi i kryerjes është i domosdoshëm për përshkrimin ligjor të cdo vepre penale. Ligdhënësi gjatë përshkrimit të veprimit shfrytëzon teknika të ndryshme, duke filluar nga natyra e së mirës së mbrojtur dhe intensiteti i mbrojtjes së saj. Ashtu së pari veprimi mund të përshkruhet direkt si kryerje e caktuar apo mosveprim apo indirect nëpërmjet përshkrimit të pasojës që mund të shkaktohet me çfarëdo veprimi (ai që tjetër do të privojë nga jeta, n.123). nga veprimi i kryerjes duhet të dallohen veprimet përgaditore që ndërmeren para ndërmarjes së veprimit dhe që kanë për qëllim krijimin e kushteve kryesit me qëllim të kryerjes së veprës penale,

⁸³ Dr.Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, faqe 25

⁸⁴ Raxin, 1.74 teoria franceze nuk i kushton fare rëndësi, Pradel, 1.327

⁸⁵ Marinucci, 177

përgaditja e planifikuar dënohet ekskluzivisht vetëm në rastet e përcaktuara shprehimisht me ligj. Çështja e kauzalitetit është e rëndësishme për të drejtën penale sepse zgjidhja e kësaj çështje duhet të jap përgjigje se kur një veprë e ka shkaktuar pasojën e caktuar.⁸⁶

- Vendimi për të kryer veprën penale
- Veprimet përgatitore të cilat ndërmerren me qëllim të kryerjes së veprës penale
- Fillimi i kryerjes së veprës penale, që mund të ngel në tentativ
- Kryerja e veprës penale (vepra penale e përfunduar).

Këto katër faza nuk janë të domosdoshme të shprehen në çdo rast. (kryerja në afekt), andaj veprimet përgatitore mund të jenë të mundshme. Në mes veprimit dhe pasojës është e domosdoshme të ekzistojë marrëdhënia e caktuar e cila pasqyrohet me faktin se për shkak të veprimit të caktuar është shkaktuar pasoja e caktuar. Marrëdhënia e tillë quhet lidhje kauzale ndërsa veprën që e ka shkaktuar pasojën e quajmë shkak. Veprimi i kryerjes e fiton kuptimin e realizimit të figurës ligjore të veprës nëse paraqitet si shkak për paraqitjen e pasojës penalo-juridike e paraparë në atë figurë ligjore. Përcaktimi i rëndësisë së lidhjes kauzale midis veprimit të kryerjes dhe pasojës së veprës është supozim themelor për përgjegjësinë penale të kryerësit. Kështu në n.130 KPM, veprimi i kryerjes së veprës penale lëndimi i rëndë trupor është përshkruar nëpërmjet pasojës. E pakontestueshme se veprimi dhe pasoja nuk janë elemente të ndara në figurën ligjore të veprës por janë të vendosura në marrëdhënie në të cilët veprimi patjetër duhet të paraqitet si shkak për shkakrimin e pasojës, sipas kësaj nuk ka përgjegjësi penale për kryerësit e veprës së kryer nëse nuk vërtetohet se me veprimin e vet e ka shkaktuar pasojën relevante penalo-juridike. Sipas të drejtës sonë penale dhe të drejtave të shteteve bashkëkohore, kur personi vetëm ka vendosur për të kryer veprën penale, nuk mund të dënohet. Vetëm veprimet që ndërmerren jashtë psikikës së njeriut dhe nëse janë të parashikuara me ligj si vepra penale, hyjnë në sferën e së drejtës penale. Kur personi krijon një qelës fak nuk mund të mendojmë se ky person do ta përdorë këtë qelës për të kryer ndonjë veprë penale por ai mund ta përdor edhe për banesën e vetë. Personi edhe nëse ka kryer veprime përgatitore për të kryer ndonjë veprë penale, prapë ekziston mundësia që ai të heq dorë nga kryerja e veprës penale për shkaqe të ndryshme. Me përjashtim vetëm kur është fjala për përgatitje të veprimeve përgatitore për vepra penale shumë të rënda dhe nëse me ligj shprehimisht parashihen. Në aspektin juridiko-penal për t'u konsideruar se është kryer tentativa e veprës penale duhet të plotësohen tre kushte:

- që të ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale
- që veprimi të ndërmerret me dashje
- që vepra të mos përfundohet.

⁸⁶ Srzentic, Stajic, 69

Nocioni ligjor sipas KPM (n.19, p.1, ai i cili me paramendim do të fillojë kryerjen e veprës penale por nuk do të mbarojë do të dënohet për tentim të veprës penale. Tentimi është vepra penale e filluar por e pambaruar, fillimi me paramendim me kryerje të veprës që ka mbetur e pakryer për shkak të ndonjë arsyeje pavarësisht nga dëshira e kryerësit. Për të gjitha format e veprës së filluar dhe të përmbaruar është karakteristikë mungesa e pasojës së veprës. Vetëm se te forma themelore e tentimit të pasuksesshëm pasoja ka munguar kundër dëshirës së kryerësit (gabim në gjuajtje, fizikisht i penguar për të kryer veprën etj), te tentimi i papërshtatshëm ose kundër mjetit të papërshtatshëm dhe te heqja dorë vullnetare – sepse kryerësi vullnetarisht është tërhequr prej kryerjes së veprës. Arsyetimi i dënimit të tentativës së veprës, paraqet zgjerim të zonës dënuese në fazën e mëhershme të të gjitha veprat e rënda që logjikisht imponohet pyetja për arsyeshmërinë e dënimit të tyre, rreth kësaj paraqitet contest në mes tre lloje të teorive: objektive, subjektive dhe të përziera.⁸⁷ Sipas dispozitës ligjore për pregaditje (n.18, p.2 KPM) pregaditja me ligj mund të përcaktohet si vepër e posacme penale ose me ligj të caktohet dënimi për përgaditjen e veprës së caktuar penale. Dënimi i veprimeve pregaditore në përcaktimin e dënimit, ligjvënësi e ndjek një linjë më të butë duke u nisur nga ajo se bëhet fjalë për shkallë më të ulët të rezikimit të së mirës së mbrojtur. Por për disa forma të pregaditjes raporti i këtyre mirëdashës nuk vlenë dhe nuk duhet të vlejë. Kështu krijimi i shoqatës kriminale e llojit të organizatës ose shoqatës për të kryer vepra të rënda meriton qortim dhe dënim të barabartë por edhe më të rënda se veprat e kryera. Nga ana tjetër te veprimet jo të pavarura duhet të kemi parasysh edhe relacionin me dënimin e përcaktuar për veprën që pregaditjet si ajo në cdo rast duhet të jetë më e lartë prej dënimit të përcaktuar për përgaditjen e mjeteve për falsifikim dhe vetëfalsifikim.

Me veprimet përgatitore krijohen kushte për kryerjen efikase të veprës penale kurse me tentativë fillohet kryerja e veprës penale, ndërmeret veprimi i kryerjes.⁸⁸

-Tentativa e plotë (personi A shkep me revole në personin B mirëpo nuk e godet)

-Tentativa e metë (Personi A vetëm ja ka drejtuar revolen personit B)

-Tentativa e cilësuar (Personi A shkep me revole që ta privon nga jeta personin B po i shkakton vetëm lëndim trupor të rënd).

Kryerësi i cili ka përgaditur ose ka tentuar që të kryejë vepër penale por në mënyrë vullnetare është tërheqëur nga kryerja mund të lirohet prej dënimit (n.21, p.1 KPM).⁸⁹ Definicioni ligjor përfshinë dy shtate: heqja dorë vullnetare nga tentative do të thotë kru kryerësi ka filluar kryerjen e veprës por

⁸⁷ Montovani, 449

⁸⁸ Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli – E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, botimi i dytë Shkup 2017

⁸⁹ Dr. Vlado Kambovski & Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale, pjesa e përgjithshme Tetovë 2018, fq. 168-171.

vullnetarisht është tërhequr prej përfundimit të saj për dallim nga forma themelore e tentativës së pasuksesshme ku përjashtohet pasoja për shkak të rrethanave të pavarura prej dëshirës së kryerësit këtu ngelja e veprës në fazën e tentimit ka të bëjë me dëshirën e vet kryerësit. Shpjegimet e natyrës juridike të këtij institute dhe baza për privilegj të kryerësit lëvizin në kornizat e dy grupeve teorish. Teoritë ligjore nisen prej mosekzistimit të ndonjë elementi konstruktiv të vetë tentimit ndërsa ato kriminalo politike arsyetimin për këtë institute dhe veprimin e tij e kërkojnë në disa arsye themelore politico-kriminale për trajtim të privilegjuar të kryerësit që janë jashtë figurës së tentimit. Mendimi bashkëkohor penalo-juridik parimisht qëndron në pozicionin e koncepteve kriminalo politike. Më e popullarizuara është e ashtuquajtura teoria e urës së artë.⁹⁰ Shteti ka interes të mos vijë deri te cënimi i të mirës material dhe ligji penal duhet të stimulojë kryerësin në heqjen dorë nga vepra e tij, t'i jap mundësinë e kthimit nga 'ura e artë' kah sjellja e dobishme sociale dhe ligjore. Në këtë mënyrë, paqartësia në paraqitjen e tij nëse tërhiqet vullnetarisht nga kryerja e veprës penale e mbron të mirën ligjore më mirë se vet dënimi.⁹¹ Kritika që i jepet kësaj teorie është e drejtuar kah veprimi i supozuar psikologjik i premtimit të trajtimit të privilegjuar si nxitje për kryerësin që vullnetarisht ta ndërpresë kryerjen e veprës. Sipas teorisë së faljes kryerësi duhet të flaet sepse vullnetarisht ka hequr dorë prej kryerjes së veprës dhe ajo për të cilën meriton një falje të tillë është heqja dorë vullnetare.⁹² Sipas teorisë së qëllimit kur kryerësi heq dorë prej kryerjes së veprës është indikacion se dëshira e tij nuk ka qenë mjaft e fuqishme dhe nuk e ka arritur masën e nevojshme subjektive për dënim të tentimit. KPM përmban formulim të përgjithshëm për përcaktimin e anës objektive të heqjes dorë është e nevojshme kryerësi që ka tentuar të kryejë veprën penale të heq dorë nga kryerja e saj, prej këtij definimi është e qartë se për heqje dorë mund të bëhet fjalë në rastet kur kryerësi ka filluar me kryerjen e veprës dhe para se të jetë realizuar gjegjësisht para se të shkaktohet pasoja. Teoria dhe praktika gjyqësore kryesisht janë të pajtimit se heqja dorë nga tentimi i pakryer është ndalesë e mjaftueshme me veprimin e kryerjes, mosveprimit: kryerësi ka filluar por e ka ndëruar mendjen dhe nuk e ka kryer veprimin e kryerjes kështu qëndrimi i tij i mëtutjeshëm pasiv në tërheqjen prej veprimit ka rezultuar me mosshkaktimin e pasojës. Heqja dorë nga tentativa e papërfunduar⁹³ ndodh me ndërprerjen e aktiviteteve të mëtutjeshme, te tentativa e përfunduar sjellja e tij e mëtutjeshme pasive nuk është e mjaftueshme sepse në këtë rast do të vijë deri te shfaqja e pasojës. Heqja dorë nga tentative e përfunduar është munduar vetëm në rastin kur në mes veprimit dhe pasojës ekziston periudhë e caktuar kohore për zhvillim të mëtutjeshëm të rrjedhës kauzale në të cilën kryerësi mund të intervenojë ose më saktë kur pasoja nuk shfaqet menjëherë pas ndërmarjes së veprimit.

⁹⁰ Feuerbach, Liszt, 210, Tahovic, 252.

⁹¹ Schultheitss, 349

⁹² Krauthammer, 3, Mayer, 146, Baumann, 514, Bockelmann, 1, 183

⁹³ Dr. Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, faqe 30

-Bashkëpunim: kur në kryerjen e veprës penale marrin pjesë dy e më tepër persona.

-Bashkëpunëtor: Personat me veprimin e të cilëve është kryer vepra penale.

Pluraliteti i kryerësve nënkupton pjesëmarrjen e dy ose më shumë personave në kryerjen e një vepre penale (*concursum plurium in delictum*), nëse me aktivitetin e tyre të përbashkët janë realizuar figurat ligjore të më shumë veprave penale në të njejtën kohë flasim për pluralitet të kryerësve dhe për pluralitet të veprave të kryera. Në një pjesë të teorisë kjo problematikë shqyrtohet me emërues të përbashkët bashkëpjesëmarës ose pjesëmarje në kuptim më të gjerë që i përfshinë edhe bashkëkryerësit dhe bashkëpjesëmarësit në kuptim më të ngushtë (shtytje dhe ndihmesë). Për dallim nga situatë e thjeshtë e kryerjes së veprës penale nga ana e një kryerësi pjesëmarje e më shumë personave e hap së pari problemin e ndarjes së roleve të ndryshme dhe të identifikimit të pjesëmarrjes vetanake si kryerje, bashkëpjesëmarje ose pjesëmarje tjetër në vepër. Me këtë përcaktohen kufijtë e zonës kriminale të veprës penale gjegjësisht i të gjitha supozimeve objektive dhe subjektive prej të cilave ndonjë person vjenn nën goditje të normës penalo-juridike.⁹⁴ Është kontribut kauzal kah rezultati i përbashkët, pjesëmarës në vepër penale mund të jetë çdokush që me veprimin e tij ka kontribuar për kryerjen e veprës, megjithatë kontributi kauzal nuk është i mjaftushëm sepse pothuajse nuk ekziston vepër penale në të cilën në kuptimin objektiv nuk kanë marrë pjesë më shumë persona. Kompleksiviteti mjaft i ilustruar në këtë mënyrë i problematikës së pluralitetit të kryerësve multiplikohe nëse përveç këtyre dy supozimeve themelore më tej parashtrohet edhe pyetja për nocionin e veprës penale. Poashtu iniciativa e përbashkët kriminale mund të kalojë nëpër stadi ose fazë të ndryshme të veprës penale para kryerjes së veprës, dy ose më shumë persona meren vesh që të kryejnë vepra të tilla, në kohën e kryerjes së veprës njëri kryerës ta marrë veprimin e kryerjes kurse tjetri të ndihmojë, pas kryerjes së veprës kryerësi të fsheh të gjitha sendet e siguruar me veprën penale etj. Pas përcaktimit të supozimeve për klasifikimin dhe dëfinimin e pjesëmarësve të ndryshëm dhe për përgjegjësinë e tyre vijon çështja reaksionit penalo juridik pa të cilin diferencim i mëparshëm nuk do të kishte asnjë kuptim, e mundur është që për të gjithë pjesëmarësit të përcaktohet një dënim i vetëm sepse secili prej tyre me veprimin e tij ka kontribuar në rezultatin kriminal por është e mundur që ligji të parashohë qasje të diferencuar gjegjësisht dënim më të butë për disa forma të pjesëmarrjes në vepër.⁹⁵

Veprat penale të cilat kryhen në bashkëpunim:

-Terrorizmi,

-Trafikim me njerëz, me drogë, me armë,

-Forma e rënda të vrasjeve me motive politike apo për interes të pasurimit etj.

⁹⁴ Dr. Vlado Kambovski, 7.7

⁹⁵ Dr. Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, faqe 32

Lidhja objektive dhe subjektive

Objektive: secili bashkëpunëtor duhet të ndërmerri ndonjë veprim për ti ndihmuar veprës penale.

Subjektive: Të gjithë bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës së caktuar do të marrin pjesë, do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme.

Terrorizmi bashkëkohor nuk është në thelb të një dukurie të re, me terrorizëm nënkuptohet forma e organizimit të aktivitetit kriminal të cilin e karakterizon ndërmarrja e akteve të dhunës, kryerja e atentateve dhe rrëmbimeve, vënia e eksplozivëve, zjarreve dhe ndërmarrja e veprimeve tjera me rrezikshmëri të përgjithshme. Aktet terroriste kryhen me veprime të dhunshme ndaj jetës, shëndetit të njerëzve për shkak të veprimtarisë shtetërore apo të shërbimit publik, vënia e lëndëve plasëse, nëpërmjet rrëmbimit si formë e heqjes së paligjshme të lirisë e sequestrimit, e rrëmbimit të mjeteve të udhëtimit, sipas autorit Richard format kryesore dhe më të shpeshta të akteve terroriste janë: marrja dhe mbajtja e pengjeve, rrëmbimi i mjeteve të udhëtimit masiv, torturimi dhe vrasja e kundërshtarëve politik, duke përfshirë edhe zhdukjen e tyre, eksplozimet, bombardimi i vendeve të banuara me civil, shfrytëzimi i armëve për shkatërimin masiv dhe vrasja e civilëve. Sipas paragrafit 1 këtë veprë e kryen ai i cili me qëllim që të dëmtojë shtetin e huaj apo ndonjë organizatë ndërkombëtare që të rrëmbejë ndonjë person që do të shkaktojë eksplozim apo zjarr apo ndonjë veprim tjetër që do të shkaktojë rrezik për jetën e njerëzve dhe për pronën me vlera të konsiderueshme. Kryerësi i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person. Lidhur me fajësinë kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje direkte e cila duhet të përfshijë edhe qëllimin që të dëmtohet shteti tjetër. Për këtë veprë penale është paraparë dënimi me burgim prej së paku 3 vite. Forma më e rëndë e kësaj veprë penale është paraparë në paragrafin 3 dhe konsiderohet se kryhet nëse për shkak të veprës penale nga paragrafi 1 kryerësi me dashje i'a ka marrë jetën tjetrit, e cila ndëshkohet me dënim me burgim prej së paku 10 vitesh ose me dënim me burgim të përjetshëm. Nocioni i kryerësit mund të ndahet në kryerësi i vetëm kur nuk ka pjesëmarrës të tjerë në kryerjen e veprës penale dhe kryerësi i drejtëpërdrejtë kur përveç kryerësit të veprës penale marrin pjesë edhe persona të tjerë. Është e zakonshme që nocioni për kryerësin të përdoret si sinonim për kryerësin e drejtëpërdrejtë dhe ai është personi që i ka kryer të gjitha veprimet pavarësisht nëse ka edhe ndonjë pjesëmarrës tjetër në kryerjen e veprës në realizimin e figurës ligjore të veprës.⁹⁶ Kryerësi i veprës penale është personi i cili me veprimin e tij realizon të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të figurës ligjore të veprës. Rreth këtij definicioni ekziston shkallë e lartë e përputhshmërisë.⁹⁷ Përveç ndërmarrjes së veprimit të kryerjes statusi i kryerjes varet prej realizimit kumulativ edhe të karakteristikave të tjera objektive, që kanë të bëjnë me pasojën dhe lidhjen kauzale mënyrën dhe kohën e kryerjes së veprës, kundërligjshmërinë etj, kryerësi mund të ndërmarë vetë veprimin e kryerjes ose për realizimin e rezultatit

⁹⁶ Kambovski, 7.78 sever, 103

⁹⁷ Schultz, 127, edhe rezoluta VII e Kongresit ndërkombëtarë për të drejtën penale

kriminal të shfrytëzojë fuqi natyrore ose kafshë. Kryerësi i veprës penale mund të jetë edhe personi i papërgjegjshëm ose fëmijë por me kusht që sjellja e tij me të cilën realizohet figura ligjore e veprës të jetë shprehje e gjendjes së posaçme të rrezikshme të personit.⁹⁸ Nëse më shumë persona me pjesëmarrje në veprimin e kryerjes ose me ndonjë kontribut tjetër të posacëm ndihmojnë në realizimin e veprës ose së bashku kryejnë vepër penale secili prej tyre dënohet me dënim të paraparë për atë vepër. Ky është definimi ligjor (n.22 KPM) përmban dy situata ose më shumë bashkëkryerës së bashku e ndërmarin veprimin e kryerjes prej të cilëve disa janë veprime të kryerjes individualisht ose së bashku dhe disa nuk paraqesin veprime të kryerjes. Mendimi bashkëkohorë penalo-juridik dhe legjislativat përcaktohen për nocionin ekstensiv të bashkëkryerjes sipas të cilit kjo definohet si ndërmarje e përbashkët e veprimit të kryerjes por edhe si pjesëmarrje e përbashkët në vepër me ndërmarje të disa veprimeve tjera.⁹⁹ Ana objektive e bashkëkryerjes përbëhet në kryerjen e përbashkët të veprës me pjesëmarrje në veprimin e kryerjes ose me ndërmarje të veprimit tjetër që paraqet kontribut të posaçëm në kryerjen e veprës. Nuk do të ekzistonte asnjë problem nëse elementi objektiv do të të përbëhej vetëm në pjesëmarrjen e veprës së kryerjes. Specifika e vetme do të përbëhej prej faktit se veprimin e përbashkët me marrëveshje paraprake e ndërmarin dy ose më shumë persona ku secili prej tyre e ndërmer atë veprim deri në fund ose e ndërmer me marrëveshje paraprake vetëm një pjesë të veprimit të kryerjes. Ana subjektive e bashkëkryerjes paraqet marrëveshje për kryerjen e përbashkët të veprës, mund të arrihet para ose gjatë kryerjes së veprës, kështu është e mundur bashkëkryerja në veprën e vjedhjes, nëse dikush në mënyrë plotësuese i bashkangjitet kryerësit në marrjen e sendeve prej se ky e ka mposhtur rezistencën e viktimës. Lajthimi për ekzistimin e marrëveshjes për aksion të përbashkët terminologjikisht e përjashton bashkëkryerjen, kështu në rastin kur dikush fillon me kryerjen e veprës duke supozuar gabimisht se do t'i bashkohet edhe personi tjetër. Secili bashkëkryerës përgjigjet sikur ai vetë të ketë kryer veprën dhe mund të dënohet pa marrë parasysh dënimin e bashkëkryerësve të tjerë. Nëse dy ose më shumë persona ndërmarin aktivitet nga i cili rezulton shfaqja e përbashkët penalo juridike e pasojës por pa vetëdije dhe pa marrëveshje për veprim të përbashkët do të ekzistojë bashkëkryerjen e rastësishme gjegjësisht kryerje paralele. (Delicta manu propria)¹⁰⁰ janë vepra që mund të kryhen vetëm personalisht nga ana e atij që e ndërmer veprimin e kryerjes, kështu vepër personale është dhënia e deklaratës së rrejshme ose dezertimi. Veprat speciale (delicta propria) mund të jenë të kryera prej dy ose më shumë personave të bashkëkryerës por me kusht që secili prej tyre të ketë cilësinë që ligji e kërkon për kryerës të veprës. Sipas tekstit të ligjit (n.25 KPM) është e mundur dhe bashkëkryerja e pakujdesshme si dhe bashkëkryerja gjatë formave të ndryshme të fajta. Kryerja indirekte në kuptimin më të përgjithshëm definohet si kryerje të veprës

⁹⁸ Zlatarić, 2

⁹⁹ Dr. Vlado Kambovski & Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq. 158

¹⁰⁰ Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale pjesa e posaçme (cikël leksionesh), Tetovë 2017, fq. 25-30

nëpërmjet personit tjetër që shfrytëzohet si mjet për kryerjen e saj.¹⁰¹ Lajthimi, kryerja indirekte paraqet paramendim nga ana e kryerësit indirect ai duhet të dijë se shfrytëzon person tjetër që ai vetë nuk mund të jetë kryerës i veprës penale, kështu është e mundur që gabimisht të mendojë se e ka sjellë mjetin në lajthim në fakt por kjo të mos jetë lajthitje dhe në vetëdije të pranojë lojën e imponuar, nëse dikush e bind tjetrin të gjuajë në njeri duke e bindur në gjueti se bëhet fjalë për kafshë të fshehura në mal ndërsa ai i cili e gjuan saktë e di se për çfarë bëhet fjalë.

- Bashkëkryerja (neni 31KPK) - (dy e më tepër persona marrin pjesë në veprimin e kryerjes së vepër penale)
 - Shtytja (neni 32 KPK) - (teoria e përkufizon si ndërmarrje e veprimeve të atilla me të cilat personi tjetër me dashje shkaktohet ose forcohet vendimi për të kryer vepër penale)
 - Ndhurma (neni 33 KPK) – (ndërmarrje e veprimeve me të cilat një person me dashje ndihmon tjetrin të kryej vepër penale)
 - Bashkim kriminal (neni 34 KPK) – (organizata kriminale, grupi i personave, të cilat janë marrë vesh për të kryer vepër penale.)
- Ndëshkimi është i dyfishtë (pjesëmarrja, anëtarësimi dhe vepra e kryer).

I afërt me nocionin e veprës penale politike është nocioni i veprës së bindjes personale dhe të ndërgjegjes, nëse vepra politike është privilegjuar qoftë edhe në aspekt të ndalimit të ekstradimit në rradhë të parë për arsye se është kryer për shkak të bindjes së kryerësit në qëndrimet e tij në të drejta politike parashtrohet pyetja pse privilegjet të mos zgjerohen edhe ndaj formave të tjera të mundëshme të veprave të kryera me bindje tjetër të kryerësit i cili meriton respekt, për dallim nga e drejta më e vjetër e drejta penale bashkëkohore nuk u pranon asnjë status të posaçëm veprave të tjera të bindjes përveç veprave politike pas të cilave qëndron gjithashtu bindja personale.¹⁰² Rasti i posaçëm i veprës së bindjes ‘vepra e ndërgjegjes’ bëhet fjalë për vepër të kryer në ndeshjen në mes ndërgjegjes personale, bindjes dhe urdhërit të shqiptuar të ligjit, veprat e ndërgjegjes janë të kufizuara me mosplotësimin e normës imperative. Në të drejtën tonë penale shembull klasik për veprën e ndërgjegjes është vepra refuzimi i pranimit dhe përdorimit të armës (n.329 KPM). Përshkrimet ligjore të veprave të përbëra përfshijnë dy veprime të ndryshme që bashkë përbëjnë veprimin e kryerjes së veprës, varësisht nga kjo veprat penale të bërëra i ndajmë në vepra të drejta dhe jo të drejta penale. Veprat e drejta të përbëra janë kombinimi i dy veprimeve nga të cilat çdokush për vete paraqet vepër të posaçme, veprat jo të drejta të përbëra përbëhen nga dy veprime nga të cilat vetëm njëri prej tyre paraqet vepër të posaçme penale si përdhunimi (n.186) përbëhet nga përdorimi i

¹⁰¹ Dr. Ejup Sahiti & Prof. Dr. Ismail Zejneli – E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkurt 2017, fq. 116

¹⁰² Dr. Shefqet Muçi – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 275

forcës dhe dhunimi nga të cilat vepër e posacme penale është vetëm përdorimi i forcës. Duke marrë parasysh mënyrën për të ndërmarrë aktin të gjitha veprat penale ndahen në veprat penale të veprimit dhe veprat penale të mosveprimit. Veprat penale të veprimit apo komiseve janë veprat tek të cilat akti i kryer përbëhet nga sjellja pozitive, aktive, përkatësisht nga të ndërmarrët e sjelljeve trupore të vetëdijshme dhe të vullnetshme.¹⁰³ Veprat penale të mosveprimit ose omiseve, janë vepra të cilat akti i veprimit përbëhet nga sjellja negative, pasive, përkatësisht me vetëdije dhe vullnet e lëshojnë lëvizjen trupore. Vepra është kryer me mosveprim kur kryesi që ishte juridikisht i obliguar për të penguar fillimin e pasojës të përshkruar me ligj e ka lëshuar ta bëjë këtë, ndërsa sjellje e tillë me veprim të vetë dhe rëndësi është e njëjtë me veprën penale të veprimit. Lidhur me veprat penale të mosveprimit në teorinë praktike parashtrohet pyetja: kur mosveprimi mund të konsiderohet si shkaktar i pasojës, përkatësisht aktin e veprimit të veprës penale. Në përgjithësi është e pranuar pikëpamja se moskryerja mund të ketë karakter të aktit penalo-juridik, vetëm atëherë kur ekziston detyrimi, përkatësisht obligimi për mosveprim kështu që me moskryerjen e këtij obligimi mund të bëhet vepra penale, me ç'rast ky lëshim sipas veprimit dhe rëndësisë së vet barazohet me veprim.

Në bazë të besimit reciprok vendoset kontakti nga i cili pritët ndihma në rreziqet e caktuara). Veprat penale të mosveprimit ndahen në:

- 1) të drejta (të pastër),
- 2) jo të drejta (të papastra).

Veprat penale të mosveprimit¹⁰⁴ janë vepra që mund të kryhen vetëm me aktine mosveprimit, përkatësisht moskryerjen e obligimit të caktuar që është e përfshirë në normën urdhëruese (imperative) që të ndërmerret veprimi e caktuar me veprat penale të drejta të moskryerjes veprohet e kundërta e normës urdhëruese, kështu që ato realizohen me vet moskryerjen e detyrimit, pa marrë parasysh në pasojën, përkatësisht pa marrë parasysh në atë nëse me moskryerjen e obligimit pasoja do të mund të pengohet apo jo. Kështu këto vepra kanë karakter të veprave formale penale. Veprat penale jo të drejta të mosveprimit janë vepra që rregullisht kryhen me veprim, por mund të kryhen edhe me mosveprim. Ato edhe quhen vepra penale të veprimit me mosveprim (*delictum commissivum per omissionem*). Këto vepra të mosveprimit rrjedhin nga obligimi i kryesit për ta eliminuar pasojën nga e mira e mbrojtur. Obligimi i tillë bazohet në ligj, marrëveshje apo parime juridike, që detyrojnë për eliminimin e rrezikut që është krijuar me veprim paraprak për të mirën e mbrojtur dhe solidariteti që është domosdoshmëri për jetën e përbashkët.

¹⁰³ Dr. Ismet Salihu, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2003, faqe 35

¹⁰⁴ Dr. Shefqet Muçi – E drejta penale – pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012, fq. 276-277

Sipas kontributit në krijim e veprës penale mund të jetë:

- 1) akti i veprimit;
- 2) akti i nxitjes; dhe
- 3) akti i ndihmës.

Akti i veprimit është veprimtari me të cilën realizohet vepra penale me shkaktimin e pasojës. Ai është element qenësor i veprës penale, të përmbajtur në përshkrimin e veprës penale. Megjithatë, te disa vepra, ajo nuk është veçanërisht e theksuar në përshkrimin e veprës penale, kështu që në këto raste duhet të gjendet me interpretimin e domethënies të dispozitave ligjore.¹⁰⁵ Në disa raste për ekzistimin e veprës penale duhet të definohet mënyrat e parashikuar me ligj; mënyra, vendi dhe koha e ndërmarrjes të aktiv të veprimit. Akti i veprës penale mund të përcaktohet në mënyrë kumulative dhe alternative. Te përcaktimi kumulativ i ekzistimit të veprës penale është e nevojshme që të gjitha aktet e përfshira në përshkrimin e veprës të realizohen, sepse ato të gjitha bashkërisht përbëjnë një akt të veprimit.¹⁰⁶ Ky është akti i ashtuquajtur i veprimit shumëaktsh (p.sh. plaçkitja). Kur ligjvënësi përcakton më shumë veprime në mënyrë alternative, vepra penale ekziston nëse ndonjë prej akteve penale është realizuar, ngase secila prej tyre është ndërmarrë pavarur dhe e bën aktin e veprimit.(vjedhja e rëndë). Personi që e realizon aktin e veprimit quhet kryes i veprës penale. Në realizimin e aktit të veprimit mund të marrin pjesë më shumë persona dhe në këtë rast ata janë bashkëpjesëmarrës.¹⁰⁷ Përcaktimi i aktit të veprimit është i rëndësishëm për kualifikimin juridik të veprave penale, për përcaktimin e vendit dhe kohës së veprimit të veprës penale dhe për përcaktimin e tentimit. Veprimi i nxitjes dhe ndihmës parashikojnë se në aktin e veprës penale marrin pjesë më shumë persona.

¹⁰⁵ Dr. Hana Korac – Penologija (prvo izdanje) Sarajevo 2009, fq. 220

¹⁰⁶ Dr. Hana Korac – Penologija (prvo izdanje) Sarajevo 2009, fq. 221

¹⁰⁷ Dr. Ragip Halili, Penologija – Prishtinë 2014, fq. 210

KAPITULLI I VI

PARANDALIMI DHE MASAT PËR MBROJTJE TË BURGOSURVE NË SHOQËRI

4.1 Roli institucional prevenues

Paraqitja e dënimeve me burgim ka qenë një hap i madh drejt humanizmit të reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit e sidomos të tretmanit ndaj personave të dënuar. Nëse shikohet me kujdes rruga e zhvillimit të dënimeve me burgim që nga burgjet e para e deri te entet bashkëkohore do të vërehet se nëpërmjet mënyrës së ekzekutimit dhe trajtimit të personave të dënuar është shprehur filozofia retributive apo ajo e përmirësimit dhe riintegrit. Disa autorë mendojnë se ekzistojnë shumë sisteme disa të tjerë ato i përqëndrojnë vetëm në tre apo katër. Të këtilla sisteme konsiderohen: sistemi i burgut kolektiv, sistemi i qelisë, sistemi i heshtjes, sistemi i pikave, sistemi progresiv, ndërsa sisteme tjera që mbështeten në idetë bashkëkohore të riintegrit të personave të dënuar konsiderohen: sistemi i klasifikimit, sistemi bashkëkohorë modern etj.¹⁰⁸ Sipas këtij sistemi nuk ka klasifikim të të dënuarve ndodh që së bashku dënimin ta mbajnë të dënuarit për krime të rënda, recidivist, personat me karrierë të gjatë kriminale, personat e vjetër me të të miturim, kryerësit primarë me kryerësit sekondar etj. Si lokale për ekzekutimin e dënimeve me burgim gjatë aplikimit të këtij sistemi në fillim shërbenin: podrumet dhe lokalet e braktisura të fortesave, kështjellave, kalave dhe objekteve të vjetra ku kushtet e jetës ishin shumë të rënda.¹⁰⁹ Me sistemin e qelisë ose të izolimit të ekzekutimit të dënimit me burgim fillon zbatimi në jetë i disa ideve dhe propozimeve të reformatoreve të burgut kolektiv, madje në literaturën penologjike dhe juridiko-penale mendohet se vetëm me sistemin e izolimit fillon ekzekutimi i vërtetë i dënimit me burg. Kriminaliteti është një dukuri mjaft e ndërlikuar, prandaj është edhe kategori teorike, sepse në vete integron një numër të madh komponentesh të ndryshme. Të gjitha ato dimensione mund të pasqyrohen me anë të qasjes analitike. Ato janë mjaft të rëndësishme për të kuptuarit e vetë kriminalitetit, por edhe për shkak të qasjes komplekse ndaj kriminalitetit që pason nga analiza. Ai është në radhë të parë dukuri shoqërore, në të cilën mbështetet aspekti sociologjik i të kuptuarit të esencës së tij. Nga aspekti sociologjik kriminaliteti mund të interpretohet, gjithashtu, në disa mënyra, varësisht nga dispozitat teorike që merren nga opusi sociologjik si referenca për analizë. Si fenomen sociologjik kriminaliteti duhet të analizohet nga aspekti i tërësisë së shoqërisë, dmth si fenomen që është rezultat i raporteve dhe proceseve të përgjithshme shoqërore. Si e tillë, qasja sociologjike mund të na ndihmojë gjatë zbulimit të mekanizmave qenësor shoqëror që janë përgjegjës për lindjen dhe riprodhimin e kriminalitetit. Ato mund të jenë, psh: mënyra e prodhimit, struktura klasore e shoqërisë, lindja dhe zhvillimi i grupeve marginale shoqërore, ekzistimi i subkulturave etj. Aspekti sociologjik mund të na ndihmojë nga

¹⁰⁸ L.Arnaudovski, vep.e.cit.fq. 148-150

¹⁰⁹ H.D.Schwind, G.Blau. vep.e.cit. fq. 6-7

pikëpamja e perspektivës mikrosociologjike, d.m.th. për të kuptuarit e grupeve dhe të institucioneve të veçanta shoqërore, të çështjeve të organizimit dhe të (mos) funksionimit të tyre. Ky lloj i analizës sociologjike nuk merret me shkaqet “e thella” të kriminalitetit, por kriminaliteti vështrohet si dukuri konkrete që ndodhë në kushte konkrete, siç janë, p.sh. shkatërrimi i familjes, dezorganizimi social mosfunksionimi i institucioneve, shkatërrimi i bashkësisë lokale. Në fund, perspektiva sociologjike është mjaft e rëndësishme nga aspekti i vetë hulumtimit të fenomenit të kriminalitetit, dmth. nga aspekti i afirmimit “të metodës sociologjike” me rastin e hulumtimit të vetë kriminalitetit. Kriminaliteti, nga aspekti metodologjik, mund të hulumtohet në dy aspekte. Komisioni ndërkombëtarë për të drejtën penale dhe entet ndëshkimore i cili shkurt quhet edhe si Komision për burgje është një ndër organizatat e para që është marrë me problematikën e organizimit të burgjeve dhe trajtimin e personave të dënuar. Kongresi i parë i kësaj organizate ka trajtuar këto çështje: dënimet trupore dhe fizike ndaj të dënuarve gjatë vuajtjes së dënimit, arsimimin e personave të dënuar, mbikqyrjen e personave të dënuar të liruar me kusht, trajtimin e vecantë të recidivistëve, organizimin e punës së të dënuarve nëpër ente, trajtimin e femrave të dënuara dhe shumë çështje tjera të cilat më parë nuk ishin shtruar. Kongresi i II-të i mbajtur më 1878 në Stokholm përvec tjerave ka trajtuar edhe çështjen e organizimit dhe funksionimit të shkollimit dhe arsimimit të personave të dënuar, ndëshkim disiplinor të personave të dënuar, problematikë e lëshimit me kusht etj. Komisioni për çështje sociale i OKB-së fillon të merret në mënyrë permanente me përcjelljen dhe trajtimin e dukurisë së kriminalitetit në botë dhe veçmas me analizën dhe shqyrtimin e pozites së personave të burgosur nëpër institucionet korrektuese. Ky komision nëpër grupe rajonale konsultative ka trajtuar gati të gjitha çështjet aktuale rreth parandalimit të kriminalitetit dhe trajtimit të personave të dënuar. Është marrë me studimin dhe analizën e organizimit të burgjeve dhe institucioneve korrektuese dhe kushtet në të cilat personat e dënuar me burgim e mbajnë këtë dënim. Shoqata ndërkombëtare për mbrojtje shoqërore është gjithashtu një asociacion i njohur dhe me renome të madhe ndërkombëtare në lëminë e studimit dhe pengimit të kriminalitetit. Përfaqësuesit e saj kanë mbajtur disa kongrese dhe tubime shkencore lidhur me mënyrat e parandalimit të kriminalitetit dhe ekzekutimin e sanksioneve penale. Idetë dhe angazhimet e Lëvizjes për mbrojtje shoqërore lidhur me humanizmin dhe modernizimin e tretmanit ndaj personave të dënuar gjithmonë kanë zgjuar interes dhe kanë pasur jehonë të madhe ndërkombëtare, në këtë mënyrë shoqata e përmendur ka ndikim në paraqitjen e reformave rrënjësore penitensiare në shumë shtete. Shoqata ndërkombëtare për kriminologji është një ndër asociacionet e njohura dhe mjaft aktive në lëminë e studimit të kriminalitetit dhe në parandalimin e tij, kjo shoqatë prej themelimit e deri më sot ka mbajtur tubime shkencore dhe profesionale, në këto kongrese përvec temave tjera të përgjithshme janë shtruar edhe çështje që kanë të bëjnë me ekzekutimin e dënimit me burgim dhe procesin e riintegrit të personave të dënuar.

4.2 Roli i policisë në parandalimin e kriminalitetit ¹¹⁰

Veprimtaria e policisë është e shumëfishtë, policia duke vepruar në parandalimin dhe zbulimin e krimit i ofron prokurorit publik dhe gjykatësit material të nevojshëm për fillimin e procedurës penale gjatë zhvillimit të procedurës penale afron ndihmë kriminalistike lidhur me identifikimin e personave dhe të sendeve (marrja e shenjave të gishtërinjëve, marrja e materialeve biologjike për analizën e AND-së etj), LPP e ka bërë rikonstruimin e procedurës hetimore duke e kaluar veprimtarinë nëpërmjet tij dhe në kompetencë të policisë, me zgjidhjet e tilla janë zgjeruar autorizimet të cilat faktikisht i ushtron dhe më parë kur informacionet e siguruara prej saj ndonëse konsideroheshin si prova vetëm në kuptimin njohës e jo në kuptimin provues me praninë e tyre në shkresa të lëndës penale ato ushtronin ndikim të caktuar në procesin e të provuarit, dallimi esencial për sa u përket autorizimeve të reja të policisë qëndron në faktin se autorizimet që tani i ka policia në procedurë penale janë rregulluar qartë dhe përpiktë me norma procedural penale të cilat ajo dueht t'i respektojë në punën e vet. LPP aktual (nenet. 46, 48-52, 272, 279, 280-284 etj) i referohet policisë gjyqësore policisë së jurisprudence). ¹¹¹ Në të vërtetë sipas nenit 284 paragrafi 1 prokurori publik vet ose përmes policisë ose persona në qendrat hetuese të prokurorisë mbledhin njoftime të nevojshme për vendimarrje për kallëzimin penal kurse sipas nevojës atë e kryen edhe përmes policisë ose organeve hetuese për zbulim. Sipas nenit 41 paragrafi 1 prokurori udhëheq me procedurën parahetimore, ndërsa sipas nenit 283 paragrafi 2 policia është e obliguar që të veprojë sipas urdhërave dhe udhëzimeve të prokurorit në pajtim me nenin 284. Detyra e policisë është që sipas detyrës zyrtare ose me urdhër të prokurorisë të ndërmer masa dhe aktivitete me qëllim të zbulimit dhe hetimit kriminalistik të veprave penale, parandalimin e pasojave, kapjen dhe denoncimin e kryerësve të tyre, sigurimin e provave dhe masave tjera të cilat mund të shfrytëzohen për realizimin e papenguar të procedurës penale. Zbaton hetim dhe veprim të urdhëruar nga gjykata dhe prokuroria, detyrat e cekura i kryejnë eprorët dhe nëpunësit e policisë (neni 46). Eprorët janë udhëheqësit e njësive organizative të MPB, në Policinë financiare e Doganën të cilët janë në lidhje të drejtëpërdrejtë me prokurorinë sikundër që nëpunësit policor të këtyre njësive organizative në këto organe (neni 49). Për zbatim efikas të procedurës penale prokurori sipas nevojës me urdhër të tij i ndahen punë nëpunës nga neni 48 pika 1 të LPP dhe janë në dispozicion vetëm të prokurorit publik dhe realizojnë punë nën urdhërat e tij, punojnë në pajtim me sugjerimet dhe udhëzimet e tij dhe për punën e tyre referojnë vetëm para tij. Edhe pse parandalimi i kriminalitetit nuk është asgjë e re, shumë çështje dhe vështirësi duhet ende të zgjidhen. Ndër to janë edhe frika lidhur me bazat e ndryshme teorike për intervenime, implementimi i programeve, realiteti politik në kuadër të të cilit duhet të zhvillohet dhe të ekzistojë cilido program, mbështetja në

¹¹⁰ Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 175

¹¹¹ Konform nenit 21, paragrafi 9 dhe 10 'polici e jurisprudence' janë nëpunësit policor nga MPB dhe pjestarët e Policisë financiare dhe persona të autorizuar me ligj të Doganës ndërsa shprehja 'Polici' në LPP përdoret si emër i përgjithshëm për policinë e jurisprudence dhe pjestarët e policisë sipas Ligjit për polici si dhe pjestarët e Policisë ushtarake.

evoluimin joadekuat, dhe të frikës rreth zhvendosjes dhe difuzionit të dobisë. *Konkurrenca teoretike*- një debat i gjerë zhvillohet rreth sqarimit adekuat të sjelljes devijuese. Organizimi i dobët shoqëror, zgjedhja racionale dhe aktivitetet rutinore, shpesh herë merren si baza teoretike për programet e parandalimit të kriminalitetit. Mirëpo, shumë teori të tjera gjithashtu ofrojnë një shqyrtim të vlefshëm mbi intervencat. E drejta e procedurës penale si pjesë e sistemit juridik të një shoqërie bën pjesë në legjislacionin penal, në luftën kundër kriminalitetit ka për detyrë që juridikisht të rregullojë procedurën penale me të cilën duhet të ndriçohet dhe të zgjidhet çështja penale, ajo në masë të njejtë kontribon si për luftën preventive ashtu edhe në luftën repressive ndaj kriminalitetit, në këtë drejtim procedura penale paraqitet si mjet me të cilin sigurohet roli edukativ dhe shtrëngues i drejtësisë. Është fakt se nga kriminaliteti si dukuri shoqërore negative nuk ka qenë dhe aktualisht nuk është immune asnjë shoqëri pa marrë parasysh kohën e veprimit të saj dhe sot secila shoqëri njerëzore e organizuar në shtet nëpërmjet institucioneve të ndryshme ndërmerr masa preventive me të cilat synon të pengojë kryerjen e veprave penale, nuk ka dyshim se procesi i tillë i reagimit ndaj kriminalitetit është proces kompleks dhe i ndërlikuar por i domosdoshëm megjithatë nuk duhet pritur që procesi edukativ preventive sa do i rëndësishëm që është të sjell deri te pengimi dhe zhdukja e plotë e kriminalitetit. Në këtë drejtim është domosdoshmëri që shteti të angazhohet dhe në aspektin tjetër atë represiv të reagimit ndaj kriminalitetit, e quajmë represiv sepse procedura penale zbatohet kundër kryerësit të veprës penale pavarësisht nga vullneti i të pandehurit dhe sipas rregullit pavarësisht nëse këtë e dëshiron i dëmtuari, prandaj masa e reagimit kundër kriminalitetit të cilat ndërmeren në procedurë penale sikur gjithë veprimtaria në fushë juridiko penale i përkasin masave repressive në kuptimin e theksuar më sipër. Ligjvënësi duke inkriminuar veprimet që çenojnë rregullimin juridik dhe të drejtat e individit duke parë veprat penale sanksionet penale dhe kushtet nën të cilat sanksionet penale mund të shqiptohen si dhe duke e rregulluar procedurën penale kërkon nga organet shtetërore t'i shqiptojnë dhe t'i ekzekutojnë sanksionet penale ndaj kryerësve përgjegjës të veprave penale. Duke vepruar kështu efektivisht mund të ndikohet në pengimin e kriminalitetit në një anë dhe të bëhet ndëshkimi i atyre ndaj të cilëve masat preventive nuk kanë dhënë rezultat për moskryerje të veprave penale, nuk ka dyshim se lufimi me sukses i kriminalitetit nënkupton ndjekjen dhe ndëshkimin e kryerësve penalisht përgjegjës për veprën penale në anën tjetër, pozitivisht reflekton në mbrojtjen dhe përforcimin e marrëdhënieve të shëndosha shoqërore, në mbrojtjen e të drejtave të etniteteve, në mbrojtjen e të drejtave të individëve dhe grupeve tjera.

1. Evolucionit i procesit është unik dhe njëherësh më dominant. Ai fokusohet në atë që është bërë, kush e ka bërë, sa ka ndodhur kjo shpesh, sa njerëz kanë qenë të inkuadruar, si dhe në masat e tjera të ngjashme. Sipas rregullës e shpallin suksesin kur arrihet niveli i caktuar i pjesëmarrjes, i implementimit ose i mbulimit. Ajo që kësaj qasjeje i mungon është vlerësimi i efektit ndaj kriminalitetit dhe viktimizimit. Këto evolucione në këtë aspekt më së shumti janë ofruar me faktin që përmbajnë përshtypjet e njerëzve mbi suksesin. Mjerisht, ky tip i evolucionit edhe sot paraqitet tepër shpesh.

2. *Evolucioni i rrjedhës* ose *i efektit* është formë më e dobishme e evolucionit. Kjo kryesisht përfshinë informatat mbi procesin, a ka arritur intervenimi përfundimin e pritur – që është kryesisht dukuri e zvogëluar e kriminalitetit dhe e viktimizimit.

Vlerësimet e këtij tipi kërkojnë më shumë planifikim dhe përpjekje. Kujdesi duhet t'i përkushtohet zgjedhjes së grupeve që renditen, kornizës kohore të përcjelljes, masave të variablave të përfundimit, faktorëve potencialë pengues, dhe teknikave analitike. Shumë pjesëmarrës të programit nuk dinë ta bëjnë një evoluim të tillë, e shpeshherë edhe mjetet dhe koha janë aq të limituara sa ai ofron vetëm një zhvillim minimal. Si pasojë, për shumë programe me perspective kurrë nuk merret vesh se a kanë vërtetë efekt, gjë që shpie në njërin prej dy përfundimeve negative – vazhdimin joefikas ose suprimimin e programit të suksesshëm. Mirëpo, dy çështje të ndërlidhura që paraqiten në çdo diskutim mbi parandalimin e kriminalitetit janë zhvendosja e kriminalitetit dhe difuzioni i dobisë (“displacement and diffusion.”) Zhvendosja e kriminalitetit ka të bëjë me idenë që në vend që të eliminohet kriminaliteti ose viktimizimi, intervenimet thjesht orientohen në zhvendosjen e kriminalitetit nga një zonë në tjetrën, zhvendosjen e kriminalitetit në caqe të reja brenda të njëjtës zonë, ndryshimin e metodave që shfrytëzohen për kryerjen e një veprë penale, dhe nxitja e kriminelit për ndryshimin e llojit të veprës penale që e ushtrojnë). Fakti që kriminaliteti paraqet aktin tejet agresiv ndaj të mirave dhe vlerave të njeriut nuk arsyeton aplikimin e dhunës, përkatësisht të çfarëdo agresiviteti, kur është fjala për prevencionit shoqërorë. Duke pasur parasysh faktin që masat e prevencionit shoqëror ndërmerren para kryerjes së veprës penale, kur kërcënon vetëm rreziku nga kryerja e saj, nuk ekziston as baza ligjore për aplikimin e detyrimit, kështu që vetë detyrimi i tillë do të ishte i paligjshëm. Koncepti bashkëkohor i prevencionit shoqëror pikërisht insiston në masat humane jorepresive me pjesëmarrjen e subjekteve të shumta dhe të institucioneve në funksionet themelore të të cilave nuk janë paraparë metodat e represionit. Mirëpo, fakti që përvencioni shoqërorë është veprimtari jorepresive nuk do të thotë edhe respektim absolut i parimit të humanitetit në aplikimin dhe realizimin e tij, nëse veprimi i tillë është i papërshtatshëm dhe joracional. Kur është fjala për koncipimin e programeve preventive dhe rregullimin normativ të prevencionit në planin e brendshëm dhe ndërkombëtar, duhet nisur nga fakti i humanitetit që shprehet në dy fusha: në planin legjislativ dhe social dhe në aplikimin e masave preventive në praktikën e drejtpërdrejtë. Praktika si formë më e rëndësishme e

verifikimit të parimit të ligjshmërisë dhe të humanitetit në mënyrën më të plotë i konfirmon, përkatësisht i demanton ato parime. Nëse me aplikimin e masave dhe të aktiviteteve përkatëse në praktikë cenohet integriteti psikik dhe fizik i personalitetit, dinjiteti njerëzor, të drejtat dhe liritë themelore, dhe efektet e atyre masave preventive, sa do që të jenë pozitive, humbin rëndësinë dhe kuptimin e vet. Parimi i humanitetit është veçanërisht i rëndësishëm kur është fjala për raportin e policisë dhe të opinionit. Veprimtaria policore është formë e ushtrimit të pushtetit që i ekspozohet në mënyrën më të drejtpërdrejtë opinionit. Për këtë arsye raporti i policisë dhe i opinionit është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse në këtë raport shprehen dhe reflektohen proceset dhe veprimet demokratike. Pasi që policia, sipas natyrës së punës, është bartëse e autorizimeve dhe e shtrëngimit, ekziston bindja se ajo është edhe orientuese, përkatësisht rregullatore e raportit të vet me opinionin. Prandaj, është përgjegjësi e madhe policisë që atë raport ta ndërtojë, ta orientojë dhe përparojë në mënyrë që të kontribuojë në përmirësimin e raporteve demokratike në shoqëri. Tek e fundit, harmonizimi i raporteve të policisë dhe të opinionit zakonisht merret si kriter i kushtetutshmërisë dhe i punës demokratike të policisë. Në pengimin e kriminalitetit ndonjëherë është i domosdoshëm edhe aplikimi i masave represive të shtrëngimit me të cilat rrezikohen dhe cenohen të drejtat dhe liritë kushtetuese. Ndërkaq, kushtetuta dhe ligji kanë përcaktuar në mënyrë mjaft precise kushtet dhe kufijtë deri ku mund të rrezikohen të drejtat e tilla, përkatësisht të cenohen. Së këndejmi, parimi i humanitetit me të cilin mbrohen të drejtat dhe parimi i ligjshmërisë së veprimit të policisë janë në një lidhje shumë të ngushtë.

4.3 Legjislacioni dhe mbrojtja e të burgosurve ¹¹²

Sanksionet e caktuara, dënimi me burg, dënimi në para – gjoba ose ndonjë lloj tjetër i masave alternative të caktuara nga gjykata përkatëse për vepra penale të kryera, ekzekutohen kur vendimi me të cilin është caktuar dënimi do të hyjë në fuqi dhe kur nuk do të ekzistojnë pengesa ligjore për ekzekutimin e të njëjtit për shkak të parashtrimit të çfarëdo lloj ankese ligjore. Procesi është urgjent dhe e realizon gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve. Sipas dispozitave të ligjeve maqedonase për procedurë penale dhe ekzekutim të sanksioneve, gjykimeve dhe vendimeve hyjnë në fuqi kur nuk mund më tej të hidhen poshtë ankesat ose kur nuk janë të lejuara ankesat. Nëse nuk parashtrohet ankesë ose palët heqin dorë nga ankesa, vendimi bëhet i zbatueshëm me skadimin e afatit për ankesë. Gjykata kompetente për ekzekutimin e sanksioneve është gjykata sipas vendbanimit/vendqëndrimit të personit të dënuar. Sipas Ligjit për ekzekutim të sanksioneve, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta kryejmë menjëherë, dhe më së voni në afat prej tre ditësh kur vendimi hynë në fuqi. Procedura për referimin e të dënuarve në burg është urgjente. Gjykata për ekzekutimin e sanksioneve është e detyruar që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme për ekzekutimin e dënimit me burg menjëherë pas pranimit të vendimit ekzekutiv, ndërsa më

¹¹² Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 266

së voni në afat prej tetë ditësh pas pranimit të tij. Procedura për ekzekutimin e të gjithë gjykimeve në pjesën e dënimeve e udhëheq gjykatësi për sanksione, person të cilin duhet ta ketë çdo gjykatë themelore.

Ai mes tjerash vendos për:

- referencë për dhënien e dënimit me burg;
- zvarritje të vuajtjes së dënimit me burg;
- ndërprerje të vuajtjes së dënimit dhe hyrjen në fuqi ndalesën për vuajtje të dënimit me burg;
- vjetërsia e ekzekutimit të dënimit ose ndalesa për vuajtjen e dënimit për shkak të vdekjes së personit të gjykuar, informon gjykatën përkatëse për shkak të marrjes së vendimit të duhur;

Gjykata për ekzekutim të sanksioneve është e detyruar që të ketë qasje ndaj ekzekutimit të sanksioneve menjëherë pas marrjes së vendimit. Gjykata, në rastin kur i gjykuari nuk u paraqit në ekzekutimin e dënimit me burg në ditën e caktuar, menjëherë do t'i jep urdhër Ministrisë së Punëve të Brendshme për arrestim të personit të gjykuar, po ashtu, do të kërkojë që përderisa personi i gjykuar fshihet ose gjendet në arratisje, organi të nxjerr ose lëshon urdhër arresti për gjetje të personit të gjykuar për të vuajtur dënimin me burg të caktuar. Personit të gjykuar personalisht i dorëzohet akt drejtues në të cilën është shënuar dita kur duhet të paraqitet në ndërtesën e përcaktuar të burgut. Me aktin drejtues personi i gjykuar paralajmërohet se përderisa nuk paraqitet në ditën e caktuar, në burg do të futet me forcë. Personi i gjykuar prej momentit të marrjes së aktit drejtues për shkuarjen në burg deri me datën kur është shënuar akti për fillim të realizimit të dënimit duhet të ketë më së paku tetë ditë, më së shumtë 13 ditë kohë. Gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve me dorëzimin e aktit drejtues personit të gjykuar njëkohësisht njofton edhe burgun për ditën se kur i dënuari duhet të paraqitet. Nëse personi i gjykuar, në pajtim me aktin drejtues, nuk paraqitet në ditën e caktuar për kryerjen e dënimit me burg, burgu për duke mos e zgjatur do të njoftoi gjykatësin për ekzekutim të sanksioneve.¹¹³

Personi i dënuar i cili gjendet në liri mund me lutje të shtyjë fillimin e vuajtjes së dënimit me burg, nëse:

1. Gjenden në mjekim mjekësor prej ndonjë sëmundje më të rëndë akute ose varësie;
2. Ka pasur rast vdekje ose sëmundje më të rëndë në familjen e ngushtë të personit të gjykuar;
3. Shtyrja është e nevojshme për shkak të ekzekutimit ose përfundimin e punëve urgjente të papërfunduar ose punë sezonale, ose punë të shkaktuara për shkak të ndonjë fatkeqësie natyrore ose ndonjë fatkeqësi tjetër, ndërsa në familje personi i gjykuar nuk ka forcë tjetër punëtore;

¹¹³ Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 267.

4. Personi i gjykuar është i detyruar që të kryejë punën e caktuar të cilin e ka filluar, dhe për shkak të moskryerjes së asaj pune do të kishte dëm më të madh të dukshëm;
5. Shtyrja e dënimit kur personit të gjykuar i duhet për shkak të përfundimit të vitit shkollor ose për kalimin e provimeve për të cilët është përgatitur;
6. Së bashku me personin e gjykuar është gjykuar edhe partneri ose anëtarë të tjerë familjar, ose nëse ndonjëri prej tyre po vuan dënim, dhe me arrestimin e të gjithë këtyre personave për shkak të vuajtjes së dënimit do të rrezikohej mirëmbajtja e pleqve, personave të sëmurë ose anëtarë të mitur në familje, ose do të vinte në pikëpyetje ekonomin normale të familjes;
7. Gruaja e gjykuar, fëmija i të cilët është më e vogël se një vjet, ose është shtatzënë, dhe deri në lindje nuk kanë mbetur edhe tre muaj ose
8. Është e nevojshme që personi i gjykuar në kohët të caktuar të kujdeset për edukimin e ruajtjen e fëmijëve ose për përkujdesjen e personave të dobët për të cilët është e detyruar që të kujdeset, sipas mendimit të organeve për mbrojtje sociale në komunën në të cilën fëmijët ose ato personave kanë vendbanim ose vendqëndrim.

Kundër vendimit të marr me lutje për shtyrje të fillimit të vuajtjes së dënimit me burg, personi i gjykuar dhe prokurori publik përkatës kanë të drejtë për ankesë deri te këshilli penal në gjykatën kompetente për kryerjen e sanksioneve në afat prej tre ditësh deri në ditën e pranimit të vendimit të shkallës së parë. Ankesa zhvat ekzekutimin e dënimit. Këshilli penal është i detyruar që të merr vendim pas ankesës në afat prej tre ditësh pas pranimit të ankesës. Shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit me burg mund ta caktojë edhe gjykata përkatëse për vendosje par kërkesës për përmirësimin e procedurës penale (Gjykatën themelore), të parashtruar në shërbim të personit të gjykuar, me kërkesë për rishkrim të jashtëzakonshëm të një vendimi përfundimtar (Gjykata e Lartë) dhe me kërkesë për ndryshim të dënimit me burg në dënim me para, nën kushte të parapara me ligj.¹¹⁴

Ekzekutimi i dënimit me burg mund të shtyhet:

- Përderisa zgjat sëmundja, gjegjësisht mjekimi, nëse shtyrja kërkohet për shkak se personi i gjykuar gjendet në mjekim për shkak të ndonjë sëmundje më të rëndë akute ose varësia. Për shkak të arsyes specifike (hospitalizim për shkak të sëmundjes së rëndë akute ose varësisë) Ligji lejon lutje për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit mund ta vuaj partneri i tij, familjar nga gjaku në linjën e parë, prindi adoptues, fëmija i adaptua, vëllau, motra ose kujdestari. Personi i gjykuar

¹¹⁴ Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 268

të cilit i është shtyrë vuajtja e dënimit për këtë shkak është i detyruar që në çdo 30 ditë të dorëzojë fakt të vlefshëm për gjendjen e tij shëndetësore.

- Më së voni për tre muaj, nëse shtyrja kërkohet për shkak të vdekjes ose ndonjë sëmundje në familjen e afërt të personit të gjykuar; nëse shtyrja është e nevojshme për shkak të ekzekutimit ose përfundimit të punëve urgjente përgjysmë ose sezonale, ose punë të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, ose ndonjë fatkeqësie tjetër, dhe në familjen e të dënuarit nuk ka forcë të mjaftueshme punëtore; nëse shtyrja kërkohet për shkak se personi i gjykuar është i detyruar që të kryejë një punë të caktuar të cilën e ka filluar tashmë, dhe për shkak të mos kryerjes së asaj pune do të ketë dënim më të madh; dhe nëse është e nevojshme që personi i gjykuar për kohë të caktuar të kujdeset për edukimin dhe ruajtjen e fëmijëve ose kujdesin e personave të pafuqishëm për të cilët është i detyruar t'i kryejë, sipas mendimit të organeve për mbrojtje sociale në komunën në të cilën fëmijët ose ato persona banojnë ose kanë vendqëndrimin.
- Pas kryerjes së vitit shkollor nëse shtyrja personit të gjykuar i është e nevojshme për shkak të përfundimit të vitit shkollor ose
- Gjashtë muaj nëse shtyrja personit të dënuar i është e nevojshme për shkak të provimeve për të cilët është përgatitur;

Të paraburgosurit dhe të dënuarit ¹¹⁵ trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre. Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindjeje politike, fetare ose filozofike, orientimi seksual, identiteti gjinor gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, shtetësie ose përkatësie në një grup të caktuar ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim. Të miturit e paraburgosur dhe të dënuar trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore të tyre. Trajtimi mbështetet në interesin më të lartë të fëmijës, të integritetit shoqëror, edukimit dhe parandalimit të rifutjes në krim. ¹¹⁶ Gratë e paraburgosura dhe të dënuara trajtohen duke respektuar liritë dhe të drejtat themelore dhe pa diskriminim, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual ose psikologjik, vuajtje ose çdo formë tjetër abuzimi e keqtrajtimi që dënohen sipas ligjeve në fuqi. ¹¹⁷ Të paraburgosurve dhe të dënuarve me ç'rregullime të shëndetit mendor u garantohet trajtim i barabartë, jodiskriminues, duke respektuar integritetin fizik dhe dinjitetin njerëzor. ¹¹⁸ Trajtimi i tyre bëhet sipas standardeve shëndetësore, që

¹¹⁵ Dr. Ismail Zejnli – Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë 2018, fq. 114

¹¹⁶ Dr. Ragip Halili – Kriminologjia, Prishtinë 2008, fq. 241

¹¹⁷ Закон за Кривичната постапка, Службен весник на РМ бр. 150/2010, бр. 100/2012 Закон за извршување на санкциите од 29.12.2005 година, измени и дополнувања, 2010/2014/2015. 2017 година Јавност во кривичната постапка, прирачник за новинари ОБСЕ 2014 година

¹¹⁸ Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejnli – E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq. 203

zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me ç'rregullime të shëndetit mendor. Të paraburgosurve dhe të dënuarve me aftësi të kufizuar u garantohen liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, trajtimi jodiskriminues i ndonjë lloji, për shkak të aftësisë së kufizuar, duke plotësuar nevojat specifike për aftësimin dhe riaftësimin e tyre. Të paraburgosurit dhe të dënuarit e huaj ose pa shtetësi trajtohen duke mbajtur parasysh situatën e tyre të veçantë dhe nevojat individuale. Autoritetet e institucionit ndërmarrin veprime pozitive për të shmangur diskriminimin dhe për të zgjidhur probleme specifike, me të cilat këta persona përballen në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, gjatë transferimit dhe pas lirimit. Masat e veçanta, që janë të nevojshme të zbatohen për respektimin e lirive dhe të drejtave të grupeve të veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve nuk konsiderohen diskriminim, sipas këtij ligji. Të paraburgosurve dhe të dënuarve që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose seksuale, para ose gjatë qëndrimit në institucion, i ofrohen menjëherë masa mbrojtjeje, mbështetjeje dhe këshillime ligjore me qëllim rehabilitimin e tyre. Në rastet e dhunës ndaj grave dhe të miturave, mbahen parasysh nevojat specifike gjinore të tyre. Në raste të përdorimit të dhunës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, autoritetet e institucionit, në çdo rast, mundësojnë fillimin e menjëhershëm të një hetimi të pavarur, nga strukturat dhe organet kompetente të ngarkuara me ligj, duke respektuar parimin e privatësisë, mbrojtjes dhe sigurisë personale. Të drejtat e të paraburgosurit dhe të dënuarve, sipas këtij ligji, mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht për shkelje të ligjit ose rregullave të brendshme, vetëm në rastet dhe sipas kriterëve të parashikuara në këtë ligj. Të drejtat e të paraburgosurit dhe të dënuarve mund të kufizohen ose të hiqen përkohësisht në grup, me urdhër të ministrit të Drejtësisë vetëm në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme, për shkak të forcës madhore, të kryerjes së punimeve të rëndësishme në institucion ose kur ka rrezik për jetën dhe shëndetin e të paraburgosurit dhe të dënuarve në atë masë dhe për aq kohë sa përcaktohet në urdhër. Drejtuesi i institucionit dhe në mungesë të tij zëvendësi, për rastet urgjente mund të vendosin kufizime sipas paragrafit të parë të këtij neni dhe jo më vonë se 24 orë të marrë për këtë miratimin e Ministrit të Drejtësisë. Të paraburgosurit dhe të dënuarit kanë të drejtë të paraqesin kërkesa dhe të bëjnë ankime lidhur me zbatimin e ligjit dhe rregullave të brendshme në formën që përcaktohet në këtë ligj dhe në mënyrë individuale. Kërkesat dhe ankesat duhet t'i drejtohen, si rregull, organit kompetent sipas këtij ligji, por të paraburgosurit dhe të dënuarit kur e çmojnë me vend mund t'i drejtohen cilitdo organ shtetëror ose organizatë joqeveritare brenda dhe jashtë vendit. Trajnimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve synon rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Përgatitja për riintegrim fillon në paraburgim, vazhdon gjatë kryerjes së dënimit dhe pas lirimit nga burgu. Institucionet e ekzekutimeve të vendimeve penale, në bashkëpunim me shërbimin e provës, shërbimet e mirëqenies sociale, organet vendore dhe organizatat jofitimprurëse hartojnë programe riintegrimi prag-lirimi për adresimin e çështjeve gjinore. Për të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur përgatitja për riintegrim realizohet në bashkëpunim me të miturin, punonjësin social, familjen ose kujdestarin e tij. Për të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin

minoriteteve etnike dhe gjuhësore, të huajt dhe personat pa shtetësi, për aq sa është e mundur, mundësohen programe që respektojnë kulturën e tyre. Pas procesit të vlerësimit bëhet programimi i trajtimit, në bashkëpunim me të paraburgosurin ose të dënuarin. Për çdo të paraburgosur dhe të dënuar hartohet plani i riintegrit, ndërsa për kategoritë e veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve hartohet programi individual i trajtimit duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike të tyre.¹¹⁹ Rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psiko-social të të paraburgosurve dhe të dënuarve të mitur, të rinjve 18 deri 21 vjeç, grave, personave me çrregullime të shëndetit mendor, të pasura ose të fituara gjatë burgimit, personave me aftësi të kufizuar, personave me orientim seksual të ndryshëm, personave me sëmundje kronike ose në varësi të drogës, të moshuarve, personave të dënuar me dënime afatgjatë, personave që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi. Për çdo të mitur të paraburgosur ose të dënuar përgatitet një plan individual rehabilitimi dhe riintegrimi, i cili merr në konsideratë arsimin e tij, vlerësimin psikologjik, situatën emocionale, dëshirat dhe mundësitë e tij/saj për të ndjekur kurse profesionale ose për të avancuar në arsim. Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse. Bashkëpunimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës për hartimin, zhvillimin, realizimin e programeve të mbikëqyrjes së të paraburgosurve dhe të të dënuarve bëhet me urdhër të nxjerrë nga Ministri i Drejtësisë. Kontributi i organizatave jofitimprurëse dhe individëve të veçantë inkurajohet dhe mbështetet nga administrata e burgjeve në realizimin e programit të trajtimit.¹²⁰

4.4 Mbrojtja juridiko-penale e të burgosurve¹²¹

Institucionet e ekzekutimit të vendimeve me burgim janë:

Burgu i sigurisë së lartë

Burgu i zakonshëm

Burgu i sigurisë së ulët

Institute të veçanta

Institucion paraburgimi

Krijimi, klasifikimi dhe mbyllja e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim apo seksioneve të veçanta në këto institucione bëhen me urdhër të ministrit të Drejtësisë. Funksionimi, administrimi, kontraktimi, si dhe rregullat që përcaktojnë elementet e sigurisë në institucionet private të ekzekutimit të vendimeve penale përcaktohen sipas legjisllacionit në fuqi dhe me vendim të Këshillit të

¹¹⁹ Dr. Vlado Kambovski & Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetovë 2018, fq. 296

¹²⁰ Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 247

¹²¹ Dr. Ragip Halili – Penologjia, E drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 247

Ministrave. Në institucionet private të ekzekutimit të vendimeve penale vendosen të dënuar, për të cilët është caktuar si masë dënimi në maksimum deri në 5 vjet burgim. Burgu i sigurisë së lartë është institucioni ku ekzekutohen vendimet me burgim për subjekte të krimit të organizuar dhe të dënuar të tjerë të cilët në kryerjen e veprës penale ose gjatë vuajtjes së dënimit janë karakterizuar nga qëndrime e sjellje që bëjnë të pamundur qëndrimin në burgjet e kategorive të tjera. Vendosja e të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë kur nuk është shprehur gjykata me vendim, bëhet me kërkesë të prokurorit tek ajo gjykatë. Ndryshimi i klasifikimit të sigurisë nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të sigurisë së lartë në institucione të tjera të ekzekutimit të dënimit bëhet me kërkesë të prokurorit, të dënuarit ose përfaqësuesit të tij ligjor, pranë gjykatës së rrethit gjyqësor ku ndodhet institucioni. Transferimi nga burgu i sigurisë së lartë në institucionet e tjera të vuajtjes së dënimit bëhet me kërkesë të vetë të dënuarit, pranë gjykatës ku ndodhet institucioni. Në burgjet e sigurisë së lartë, vihen kufizime në të drejtat e të dënuarit, në rastet dhe sipas kriterëve të përcaktuara shprehimisht në këtë ligj.

Në burgjet e kategorive të tjera me urdhër të ministrit të Drejtësisë mund të krijohen seksione të burgut të sigurisë së lartë, në të cilat zbatohen rregullat e mësipërme.

1. Në raste të veçanta, sipas përcaktimeve të këtij neni, një regjim i posaçëm i ushtrimit të të drejtave mund zbatohet për të dënuarit në burgun e sigurisë së lartë dhe të paraburgosurit që hetohen apo gjykohen për këto vepra penale, të parashikuara në nenet 79, shkronja “ç”, 79/a, 79/b, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 234, 234/a, 234/b, 283, paragrafi 3, 283/a, paragrafi 3, 284, paragrafi 3, 284/a, 284/c, paragrafi 3, 284/ç, paragrafi 3, 333, 333/a dhe 334 të Kodit Penal, të kryera në kuadër të pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste ose për vepra me qëllime terroriste.

2. Vendimi për vendosjen e të dënuarit ose të paraburgosurit në regjimin e posaçëm në burgun e sigurisë së lartë merret nga ministri i Drejtësisë mbi kërkesën e arsyetuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pas konsultimit me ministrin e Brendshëm, bazuar në të dhënat/informacionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Shërbimit Informativ Shtetëror, Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe organeve të specializuara në luftën kundër krimit të organizuar e terrorizmit, sipas fushave të përgjegjësisë.

3. Vendosja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë bazohet vetëm në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë dhe/ose parandalimin e komunikimit me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, të referuara në pikën 1, të këtij neni, nëpërmjet marrjes së masave të brendshme dhe të jashtme të sigurisë së lartë, që lidhen, kryesisht, me nevojën për të parandaluar:

- kontaktet me organizatën kriminale ku bëjnë pjesë apo me organizata të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;
- konfliktet e mundshme me elementë të organizatave të tjera;
- ndërveprimin me të burgosurit apo të paraburgosurit e tjerë, të cilët i përkasin së njëjtës organizatë ose të organizatave të tjera, me të cilat ata bashkëpunojnë;
- komunikimin apo shkëmbimin e sendeve ndërmjet të dënuarve apo të paraburgosurve.

Sanksionet ¹²² e caktuara, dënimi me burg, dënimi në para – gjoha ose ndonjë lloj tjetër i masave alternative të caktuara nga gjykata përkatëse për vepra penale të kryera, ekzekutohen kur vendimi me të cilin është caktuar dënimi do të hyjë në fuqi dhe kur nuk do të ekzistojnë pengesa ligjore për ekzekutimin e të njëjtit për shkak të parashtrimit të çfarëdo lloj ankese ligjore. Procesi është urgjent dhe e realizon gjykatësi për ekzekutimin e sanksioneve. Sipas dispozitave të ligjeve maqedonase për procedurë penale dhe ekzekutim të sanksioneve, gjykimeve dhe vendimeve hyjnë në fuqi kur nuk mund më tej të hidhen poshtë ankesat ose kur nuk janë të lejuara ankesat. Nëse nuk parashtrohet ankesë ose palët heqin dorë nga ankesa, vendimi bëhet i zbatueshëm me skadimin e afatit për ankesë. Gjykata kompetente për ekzekutimin e sanksioneve është gjykata sipas vendbanimit/vendqëndrimit të personit të dënuar. Sipas Ligjit për ekzekutim të sanksioneve, gjykata e shkallës së parë është e detyruar që ta kryejmë menjëherë, dhe më së voni në afat prej tre ditësh kur vendimi hynë në fuqi. Procedura për referimin e të dënuarve në burg është urgjente. Gjykata për ekzekutimin e sanksioneve është e detyruar që të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme për ekzekutimin e dënimit me burg menjëherë pas pranimit të vendimit ekzekutiv, ndërsa më së voni në afat prej tetë ditësh pas pranimit të tij. Lejimin e një takimi familjar në muaj, i cili kryhet në intervale të rregullta kohore dhe në mjedise të caktuara, ku ndalohej hyrja e personave apo sendeve të tjera dhe që i nënshtrohen regjistrimit audio dhe video. Me termin “familjarë” nënkuptohen të paralindurit, të paslindurit, bashkëshortët dhe bashkëjetuesit. Takimi me persona të ndryshëm nga familjarët, për personat e dënuar, lejohet me propozimin e drejtorit të institucionit dhe me miratimin e ministrit të Drejtësisë. Për personat e paraburgosur, takimi me persona të ndryshëm nga familjarët lejohet vetëm me miratimin e prokurorit.

Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për takimet me avokatët mbrojtës:

- lejimin e të dënuarit ose të paraburgosurit, i cili nuk kryen takime familjare, për kryerjen një bisede telefonike në muaj, me kohëzgjatje maksimale dhjetë minuta, e cila regjistrohet. Kryerja e bisedave telefonike për personat e dënuar autorizohet me vendim të arsyetuar të Drejtorit të

¹²² Dr. Ragip Halili – Penologjia, e drejta e ekzekutimit të sanksioneve penale, Prishtinë 2014, fq. 235

Përgjithshëm të Burgjeve, kurse, për personat e paraburgosur, ajo autorizohet me vendim të arsyetuar të prokurorit. Parashikimet e këtij paragrafi nuk zbatohen për kryerjen e bisedave telefonike me institucionin e Avokatit të Popullit dhe me organizata vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e të drejtave të njeriut;

-ndalimin e përdorimit të vlerave monetare, sendeve dhe objekteve që mund të marrë i dënuari ose i paraburgosuri nga jashtë, sipas parashikimeve në rregulloren e brendshme të institucionit;

-kontrollin e korrespondencës, përveç asaj me subjektet e përcaktuara në nenin 43, të këtij ligji, ose me organizata ndërkombëtare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut;

-reduktimin e qëndrimit në ajrim në mjedise të hapura, deri në 2 orë, por jo më pak se 1 orë në ditë;

-përrjashtimin nga organet përfaqësuese të të dënuarve apo të paraburgosurve.

1.Kohëzgjatja e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave në burgun e sigurisë së lartë është një vit. Me kërkesë të të dënuarit ose të paraburgosurit, pas një periudhe njëvjeçare, ministri i Drejtësisë, në bazë të propozimit të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mund të rivlerësojë nëse janë kushtet për vazhdimin e regjimit të posaçëm të ushtrimit të të drejtave ndaj të dënuarit ose të paraburgosurit.

2.Kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë, për vendosjen apo zgjatjen e regjimit të posaçëm, i dënuari, i paraburgosuri apo avokati mbrojtës mund të paraqesin kërkesë ankimore brenda 20 ditëve, nga momenti i njoftimit të vendimit.

1.Kërkesa ankimore depozitohet në gjykatën e shkallës së parë kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, e cila është kompetente për gjykimin e çështjes, sipas parashikimit të nenit 480, të Kodit të Procedurës Penale. Gjykimi i çështjes nuk pezullon vendimin e ministrit të Drejtësisë.

2.Në rastet kur kërkesa kundër vendimit të ministrit të Drejtësisë pranohet nga gjykata, ministri i Drejtësisë vendos bazuar në vendimin e gjykatës. Institucionet mjekësore të posaçme jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale shërbejnë për mjekimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor.

Vendosja e personave në institucionet mjekësore të veçanta, jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës. Vendosja e personave në seksione mjekësore të posaçme kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës ose të urdhrin të ekzekutimit të

prokurorit. Në rastet që nuk presin, vendosja e personit të paraburgosur ose të dënuar urdhërohet nga drejtori i institucionit ku ndodhet i paraburgosuri ose i dënuari, duke vënë në dijeni menjëherë prokurorin. Brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale krijohen seksione të veçanta për vendosjen e personave, të paraburgosur ose të dënuar, që gëzojnë statusin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë së Shtetit marrin masa për sigurimin e jetës së personit dhe realizimin e programit të trajtimit individual të tij. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, që ndjek e realizon organizimin dhe funksionimin e sistemit të paraburgimit, të ekzekutimit të vendimeve penale, të kryerjes së dënimit dhe të trajtimit të të ndaluarve, të arrestuarve e të dënuarve me burgim.¹²³ Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të administratës civile në Drejtorinë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët nuk bëjnë pjesë në strukturat e Policisë së Burgjeve, si dhe të punonjësve të administratës civile, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, rregullohen sipas legjislacionit të shërbimit civil. Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale me burgim duhet të projektohen, të ndërtohen apo të rikonstruktohen, në mënyrë që të plotësojnë kërkesat për një jetë normale. Ato duhet të kenë hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive të përbashkëta, si dhe të plotësojnë kërkesat individuale të të dënuarve apo të paraburgosurve. Atje ku e kërkojnë kushtet klimaterike duhet të sigurohet edhe ngrohja e mjediseve. Kur nuk është e mundur të sigurohet fjetja në dhoma individuale, caktimi i të paraburgosurit dhe të dënuarve në të njëjtën dhomë duhet të bëhet në mënyrë të tillë, që të shmangen konfliktet dhe ndikimet negative të ndërsjella. Për këtë qëllim përdoren kriteret e grupmoshave, të llojit të veprave penale të kryera dhe të veçorive instelektuale e psikike të të dënuarve. Higjiena vetjake, qethja dhe rruajtja mund të bëhen me detyrim vetëm për arsye të veçanta higjieno-sanitare, sipas kërkesës së shërbimit mjekësor dhe me urdhër të drejtorit të institucionit. Të paraburgosurit dhe të dënuarve u sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i mjaftueshëm, i përshtatshëm për moshën, gjendjen shëndetësore, punën, klimën dhe stinën. Ushqimi përgatitet dhe jepet si rregull në mjedise të caktuara për këtë qëllim. Me leje të drejtorit të institucionit, në raste të veçanta, të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të përgatisin dhe të konsumojnë ushqimin individualisht. Norma e ushqimit ditor përcaktohet nga tabelat përkatëse të miratuara nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë. Administrata e institucionit pranon ushqime tërësisht ose pjesërisht për të paraburgosurit dhe të dënuarit ose i siguron ato me shpenzimet e tij duke respektuar kufijtë e rregullores së brendshme. Të paraburgosurit dhe të dënuarve duhet t'u sigurohet në vazhdimësi ujë i pijshëm. Të paraburgosurit dhe të dënuarit që nuk

¹²³ Dr. Ismail Zejneli – E drejta penale pjesa e posacme (cikle leksionesh), Tetovë 2007, fq. 151

punojnë jashtë dhe të gjithë të dënuarit e tjerë, në ditët që nuk punohet, kanë të drejtë të qëndrojnë në ajrim në mjedise të hapura jo më pak se 2 orë në ditë. Kjo periudhë kohe mund të reduktohet, por jo më pak se 1 orë në ditë për shkaqe të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër të drejtorit të institucionit. Të paraburgosurit dhe të dënuarit që i përkasin minoriteteve etnike ose gjuhësore, të huaj ose persona pa shtetësi, pajisen me informacion me gojë dhe me shkrim, në gjuhën që e kuptojnë, për të drejtat dhe detyrimet e tyre në institucion.¹²⁴ I dënuari ka të drejtë të mbajë informacionin me shkrim për vete. Menjëherë pas pranimit, drejtuesit e institucionit i mundësojnë të paraburgosurit dhe të dënuarit të huaj njoftimin e familjes, këshilltarit ligjor, përfaqësuesit konsullor ose organizatës kompetente që vepron në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Shtetasve të huaj, që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në vend, refugjatëve ose personave pa shtetësi u mundësohet komunikimi me përfaqësitë diplomatike të shtetit që mbrojnë interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar, detyra e të cilit është mbrojtja e interesave të këtyre personave. Pas momentit të pranimit në institucion, të sapoardhurit menjëherë duhet t'i nënshtrohen një vizite ekzaminuese dhe interviste mjekësore nga ana e mjekut të institucionit për njohjen dhe parandalimin e përhapjes së sëmundjeve ngjitëse në institucion, vetëvrasjeve, regjistrimin e plagëve dhe dëmtimeve në kohën e duhur. Shenjat e dëmtimeve fizike, të identifikuar në vizitën e pranimit, duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë së bashku me shpjegimet e të sapoardhurit rreth rrethanave të shkaktuara. Mjeku, në rast se i kërkohet, duhet të pajisë të sapoardhurin me një certifikatë mjekësore, e cila shpjegon gjendjen e lëndimeve dhe rrethanat e tjera. Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor mbështetet në ligjin për shëndetin mendor. Të dënuarit dhe të paraburgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë seksioneve mjekësore të posaçme të institucioneve ose në qendrën spitalore të burgjeve. Trajtimi shëndetësor i grave të dënuara dhe të paraburgosura përfshin kontroll të plotë për të përcaktuar nevojat e kujdesit shëndetësor parësor si: praninë e sëmundjeve seksualisht të transmetueshme ose sëmundjeve të lindura të gjakut; nevojat për kujdesin shëndetësor mendor, përfshirë trajtimet e çrregullimeve posttraumatike, të rrezikut të vetëvrasjes ose vetëdëmtimit; historinë e shëndetit riprodhues; praninë e varësisë të drogës; abuzimin seksual dhe forma të tjera të dhunës që mund të ketë pësuar përpara pranimit në institucion. Të dënuarve dhe të paraburgosurave të mitura u garantohen programe dhe shërbime specifike me qasje me moshën dhe gjininë. Ato informohen me një gjuhë të kuptueshme për kujdesin shëndetësor, për parandalimin e sëmundjeve të ndryshme, higjienën vetjake, për format e dhunës dhe çdo lloj abuzimi. Gratë dhe të miturat, që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike, seksuale u nënshtrohen programeve të kujdesit shëndetësor për trajtimin dhe rehabilitimin e tyre.¹²⁵

¹²⁴ Dr. Ejup Sahiti & Dr. Ismail Zejneli – E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë, Shkup 2017, fq. 242

¹²⁵ Dr. Ragip Halili – Kriminologjia, Prishtinë 2018, fq. 339

Përfundimi

Me përfundimet që kam arritur me anë të këtij punimi kërkimor mund të them që na pjesën e analizës adekuate ose në pjesën e hulumtimit trajtohet problematika e konkluzionit dhe dhënies së rekomandimeve të duhura për sa i përket trajtimit efikas të parandalimit si dhe të uljes së vuajtjes së dënimit në shoqëri që paraqitet në familjet shqiptare, posaçërisht në shoqërinë e rajonit të Pologut të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Bazuar në analizën e përcaktimit normativo-ligjor të dënimit me burg në Republikën e Maqedonisë Veriore, si dhe bazuar në analizën e disa të dhënave statistikore që lidhen me zbatimin e dënimit me burg në Republikën e Maqedonisë Veriore, mund të nxjerrim përfundime për këtë temë por edhe për të dhënë pikëpamjet, konsideratat dhe propozimet tona për përmirësimin e mënyrës së vuajtjes së dënimit me burg në Republikën e Maqedonisë Veriore, por edhe për të përmirësuar pozicionin e të dënuarve. Sipas kohëzgjatjes së dënimit me burg, burgimi deri në 6 muaj është dënimi më i zakonshëm. Megjithëse kemi përmendur më parë se dënimet me burg në Republikën e Maqedonisë Veriore kanë filluar të ulen nga viti në vit. Kur bëhet fjalë për dënime me burg deri në 6 muaj ose edhe dënime me burg më të shkurtër. Ata janë dënimet më të shpeshta të shqiptuara nga gjykatat në vend. Qëllimi i gjithë këtij hulumtimi më shumë ka të bëjë me gjendjen në burgun e Tetovës pasi që deri më sot askush nuk e ka ngritur këtë problematikë me vite edhe pse si burg është i vogël në numër në nivel vjetor me pranimin e atyre që vuajnë dënimin megjithatë përmes këtij hulumtimi të punimit kam arritur të nxjer në pah një numër të madh të problematikave si nga mosha, gjendja shëndetësore e të dënuarve, arsimimi i tyre, përkatësia etnike etj. Mbipopullimi është problemi më i zakonshëm kur vuan dënimin me burg në burgje në Republikën e Maqedonisë së Veriut me të cilën edhe vërtetohen hipotezat e ngritura në këtë punim. Analiza e raporteve të Avokatit të Popullit, raportet e Drejtorisë për Ekzekutimin e Sanksioneve, raportet e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut zbuluan probleme të ndryshme, të parat që ishin problemi i "mbipopullimit" në burgje. Rritja e numrit të të dënuarve nga njëra anë dhe numri i kufizuar i objekteve akomoduese në institucionet ndëshkuese janë pikërisht arsyet e këtij problemi. Mbipopullimi dhe kushtet e dobëta dhe mungesa kadrovike e cfarëdo profili që nevojitet në burgje e që do të ishte në shërbim të të burgosurve po cenojnë dinjitetin njerëzor të personave të privuar nga liria. Sipas të dhënave më të fundit nga Këshilli i Evropës, për Republikën e Maqedonisë së Veriut konstatohet se vendi udhëheq grupin e dhjetë vendeve evropiane në burgjet e së cilës ka më shumë të burgosur se sa vende të lira në burgje. Në lidhje me problemin e mbipopullimit, ne besojmë se kjo nuk është mënyra e vetme për të zgjidhur këtë problem me një sfond politik, d.m.th. me miratimin e një Ligji të Amnistisë për kryerësit e veprave kriminale. Për ta zgjidhur atë, mund të ekzistojnë disa alternativa të ndryshme si: Rinovimi dhe zgjerimi i ambienteve të akomodimit në institucionet ekzistuese të burgjeve, ndërtimi dhe ngritja e institucioneve të reja të burgjeve. Problem tjetër që del në pah janë edhe kushtet e këqija dhe të dobëta higjienike dhe në mënyrë direkte ndikojnë në

përhapjen e sëmundjeve të ndryshme infektive midis të burgosurve por edhe të rrethit më të gjërë në shoqëri. Në kontekstin e zgjidhjes së këtij problemi, është e nevojshme tprodukte të higjienës personale, ujë, ndryshim të rregullt të rrobave, shtratetërve dhe ajrosje të nevojshme. Problem tjetër që ngrihet në këtë punim është edhe procesi i rregullt edukativo- arsimor që është edhe i domosdoshmë për të burgosurit që do të ketë një impakt pozitiv në resocializimin e të burgosurve dhe me arsimin dhe edukimin e detyrueshëm do të krijohen kushte për të siguruar vazhdimësinë në procesin arsimor. Kryerja e procesit arsimor të të dënuarve është një segment i rëndësishëm që mund të kontribuojë në përmirësimin e procesit të risocializimit dhe përshtatjes sociale të të dënuarve pas vuajtjes së dënimit me burg, mungesa e një procesi të tillë nëpër burgjet e Maqedonisë së Veriut e vërteton hipotezën e ngritur në këtë punim.

Literatura

- Ault, L, Richard, Reise, James, T, A Psychological Assessment of Crime Profiling, (2007),
- Butorac, Ksenija, Geografija kriminaliteta-kriminološki i kriminalistički diskursi. Policija i sigurnost, broj 3,
- Canter, V. David, Criminal Shadoës: Inside the mind off the serial killer, Harper Collins, (1994.),
- Clarke, C, Keith, Getting started With Geographic Inforamtion Systems. Upper Sadlle River, (1997.),
- D.Atanacković - Penologija, Beograd, 1988,
- Ebisike, Norbert, The use of offender profiling evidence in criminal cases, (2007.),
- Egger, A, Steven, Psychological Profiling: Past, Present, and Future, Journal of Rossmo, Kim, Jackson, L. Contemporary Criminal Justice, Volume 15, No. 3, (1999.),
- Kanuni i Lekë Dukagjinit, i përmbledhur nga Shtjefën Gjeqovi,
- Kovčo Vukadin, Irma, Mihoci, Miroslav, Nasilje u penalnim ustanovama, Hrvatski ljetopis za kazneno pravo i praksu, Zagreb, vol 17,
- Kovač, Dario, Što je kriminalističko profiliranje, <http://istrazime.com/klinickapsihologija/sto-je-kriminalisticko-profiliranje/>, (2014), (10.12.2018),
- I.Salihi E drejta penale, Prishtinë, 2013,
- I.Elezi & V.Hysi Politika penale, Tiranë, 2001,
- Janet, Bekerian, Debra, Geograpich Profiling, Offender Proffiling: Theory, Research and Practice, Wiley, (1997.),
- L.Arnaudovski - Penologija, Shkup, 1998,
- McGrath, Michael, Criminal Profiling: Is there a Role for the Forensic Psychiatrist, Journal of American Academy of Psychiatry and LaË, Vol 28, No 3, (2000.),
- M.Shuković Uslovni otpust, Beograd, 1971,
- Pavliček, Josip, Krvni delikti, Međunarodno kriminalističko udruženje, Zagreb, (2012.),

- R.Halili Kriminologjia, Prishtinë, 2011,
- R.Halili Penologjia, Prishtine, 2014,
- Rašić, Helena, Kovačević, Dražen, Žarković Palijan, T, Profiliranje počinitelja ubojstava, Policija i sigurnost Zagreb, godina (2012.),
- Slaviček, Irena, Doležal Dalibor, Kriminalističko profiliranje. Hrvatska revija za rehabilitacijska istraživanja, Zagreb, vol. 2,
- Schrag, Clarence, Leadership among prison inmates, American Sociological Review, (1954.),
- Šeparović, Zvonimir, Viktimologija Studije o žrtvama, Zagreb, Pravni fakultet u Zagrebu, (1987.),
- Turvey, Brent, Criminal Profiling: An Introduction to Behavioral Evidence Analysis. San Diego, Academic Press, (2008.),
- T.Kralev Penoloshki leksikon, Shkup, 2002,
- Violent and Sexual Offenders, Psychiatry, Psychology, and Laë, Vol.4, No. 1, (1997.),
- V.Latifi Politika e parandalimit të kimit, Prishtinë, 2013
- V.Kambovski & I.Zejneli E drejta penale, pjesa e përgjithshme (përkthim), Shkup,2018
- I.Zejneli E drejta penale pjesa e posacme, vit 2007,
- I.Zejneli Delikuenca e të miturve, Prishtinë/Tetovë 2018,
- Dr. Ismet Salihu – E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2003
- Ejup Sahiti & Ismail Zejneli E drejta e procedurës penale e RM-së, Shkup 2017
- Dr. Shefqet Muci – E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tiranë 2012,
- Dr. Ismet Salihu – E drejta penale pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2003,
- Wilson, P. Lincoln, R. Kocsis, R., Validity, Utility and Ethics of Profiling for Serial,
- Dr. Toma Zhivanovq Osnovi krivicnog prava (Opsti del), Boegrad vit 1992,
- Dr. Jovan Proevski: Krivicen zakonik (objasnenie, komentari i sudska praktika Akademik – Skopje, vit 1998
- Kushtetuta e IRJ nga viti 1963, Kushtetuta e publikuar në Gazetën zyrtare të Jugosllavisë nr. 14/1963 vit,
- Kushtetuta e RMV nga viti 1974 (Gazeta zyrtare e RMV, nr. 7/1974),
- Gazeta zyrtare e RM, nr. 37/1996 vit).

LIGJET

- Kodi penal i R.Maqedonisë së Veriut
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale te R.Maqedonisë së Veriu
- Ligji mbi prokurorine publike
- <http://pravda.gov.mk/>
- Ligji mbi gjykatat
- <http://ombudsman.mk/>

Biografia

Blerand Rexhepi ka lindur në Tetovë të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Deri në vitin 2001 ka jetuar në fshatin Sellcë të Tetovës ku edhe ka kryer shkollimin fillorë në shkollën fillore 'Rilindja' të fshatit Sellcë ndërsa mësimet më pas i ka vazhduar në shkollën e mesme ekonomike '8 Shtatori' në Tetovë. Pas mbarimit të shkollës së mesme ai zhvendoset për të jetuar në Budapest të Hungarisë së bashku me familjen duke qenë për tre (3) vite rresht atje e më pas për t'u zhvendosur në Pragë të Republikës Çeke për dy (2) vite. Në vitin 2007 ka qëndruar në Perugia të Italisë për të ndjekur mësimet e gjuhës dhe kulturës italiane në 'Universita degli Stranieri'. Më pas në vitin 2008 regjistron studimet universitare në UEJL në fakultetin juridik sistemi tre (3) vjeçar, e pas mbarimit të tyre njëkohësisht bën transfer në sistemin katër (4) vjeçar në Fakultetin juridik në Universitetin e Travnikut në Bosnjë dhe Hercegovinë. Pas mbarimit të studimeve të ciklit të lartë ai vazhdon edhe studimet master në UEJL në fakultetin juridik drejtimi E drejtë penale. Ka punuar për shumë vite si gazetar në gazetën Panorama të Tiranës, në Agjencionin e lajmeve Zhurnal, në gazetën Koha, në komunën e Tetovës, në Ministrinë e financave, në Entin shtetërorë për pronësi industrial e shumë institucione të tjera. Është i martuar dhe baba i dy vajzave.